

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Prenuar		15.02.2023	
Nj. Org	Numër	Shtojca	Vlera
01-	052/01-	8653	

RAPORTI I PUNËS JANAR-DHJETOR 2022 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Komuna e Drenasit



**DRENAS
2022**



Përmbajtja

1. Zyra e Kryetarit të Komunës
 - 1.1. Zyra për Komunikim me Publikun
 - 1.2. Zyra e Auditorit të Brendshëm
 - 1.3. Zyra e Personelit
- 1.4. Zyra për Integritet Evropian (ZKIE)
- 1.5. Zyra për Komunitete dhe Kthim
- 1.6. Zyra për Barazi Gjinore
2. Planifikimet sipas drejtorive
 - 2.1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
 - 2.2. Drejtoria e Arsimit
 - 2.3. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
 - 2.4. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR)
 - 2.5. Drejtoria e Inspektionit
 - 2.6. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
 - 2.7. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
 - 2.7.1. Raporti i Punës i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Hafir Shala”
 - 2.8. Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
 - 2.9. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
 - 2.10. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
 - 2.11. Infrastruktura Publike
 - 2.12. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

1. ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Në periudhën raportuese janar-dhjetor 2022 të kryetarit, janë regjistruar përmes intranetit të brendshëm (arkivit aktiv) 2133 lëndë të ndryshme dhe të gjitha janë procesuar me kohë, mbi 300 prej tyre janë dorëzuar në arkivin e Komunës, ndërsa janë kthyer përgjigje të gjithë atyre që kanë adresuar kërkesat përmes intranetit. Janë nxjerr 349 vendime të ndryshme, ku ato që kanë pasur karakterin e përgjithshëm, janë publikuar edhe në ueb faqen e Komunës, ndërsa të tjerat janë publikuar me listë të përgjithshme. Zyra e kryetarit ka organizuar dy (2) takime me publikun, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për të diskutuar aktivitetet e gjashtëmujorit të parë të vitit raportues dhe gjashtëmujorit të dytë të vitit raportues. Po ashtu janë mbajtur dymbëdhjetë (15) dëgjime buxhetore, tetë (8) për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024 për kërkesat fillestare me qytetarët e Komunës së Drenasi dhe shtatë (7) të tjera për investime kapitale. Po ashtu janë mbajtur edhe 6 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), janë mbajtur edhe 54 mbledhje të Bordit të

Drejtorëve, ku janë diskutuar pika të ndryshme dhe për të gjitha është mbajtur proces mbi diskutimet

dhe konkluzionet e nxjerra nga mbledhjet, ku secili drejtor ne baza javore ka raportuar për aktivitetet, punët dhe angazhimet si dhe janë diskutuar tema të ndryshme. Të gjitha njoftimet, komunikatat, ftesat dhe dokumentet janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetin social Faceook.

ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN

Zyra për Komunikim me Publikun, gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, ka përcjellë aktivitetet ditore, javore dhe mujore të Komunës. Përmes linkut <http://kk.rks-gov.net/gllogoc/>, ueb faqes zyrtare të Komunës. ZKP ka publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe ka publikuar të gjitha vendimet, rregulloret, raportet, projektet, njoftimet, konkurset, njoftimet e zyrës së prokurimit si; kontratat e nënshkruara, njoftimet për anulim, njoftimet për dhënien e kontratave, njoftimet për kontratë, njoftimet për nënshkrimin e kontratave dhe shkresa të tjera në interes të gjithë qytetarëve të Komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me media dhe OJQ, ku i ka përcjellë njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa, reagime etj., ku gjithsejtë ka lëshuar mbi 450 komunikata të karakterit të ndryshëm informues në ueb faqen zyrtare dhe në rrjetin social Facebook. Ka përcjell agjendën e Kryetarit dhe ka caktuar takime në bashkëpunim me Kryetarin me delegacione të ndryshme nga niveli qendror dhe ai lokal, si dhe më delegacione të ndryshme ndërkombëtare. Në kuadër të kësaj zyre, janë pranuar dhe shqyrtuar edhe kërkesat për qasje në dokumente publike dhe gjatë periudhës raportuese, janë pranuar 50 kërkesa për qasje dhe të gjitha kanë qenë të qasshme sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Ju ka përgjigjur të gjitha OJQ-ve për plotësimin e formularëve të pyetjeve të dërguara dhe kontakti i përhershëm me Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal si dhe me nivele të tjera qeveritare. Po ashtu ka mbajtur kontakte të rregullta me media dhe i ka kthyer përgjigje të gjitha atyre që janë interesuar për çështjet e Komunës së Drenasit dhe ka dhënë intervista të ndryshme për televizione e portale. Zyra për Komunikim me Publikun kryen edhe punë të tjera sipas përkrahjes së detyrave të secilit punonjës.

1.2. ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM

Komuna ka të themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm si Njësi e auditimit në vartësi të drejtpërdrejtë të Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik sipas nenit 19, pika 2.1 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe në pajtim me Rregulloren QRK nr. 01/2019. Kjo Njësi është e përbërë prej dy auditorëve, Drejtorit të Njesisë dhe një Auditor. Kërkesat ligjore janë që ne të kemi së paku edhe një auditor për shkak të buxhetit mbi 18 milionë dhe për shkak të numrit të personelit prej 1368 punëtorë, mirëpo në mungese të masës buxhetore për paga dhe në mungesë të numrit të certifikuar për punëtorë të rinjë, nuk kemi pasur mundësi që ta rrisim numrin e auditorëve. Poashtu në pajtim me nenin 20 të këtij Ligji është i formuar edhe Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në fund të vitit 2021, ka hartuar dhe aprovuar para Komitetit të Auditimit të Brendshëm Planin Strategjik të zhvillimit të aktiviteteve audituese për vitet 2022 -2024 si dhe duke u bazuar në këtë Plan , ka miratuar edhe Planin vjetor të Punës për vitin 2022.

Me Planin e Punës së kësaj Njësie, për vitin 2022 janë paraparë që të kryhen gjithsej shtatë auditime të rregullta. Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2022 ka përmbushur në tërësi Planin vjetor të punës duke kryer të gjitha auditimet e parapara me këtë Plan.

Auditimet e kryera kanë pasur për qëllim arritjen e përmbushjes së objektivave të parapara me Planin Strategjik të kësaj Njësie për vitet 2022-2024.

Atom und të përmbledhen në këto pika kryesore si:

- ❖ Arritja e një pajtueshmërie të plotë me kornizën ligjore
- ❖ Ruajtja dhe menaxhimi i mirë me buxhetin dhe pasuritë e komunës;
- ❖ Shfrytëzimi më ekonomik i pasurisë komunale dhe rritja e vlerës së kësaj pasurie;
- ❖ Shfrytëzimi më ekonomik i resurseve humane dhe materiale në dispozicion të komunës;
- ❖ Shtimi i sigurisë dhe integritetit të të dhënave të pasqyruara;
- ❖ Rritja e vlerës së burimeve humane dhe materiale; dhe
- ❖ Krijimi i një qeverisje të mirë të bazuar në rrezik.

1.2. ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM

Gjatë vitit 2022 janë kryer shtatë auditime të parapara me Planin vjetor. Të gjitha këto auditime kanë përfunduar me Raporte të shkruara në formen finale. Raportet e finalizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë shqyrtuar nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe janë nxjerrur konkluzionet për hapat që duhet të ndërmerren për jetësimin e rekomandimeve të Auditorit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm ka qenë mjaft aktiv dhe gjatë këtij viti ka mbajtur katër mbledhje të parapara për çdo tremujor sipas ligjit ku ka shqyrtuar dhe miratuar të gjitha raportet e auditimit, Planin vjetor dhe atë strategjik, raportet gjashtëmujore dhe vjetore mbi gjendjen e rekomandimeve të dhëna, si dhe raportin gjashtëmujor dhe atë vjetor të cilët janë dërguar në Ministrinë e Financave, përkatësisht në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm.

Gjatë vitit 2022, Njësia e Auditimit të Brendshëm e Komunës së Drenasit ka qenë e monitoruar në vazhdimësi edhe nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave e cila kujdeset për arritjen e pajtueshmërisë së plotë me të gjitha standardet e parapara në Kornizen Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale në fushën e Auditimit. Poashtu, gjatë vitit 2022, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka ndërmarrur një qasje gjithpërfshirëse dhe profesionale për ofrimin e rekomandimeve të dobishme për menaxhmentin e komunës. Aktivitetet e kësaj Njësie ishin në përputhje me detyrat e planifikuara në fillim të vitit në aspektin kohor. Gjatë auditimeve janë zhvilluar intervista me menaxherët dhe janë shqyrtuar mostra për të identifikuar shkallën e implementimit të rekomandimeve dhe aktivitetet që janë ndërmarrur në këtë drejtim.

1.2. ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM

Fushat e audituara gjatë këtij gjashtëmujori kanë qenë: Menaxhimi me pasuritë jofinanciare të Komunës të krijuara nga investimet kapitale dhe pasuritë tjera të lëvizshme kapitale jo financiare, Rishikimi i proqeseve të lëshuarjes së lejeve dhe inkasimi i të hyrave vetanake në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Menaxhimi me autoveturat në pronësi të Komunës, Auditimi i proceseve të inkasimit të të hyrave vetanake nga Tatimi në Pronë, Menaxhimi me kontrata publike, Rishikimi i proceseve të shpenzimit, dhe Rishikimi i proceseve të prokurimit.

Gjatë kësaj periudhe janë dhënë një numër i rekomandimeve dhe shumica prej tyre janë implementuar ku janë ndërmarrur një numër i madh i aktiviteteve për adresimin e drejtë të tyre.

Menaxhmenti i komunës ka ndërmarrur gjithsej 59 aktivitete konkrete për jetësimin e rekomandimeve edhe përkundër kohës së shkurtër, një numër i madh i rekomandimeve janë përmbushur.

Gjatë kësaj periudhe, Komuna ka pranuar edhe Raportin e rregullt vjetor të auditimit të Pasqyrave Financiare nga Zyra Kombëtare e Auditimit ku ka marrë opinionin më të mirë të mundshëm që ekziston (opinion i pa modifikuar pa theksim të çështjes). Ne inkurajojmë menaxhmentin që edhe më tutje të vazhdojnë me aktivitete në përmbushjen e implementimit të rekomandimeve dhe në arritjen e objektivave të përgjithshme të Komunës.

1.3. ZYRA E PERSONELIT

Gjatë vitit 2022, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka azhuruar listat e pagave sipas ndryshimeve, konform zhvillimeve në stafin e punëtorëve.

Paraqitja në formë tabelare e realizimit sipas azhurimit në listë të pagave ;

Muaji-viti	Punëtor i ri	Ndryshime	Punëtorë të larguar	Pagesa retroaktiv	etj
Janar 2022	3 (tri) pozita punëtor të ri	2	0	8	Lista për anët.dhe anët. të KK
Shkurt 2022	6(gjashtë) pozita punëtor të ri	3	0	13	Lista për anët.dhe anët. të KK
Mars 2022	10(dhjetë) pozita punëtor të ri	6	1 largim për shkaqe personale	12	Lista për anët.dhe anët. të KK
Prill 2022	4 (katër) pozita punëtor të ri	2	2(largim-përfund. Mandati dhe shk.pers.	15	Lista për anët.dhe anët. të KK
Maj 2022	0	5	0	8	Lista për anët.dhe anët. të KK
Qershor 2022	2 (dy) pozita punëtor të ri	7	0	2	Lista për anët.dhe anët. të KK
Korrik 2022	0	3	1 largim më arritjen e moshës së pensionimit	3	Lista për anët.dhe anët. të KK
Gusht 2022	0	1	1 largim më arritjen e moshës së pensionimit	5	Lista për anët.dhe anët. të KK
Shtator 2022	2 (dy) pozita punëtor të ri	0	1 largim më arritjen e moshës së pensionimit	12	Lista për anët.dhe anët. të KK
Tetor 2022	5 (pesë) pozita punëtor të ri	1	1 largim (dorëheqje) për shkaqe personale	2	Lista për anët.dhe anët. të KK
Nëntor 2022	2 (dy) pozita punëtor të ri	4	2 largime më arritjen e moshës së pensionimit dhe 1 largim (dorëheqje) për shkaqe personale	7	Lista për anët.dhe anët. të KK
Dhjetor 2022	0	1	0	33	Lista për anët.dhe anët. të KK

1.3. ZYRA E PERSONELIT

Nga muaji Shkurt 2022, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me kërkesë të DMZP, IKAP, USAID, ATK ka përgaditur planin për trajnimin e stafit (shërbyesve civil). Është përgaditur lista e të dhënave të të punësuarëve në shërbimin civil, për staf në Arsim, në Shëndetësi, staf Politik, staf mbështetës dhe i është dërguar përmes formularit (Moduli i Statistikave) në SIMBNJ (Sistemi Informativ për Menagjimin e Burimeve Njerëzore).

Hartimi i planit individual i personelit për pozitë e lira nga të gjitha format e kërkesave për vitin 2022 është përfunduar në fund të muajit Tetor 2022, përmes sistemit të SIMBNJ dhe plotësim-ndyshim PPI, si dhe është aprovuar prej DMZP.

Me fillim vit hartohet plani orientues i shfrytëzimit të pushimeve vjetore prej zyrtarëve publik në vartësi dhe në përputhje me kërkesat e të punësuarve dhe nevojat e institucionit.

Pra për kërkesat e njësive kërkuese për plotësim të pozitave të lira të punës nga muaji Janar 2022 është filluar me konkurse të mbyllura (brendshme) Lëvizje paralele brenda kategorisë, si dhe gjatë vitit 2022 janë realizuar dy (2) pozita Lëvizje paralele brenda kategorisë.

Pas këtij hapi si dhe interesimi i njësive kërkuese që sa më parë të zhvillohen procedurat rekrutuese për pozitë e lira të punës, kërkesat për plotësimin e pozitave me rastin e pensionimit, me ndërprerje të marrëdhënies së punës si dhe për arsye të ndryshme, si dhe pozitë e lira të punës të planifikuara me PPI për vitin 2022. Pas Plotësim-ndyshimeve ligjore dhe akteve nënligjore në nivel vendi, me shpallje të konkurseve – pranim (konkurse të hapura-publike gjatë të vitit 2022 janë shpallur 16 (gjashtëmbdhjetë) grup pozitash : pas përfundimit me sukses të procedurave rekrutuese më përzgjedhje janë plotësuar njëzetëntë (29) pozita me nëpunës civil dhe një (1) pozitë më zyrtar publik.

1.3. ZYRA E PERSONELIT

Në muajin Mars 2022 Auditorët e Jashtëm ,

Nga auditorët janë kërkuar; dosjet personale për disa shërbyes civil, Akt Emërime, Lista e pagave për muaj të caktuar, Kualifikimi (diplomë ose certifikatë), lista e shërbyeve civil në pushim të lehonisë 2021, punë shtesë të shërbyesve civil, procedurën e pensionimit me arritjen e moshës, raporti periodik i evidencës së hyrjeve dhe daljeve të punëtorëve për periudhë të ndyshme mujore, procedura rekrutuese të konkurseve të mbyllura (të brendshme) Lëvizje paralele brenda kategorisë dhe procedura rekrutuese të konkurseve – pranim (konkurse publike), si dhe lidhur me punët dhe detyrat e tjera që dalin nga kompetencat e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është përgjigjur dhe ka plotësuar dokumentacionin në bazë të detyrës zyrtare edhe sipas kërkesës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me rastet ankimore që kanë të bëjnë me procedurat e rekrutimit, ankesave për ngritje të koeficientit, si dhe përgjigjen më rastin e monitorimit të rregullt të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Po ashtu Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore sipas detyrës Zyrtare dhe sipas Rreg.nr.11/2020 ka rolin e sekretarisë për përgatitjen e seancave sipas ankesave, për Komisionin Disiplinor, ku janë zhvilluar seancat: Ankesat kanë qenë; ankesa për masë disiplinore, për pagë jubilarë.

2.1.ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE (ZKIE)

ZKIE edhe në këtë periudhë të raportimit kemi punuar në përmbushjen e detyrave të punës në përmbushjen e obligimeve komunale nga Agjenda Evropiane ka raportuar në MAPL për raportin Gjashtë mujor Janar-Qershor 2022,dhe Janar-Dhjetor 2022, po ashtu kemi koordinuar monitoruar dhe raportuar edhe më stafin drejtues për sfidat që kanë dale në përmbushjen e tyre.

ZKIE- Harton dhe miraton plane, projekte dhe ofron shërbime përkatëse në fushën e integrimeve europiane, ofron përkrahje, këshilla dhe ekspertizë profesionale drejtuesve në fushën e integrimit evropian duke marrë parasysh obligimet që dalin nga të gjitha dokumentet strategjike kombëtare rreth integrimit evropian dhe marrëdhënieve në Kosovë. Siguron që ndihma e jashtme është e ndërlidhur dhe kontribuon në zbatimin e prioriteteve dhe planeve të institucionit, koordinon dhe konsultohet me institucionet përgjegjëse dhe institucionet e tjera të jashtme përkatëse për fushën e integrimeve europiane me qëllim të harmonizimit të prioriteteve dhe politikave, merr pjesë në përcaktimin dhe planifikimin e aktiviteteve të ministres në përputhje me dokumnetet strategjike kombëtare për integrim evropian, koordinon dhe bashkëpunon me zyrën e personelit për ngritje të kapaciteteve të stafit për çështjet e ndërlidhura me integrimin evropian, ofron udhëzime për stafin e nivelit më të ulët të njësisë organizative në bërjen e hulumtimeve, përgatitjen e raporteve dhe ofrimin e këshillave rreth çështjeve të integrimeve europiane, duke kontribuar në punën e tyre sipas nevojës monitoron produktet.

2.1.ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE (ZKIE)

ZKIE gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 ka kryer punët dhe detyrat e punës në bazë të planit të punës përshkrimit të detyrave të punës dhe Rregullorës Qeverisë 08/2011. Programi Kombëtar për Zbatim të MSA-së që është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe komuna, ku në nivelin lokal kemi Planin e veprimit të obligimve të Komunave nga Agjenda Evropiane,

Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi parrë pjesë edhe takimin e grupit punues për hartimin e Planit për integritet 2023-2026 konform ligjit nr.03/1-159 i cili plan është miratuar më dt.28.12.2022 nga Kuvendi Komunal i Komunës së Drenasit, i cili ka qenë rekomadim nga MAPL dhe i përmushur nga Komuna, po ashtu kemi marrë pjesë edhe në grupin punues në hartimin e Planit Komunal për menagjimin e mbeturinave i cili është fazat e procedurave për tu miratur nga KK, Drenas. Gjithashtu kemi përcjellë raporte sipas kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal përkatësisht Departamentit për Integrim Evropiane dhe koordinim të Politikave, kemi koordinuar punën me drejtorët e drejtorive dhe shefat e sektoreve dhe udhëheqësin e personelit për identifikimin e nevojave për trajnime për stafin civil të komunës së Drenasit. Është raportuar me kohë kryetarit dhe MAPL-së për Përmbushjen e Obligimeve nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar – Qershor 2022 dhe Janar Dhjetor 2022 për Komunën e Drenasit Prandaj duke pasur parasysh se procesi integritet evropiane janë një nder prioritetet kryesore të Qeverisë dhe të komunave, ndërsa përmbushja e tyre janë obligimet e tona të përbashketa e të gjitha institucioneve, ku për vlersimin e tyre Komisioni Evropian del më raportin për të arriturat ngecjet dhe sfidat që dalin në përmbushjen e tyre.

2.2. ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim këshillon autoritetet komunale në lidhje me nevojat e komuniteteve pakicë që jetojnë në Komunën tonë, të siguroj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre, qasje të barabartë të gjitha komuniteteve në shërbimet publike dhe të krijoj kushte për një kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar që u përkasin të gjitha komuniteteve.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim gjatë vitit 2022, ka pasur për fokus personat e riatdhesuar – riintegrimin e tyre.

Gjatë këtij viti kemi 7 persona të riatdhesuar, nga këto 2 raste i kemi raste të cenueshme. Ndërsa të riintegruar kemi 18 persona.

Në bazë të Rregullores së Riintegrit 22/2020, personat e riatdhesuar kanë mundësi aplikimi në: Vetëpunësim, Subvencionimi në punësim dhe Trajnim në punë.

Tek kategoria e Vetëpunësimit kemi 7 (shtatë) persona të riatdhesuar të cilët janë integruar dhe kanë përfituar mjete pune për fillim të biznesit në lëmin ku ata kanë aplikuar për të krijuar të ardhura për familjet e tyre.

Gjatë këtij viti kemi pasur 12 kërkesa nga personat e riatdhesuar për paisje me vërtetim, pastaj për kompletim të dokumentacionit, ku të gjithë janë paisur në bazë të dokumenteve të kthimit që i kanë poseduar. Nga rastet e riintegrit kemi 1 (një) familje përfituese të pakos së akomodimit dhe (1) një individ, 3 (tre) familje përfituese nga pakoja e gjëra ushqimore – higjienike, 2 persona (individ) përfitues të pakos gjëra ushqimore-higjienike dhe 1 (një) familje përfituese e pakos me dru.

2.2. ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Kemi mbajtur 6 (gjashtë) takime me Komisionin Komunal për Riintegrim , ku kemi shqyrtuar kërkesat e personave të riatdhesuar, nga këto kemi 2 (dy) pranim të akomodimit ,1 (një) pranim për renovim të shtëpisë, 1 (një) pranim të ndërtimit të shtëpisë dhe 1 (një) orendi shtëpiake.

Nga personat e riatdhesuar/riintegruar kemi verifikuar në teren 18 raste. Verifikimi është bërë së bashku me koordinatorin rajonal nga MPB, gjithashtu kemi pasur 2 raste ku verifikimi është bërë së bashku me zyrtar nga Drejtoria e Urbanizmit.

Zyra për Komunitete dhe Kthim gjatë vitit 2022 ka mbajtur 6 takime të Komitetit për Komunitete , ku temë diskutimi ka qenë gjithmonë si pikë e parë Raporti i punës nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, pastaj temat të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien e qytetarëve të Komunës sonë.

Gjithashtu kemi qenë pjesë e KKS-së, ku në çdo mbledhje kemi dhënë kontributin tonë.

Zyra për Komunitete dhe Kthim- në cilësinë e kordinatorit kemi mbajtur tre takime me **Grupin Lokal të Veprimit** ku edhe kemi përfunduar projektin mbi monitorimin dhe bashkëpunimin me **Organizaten “AKTI”**, për përgatitjen e të rinjve dhe shfaqjen e vlerave të tyre , përmes trajnimit dhe këshillimit së bashku me trajneret e tyre. Pra me datë **23.06.2022**, kemi mbajtur Konferencën përfundimtare me **Organizatën “AKTI”**, kështu që kemi arritur që me anë të këtij projekti kanë përfunduar dhe janë certifikuar 62 të rinj nga grupet e marginalizuara nga

këta kemi 24 persona të punësuar, 8 persona të angazhuar me punë praktike, 3 persona në intership dhe 3 persona të angazhuar në aftësim profesional. I gjithë ky rezultat është arritur falë bashkëpunimit me institucionet dhe bizneset komunale. Nga ky projekt G.L.V së bashku me Org “AKTI” kemi mbajtur gjithsej 14 takime ku kemi diskutuar rreth mbarëvajtjes së projektit.

2.2. ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Kemi mbajtur dy takime me Zyren e Kryeministrit për projektet të cilat mund të përfitojnë të gjitha komunitetet. ZKKK- gjithashtu ka qenë pjesë e grupit për krijimin e databazës, Projekti “DEMOS” ne si grup kemi krijuar një databazë me grupet më të rëndësishme që ka të bëjë në fuqizimin e vendimarrjes komunale , ku arrihet përmes konsultimit dhe pjesmarrjes së qytetarëve në takimet komunale.

Gjatë vitit 2022 gjithashtu kemi mbajtur trajnim 3 ditor me organizaten “Business Development Group” mbështetur nga MPB, Caritas, GIZ– ku kemi punuar në projektin që do të filloj në vitin 2023 , për tu dalur në ndihmë personave të riatdhesuar , projekti perfshin femijet e riatdhesuar.

Zyra për Komunitete dhe Kthim ka qenë pjesë e Komisionit për Çmimin Evropian për Qeverisje të Shkëlqyer, duke u bazuar në plotësimin e Parimeve (1-12) të qeverisjes së mirë demokratike. Zkk- kemi pasur për obligim plotësimin e P-11, ku të gjithë si komision kemi punuar duke marrur nga Komisoni Evropian edhe çmimin Kryesor për Qeverisje të mirë Komunale të pranuar nga Kryetari i Komunës së Drenasit z.Ramiz Lladrovci.

Zyra për Komunitete dhe Kthim ka qenë pjesëmarrëse edhe në muajin e ndërgjegjësimit kundër dhunës në familje “16 Ditët e Aktivizimit” – ku së bashku me ZDNJ , kemi shprendar fletushka dhe kemi mbajtur takime në institucione arsimore , po ashtu dhe institucione tjera të

rëndësishme të cilat kontribuojnë në mirëqenien qytetare.Po ashtu për festat e fundvitit kemi bërë shpërndarjen

e dhuratave për fëmijët me aftësi të kufizuar në Handikos së bashku me stafin e Organizates Preda

Plus, Wentrepreneur dhe ASB – Kosova, ku do të vazhdojë bashkëpunimi gjatë vitit 2023 me projekt për

fuqizimin e aftësimit profesional të personave të riatdhesuar për zhvillim biznesi.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Njësia për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Drejta të Njeriut paraqet raportin e punës për periudhën janar – dhjetor **2022**, ku pasqyrohet komplimentimi i ligjeve që janë në funksion të drejtave të njeriut si dhe aktiviteteve të Njesisë për MD dhe Drejta të Njeriut dhe **Zyrtarës për Barazi Gjinore**

Në raport janë prezantuar aktivitetet, të dhënat dhe shënimet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara për vitin 2022, në kontekst të të drejtave të njeriut, Barazisë Gjinore nga sektorë të ndryshëm të institucioneve komunale. Raporti pasqyron implementimin e ligjeve vendore që janë në funksion të të drejtave të njeriut, por edhe konventave ndërkombëtare që zbatohen drejtëpërdrejtë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Nga ky raport, ndërtojmë rekomandimet e reja për përfshirjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të gjitha sferat shoqërore, respektimin e plotë publik mbi të drejtat e qytetarëve si dhe ngritjen e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë në mënyrë që të gjithë qytetarët e komunës së Drenasit të kenë qasje të barabartë në shërbimet cilësore publike.

Koordinator/e e Njesisë Komunale për Mbrojtje nga Diskriminimi të Drejtat e Njeriut dhe Zyrtare për Barazi Gjinore

Koordinon, udhëheqë dhe mbikëqyrë politikat në komunë në fushën e të drejtave të njeriut duke përfshirë respektimin e politikave mbi barazinë gjinore, të drejtave të komuniteteve, përdorimi i gjuhëve, mundësitë e barabarta, zbatimin e politikave për personat me aftësi të kufizuara, të drejtave të fëmijëve, kundër – diskriminimin dhe antitrafikimin.

KNJKDNJ është përgjegjës për implementimin e politikave anti – diskriminuese në komunë, ashtu siç është e paraparë me Ligjin Kundër Diskriminimit, ligjet tjera vendore dhe ato ndërkombëtare, të cilat promovojnë respektimin e të drejtave të njeriut.

Udhëheqë programin e komunës për barazi gjinore, duke siguruar se funksionet ekzekutive të komunës dhe zyret tjera relevante, mbështesin politikat dhe strategjitë për implementimin e Ligjit për Barazi Gjinore, procedurat e Mundësive të Barabarta dhe Personat me aftësi të kufizuara, sipas legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtar, për të drejtat e njeriut, si dhe monitoron zbatimin e ligjeve që sanksionojnë trafikimin me qenie njerëzore.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Barazia Gjinore

Koncepti i diskriminimit në bazë të gjinisë përfshinë dallimin në trajtimin, përjashtimin apo kufizimin në bazë të gjinisë, që me atë rast e rrezikon apo parandalon gëzimin ose ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në politikë, shoqëri, kulturë apo fusha tjera. Çfarë do dallimi në trajtim është diskriminues vetëm atëherë kur nuk ka ndonjë arsytim objektiv apo të arsyeshëm. Barazinë gjinore e garanton edhe dokumenti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton barazi gjinore, dhe e ndëshkon diskriminimin gjinor. Përveç kësaj, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës zbatohet drejtpërdrejtë edhe [Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas \(CEDAVË \)](#).

Të gjitha institucionet në Kosovë janë të obliguara që të zbatojnë instrumentet ndërkombëtare që zbatohen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Njësia për MD dhe Drejtat të Njeriut, gjatë vitit 2022, ka qenë e përqendruar në rastet e diskriminimit në bazë të gjinisë, dhe ka qenë mjaft e angazhuar për të ndikuar në politikat dhe proceset që e promovojnë analizimin, parandalimin dhe mbikëqyrjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut në bazë të gjinisë.

Çështja kryesore në lidhje me implementimin e Ligjit për Barazi Gjinore, po ashtu dhe rregulloren për Barazi Gjinore, është fakti se shumë faktorë që rrjedhin nga ligjet dhe traditat e lashta, si dhe problemet me të cilat përballen shoqëria, krijojnë shumë pengesa për zbatimin e drejtë dhe të duhur të këtij Ligji dhe parimeve që i përmban Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Mirëpo, megjithatë gjendja e barazisë gjinore nuk është e njëjtë nëpër të gjitha lokalitetet e komunës në lidhje me përkatësinë gjinore dhe për një shpërputhje të fuqishme gjinore në vendimmarrje, në të gjitha nivelet e hartimit, menaxhimit dhe administrimit të politikave, ku pozicioni i grave (që në numër) dhe si rrjedhojë trajtimi i nevojave specifike të tyre dhe përpjekjet për plotësimin e interesave strategjike të tyre, është i dobët.

-Meshkujt më tepër dominojnë në pozitat vendimmarrëse, ku në këtë në bazë të statistikave si vijon:

- Gjithsej të punësuar staf civil janë **1320**, prej tyre **612 F, 708 M**.
- Shefa gjithsej **21 F, dhe 24 M, gjithsej 45**.
- Prej tyre poste vendimmarrëse; **33 - drejtor të shkollave, 3- zëvendësdrejtor, 1- drejtor QKMF, 1-drejtor QPS, 12- drejtor Komunal, gjithsej 50, prej tyre 16 F drejtoresha, 34 M**.
- Një fenomen që diskriminon femrën në shoqëri, është edhe dhuna në familje. Dhunë në familje gjatë vitit 2022, janë **54 raste dhunë fizike, 47 raste 7, janë dhunë psikike, emocionale, ekonomike, dhunë seksuale nuk ka, nga QPS**.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Anti Trafikimi me qenie njerëzore

Sa i përket kësaj fushe Anti Trafikimi me qenie njerëzore nuk ka pasur raste gjatë viti 2022.

Të Drejtat e Fëmijëve

Të drejtat civile, ekonomike, sociale, kulturore dhe politike të fëmijëve duhet të mbrohen me përparësi nga çdo individ, familje dhe institucion, sepse kemi të bëjmë jo vetëm me qenie njerëzore përgjithësisht të pambrojtura, por edhe se niveli i sotëm i zhvillimit të tyre fizik e mendor, do të përcaktojë gjithsesi të nesërmen e vendit tonë.

Nisur nga ky vlerësim, Komuna e Drenasit ka marrë disa nga masat e nevojshme në përputhje me dispozitat e Konventës, por edhe për shndërrimin e dokumenteve vendore dhe atyre ndërkombëtare në aksion komunal dhe detyrues për të gjitha institucionet komunale.

Ndër të arriturat gjatë periudhës të cilën raportojmë, në fushën e të drejtave të fëmijëve do të veçonim: sensibilizimin dhe vetëdijesimin, informimin, edukimin dhe arsimimin.

Numri i nxënësve të SHFMU, është gjithsej, **11242** nxënës, **5397**, janë femra dhe **5845**, janë meshkuj, prej tyre kanë përfunduar shkollimin e mesëm **757**, nxënës, prej tyre **390 F dhe 367 M**.

Si e arritur gjatë këtyre muajve është se nuk ka pasur as një përleshje tek nxënësit lidhur me dhunën e fëmijëve në shkolla.

-Drejtorja e Arsimit Perfitures të Bursave komunale për vitin akademik 2022/2023, janë gjithsej dyqindë (200) student; prej tyre njëqindegjashtëdhjetë (160) janë Femra dhe dyzet (40) janë meshkuj.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

- **Drejtori për Shëndetësisë dhe Mirëqenies** sociale ka ndihmuar me subvencione për shërim rehabilitim **gjithsej: 51, familje** me shumën e mjeteve **8,120,00** euro prej tyre femra të ndihmuara janë **28 dhe 23 Meshkuj**.
- **Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik** ka ndihmuar 13 biznese me subvencione, shuma gjithsej 19,950.00, prej tyre **12 biznese** janë të gjinisë femërore dhe **një biznes** i gjinisë mashkullore.
- **Zyra e Kryetarit të Komunës Drenas** ka ndihmuar me subvencione gjithsej: 3 OJQ-të me shumën e mjeteve 4,000,00 euro, prej tyre OJQ të udhëhequr nga femrat të ndihmuara janë : 2 Femra 2500 euro dhe një mashkull 1500 euro.
- **Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**, ka ndihmuar 84 bujq me subvencione për ujitje të kulturave bujqësore prej tyre një kulturë bujqësore që udhëhiqet nga gjinia femërore dhe 83 kultura bujqësore që udhëhiqen nga gjinia mashkullore.
- **Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**, ka ndihmuar 105 familje me subvencione për sera shuma prej 84,779,10 euro për sera, prej tyre 59 femra dhe 46 meshkuj.
- **Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe zhvillimit Rural**, ka ndihmuar 15 familje me subvencione për hapje të puseve (bunareve) prej tyre 3 femra dhe 12 familje që udhëheqen nga gjinia mashkullore.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

-Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka ndihmuar me subvencione për aktivitete gjithsej: 33, OJQ me shumen e mjeteve 121,000.00 euro, prej tyre OJQ të udhëhequr nga femrat të ndihmuara janë: 7 femra, shuma 5300 euro dhe 26 meshkuj, shuma 115.700.00 euro.

Gjatë vitit 2022, prej të gjitha projekteve janë ndihmuar gjithsej; F– 272, dhe M- 232.

Mundësitë e Barabarta dhe Kundër diskriminimi

KNJKDNJ, ZBGJ dhe MB, këtë vit nuk është pjesë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashki këtu është një diskriminim i drejtpërdrejt në bazë të **UA.nr.27/2012 MPB 03/2012 MAPL.**

Sa i përket shërbimeve për qytetarë nga institucionet komunale, **NJKDNJ**, shpesh herë ka vëzhguar sektorë të ndryshëm dhe nga ky vëzhgim konstatohet se të gjithë qytetarët kanë qasje të barabarta, pasi që në periudhën të cilën raportohet vërehet dukshëm përmirësimi i kushteve për shërbimet ndaj qytetarëve, duke u nisur nga Sektori i Gjendjes Civile, si dhe efikasitetit më të madh të punës nga shërbyesit civil.

Sa i përket sferës së punësimit në sektorin privat, nga intervistat e drejtpërdrejta me disa punëtorë pothuaj se në shumicën e subjekteve afariste punëtorëve u shkelen të drejtat në punë. Ata nuk pajisen me kontrata të punës, nuk kanë orar të punës sipas ligjeve në fuqi, me përjashtim të një numri të vogël të bizneseve.

Nuk u lejohej që të shfrytëzojnë pushimet vjetore dhe të tjera sipas ligjeve në fuqi, mirëpo vetëm ashtu si vendosin menaxherët e tyre. Vërehet se në komunën e Drenasit ashtu si edhe në tërë vendin është mese prezentë papunësia.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Krijimi i një mjedisi shoqëror i cili do të siguronte për respekt të gjitha të drejtat njerëzore të personave me paaftësi dhe zbatimin e standardeve të OKB-së në mundësi të barabarta për të gjithë personat me paaftësi, përmes mbështetjes psiko-sociale të gjithë personave me forma të ndryshme paaftësish dhe anëtarët e familjeve të tyre, janë kushte për krijimin dhe zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe njerëzore.

Një shoqëri e tillë është e detyruar të sigurojë për personat me paaftësi një mundësi për integrim të plotë dhe të drejta të barabarta si të gjithë qytetarët tjerë.

Të dhënat dhe njohuritë statistikore për pozitën e personave me aftësi të kufizuara janë të pakta. Aktualisht ato reduktohen në numrin e personave me aftësi të kufizuara, ndarjen e grup moshave në baza gjinore.

Sa i përket analizës së pjesërishtme të PAK-ve, nga tregues statistikorë janë gjithsej të evidentuar **1250** persona me aftësi të kufizuara fizike, **40% F, 60% M, 30 % fëmijë**. Sa i përket personave me aftësi të kufizuar mendore, në komunën e Drenasit nuk kemi evidencë, gjithashtu edhe i personave të verbër dhe shurdhmemec. Nga takimet që kemi pasur me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, vërehej se ata vuajnë nga përjashtimi dhe diskriminimi në shoqëri.

Në komunën e Drenasit ka të evidentuar mëse **56** fëmijë me aftësi të kufizuara të cilët ndjekin mësimin e rregullt, prej tyre 27 meshkuj dhe 29 femra prej tyre 8 fëmijë janë në Qerdhen “Ardhmëria” në Drenas dhe në Komoran. Disa nga prindërit e fëmijëve deklarojnë se jetojnë në një gjendje tejte të vështirë ekonomike dhe është e pamundur për ta sigurojnë shkollimin e fëmijës. PAK-të, përballen me probleme të shumta, për shumicën e njerëzve me Aftësi të Kufizuar mjedisi i ndërtuar është i papërshtatshëm për lëvizje dhe në këtë mënyrë u pamundësohet pjesëmarrja në jetën ekonomike, Sociale dhe në kryerjen e shërbimeve të përditshme.

Komuniteti i personave me aftësi të kufizuara është pjesë e natyrshme e shoqërisë, ndërsa obligim i institucioneve komunale, në veçanti ata që janë kompetent në hartimin dhe implementimin e politikave dhe projekteve, një kujdes të konsiderueshëm t’u kushtojnë njerëzve me aftësi të kufizuara, për t’u krijuar mundësi të barabartë dhe qasje pa pengesa në të gjitha objektet e infrastrukturës publike dhe private.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Përmbledhje e Aktiviteteve të Njesisë për MD dhe të Drejtat e Njeriut për periudhën Janar – Dhjetor 2022

* Njësia komunale për MD dhe të Drejtat e Njeriut, për periudhën Janar – Dhjetor 2022, në version të shkurtër paraqet disa nga aktivitetet: Ku në bazë të plan-programit me arsyetim të projekteve që i kemi bërë sipas kushteve dhe mundësive të buxhetit që posedon komuna jonë.

* **Numri i femrave dhe numri i njësive kadastrale** që kanë fituar të drejtën Pronësi/Posedim i përbashkët (e drejtë që përdoret për të regjistruar pronë në emër të dy bashkëshortëve pa përpjesë) për vitin 2022 në Komunën e Drenasit (Gllogoc) është : **129 femra dhe 169 njësi kadastrale.**

* **Takim me PAK në Handikos me 13.06.2022**, në kuadër të Projektit „Shërbime cilësore dhe multidiciplinare të bazuara në bashkësi për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të Kufizuar .

* Takim i organizuar me Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), për implementimin e Projektit Gjinia Paqja dhe Siguria.

* **Për këtë vit NJKDNJ, ZBGJ** ka hargjuar buxhet nga Komuna në shumën prej **712.00 euro**, ku e ka përkrahur me buxhet të Kuvendit Komunal nga Kryesuesi Milaim Hajdari.

* Ftesa e mbledhjes së **asamblistëve** për themelimin e Grupit jo formal të grave në Kuadër të Asamblesë Komunale e dt, **24.06.2022**, me protokoll nr. **02-060/03-29700, dt.22. 06.2022.**

- **Raport i takimit me qytetarë gra dhe burra** për informimin, procedurë e aplikimit për legalizimin e ndërtimeve pa leje i **dt.05.07.2022**, me protokoll nr.**02-052/01-33672, dt.05.07.2022.**

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

DAP- Njësia për Mbrojtje nga Diskriminimi, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në Bashkëpunim me OJQ-në Aureola, Drejtorinë e Urbanizmit dhe Programin e USAID për Qeverisjen Ekonomike në Kosovë (Kosovo Economic Governance Activity), ka organizuar takim qytetarë, gra dhe Burra nga fshatrat e Komunës së Drenasit në kuadër të projektit.

Temë e diskutimit ishte informim mbi procedurën e aplikimit për legalizim të ndërtimeve pa leje, bazuar në Ligjin Nr. 06/L-024, për trajtimin e ndërtimeve pa leje, të cilin organizata joqeveritare OJQ “Aureola” e Projekti është i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, si dhe i realizuar nga shoqata “Aureola” Dega në Prishtinë. Takimin e hapi drejtoresha Flutra Avdiu ku ja kaloi fjalën e përfaqësueses nga shoqata “Aureola” Florentina Hoti.

E cila ja dha fjalën përfaqësueses nga USAID për shpjegimin e procedurave për aplikim për legalizim, dokumentet e nevojshme për aplikim, afati me ligjin aktual për aplikim dhe çështjet tjera që ndërlidhen me këtë proces. Po ashtu, gjatë këtij takimi pati pyetje nga qytetarët dhe përgjigje nga përfaqësuesja e USAID të cilat ndërlidhen me procesin e aplikimit për legalizim.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Foto nga takimi me qytetarë më 05.07.2022, në Sallën e Kuvendit nga ora 10.00 -11.00.



2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Të gjithë pjesëmarrësve ju shpërndanë maica, çanta dhe fletëpalosje me logo të legalizimit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Komunës së Drenasit dhe shoqatës të cilat ishin punuara nga shoqata Aureola. Pjesëmarrës në ishin: Gratë burrat dhe vajzat, aktiviste të ndryshme, qytetarë nga fshatrat e ndryshme të Komunës së Drenasit. Raporti i bashkëngjitet edhe lista e pjesëmarrësve në takim me qytetarët për legalizim të pronave pa leje. Pjesëmarrës në takim 16 (gjashtëdhjetë) femra dhe 7 (shtatë) meshkuj.

- Ftesa e trajnimit e trajnimit për procedurat standarde kundër Dhunës në Familje e dt,02.08.2022, me protokoll nr. 02-060/03-39022, dt. 29.07.2022.
- Raport i trajnimit Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga dhuna në Familje i dt.02.08.2022, me protokoll nr.02-052-39849.
- Njësia për Mbrojtje nga Diskriminimi Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore në Bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës ka organizuar trajnim, ku ka organizuar takim me zyrtar të institucioneve të Komunë së Drenasit, të cilat i trajtojnë rastet e dhunës në Familje.

Temë e diskutimit ishte „Rrugët Ligjore që duhet të ndiqen në rastet kur shkelen të drejtat e grave, burrave, fëmijëve dhe pleqëve lidhur me dhunën në familje . Projekti është i financuar nga Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Qeverisë dhe i menagjuar në bashkëpunim me Koordinatorën e NJMDDNZBGJ dhe MB Komuna Drenas.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Foto nga Trajnimi për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga dhuna në Familje me 02. 08. 2022, në Restorant 74, nga ora 9.30 deri në 14.00.



2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Qëllimi i këtij takimi, ishte për t'i trajnuar stafin e institucioneve që merren me trajtimin e rasteve të dhunës në familje për **Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje**. Moderatore e takimit ishte Koordinatorja e Njësitit për drejta të njeriut, zyrtare për Barazi Gjinore Zahrie Podrimqaku - Subashi nga Komuna e Drenasit, e cila e bëri prezantimin e takimit si dhe të pjesëmarrësve. Gjithashtu foli rreth punës dhe procesit të hartimit të strategjisë Komunale kundër dhunës në Familje dhe Mekanizmin e dhunës në familje ku në komunën tonë nuk është i formuar për arsye se kam qenë e transferuar që nga 1 marsi i vitit 2019 në zyrën e informimit.

Për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga dhuna në Familje, ka folur Leunora Selmani nga Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Qeverisë së Kosovës.

Nga QPS mori fjalën zyrtari Florjan Meha ku sqaroi se si në QPS në bashkëpunim me policin si i trajtojnë rastet të cilat lajmërohen qoftë në stacionin policor ose në QPS.

Gjithashtu nga policia foli zyrtarja policore Nazmije Rrukiqi e cila sqaroi procedurat e trajtimit të rasteve se si vepron policia tek të gjitha rastet, dhe bashkëpunimin që kanë me strehimoren dhe QPS-në.

Kishte diskutime edhe nga Drejtoria e arsimit lidhur me dhunën në shkolla si dhe nga drejtoret e shkollave, gjithashtu nga QKMF dr. Edona Mehaj dha sqarime se si vepronin mjekësia me rastet që paraqiten tek mjeku nëse lajmërohen si raste të dhunës në familje apo edhe nëse dyshohen se kanë pasur dhunë në familje.

Në fund të trajnimit u bënë përmbledhjet dhe rekomandimet nga pjesëmarrësit, ku mbajtëm premtimin se do të bëjmë iniciimin për formimin e mekanizmit për dhunën në familje dhe përpilimin e strategjisë Komunale kundër dhunës në Familje.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Në fund të trajnimit u bënë përmbledhjet dhe rekomandimet nga pjesëmarrësit, ku mbajtëm premtimin se do të bëjmë iniciimin për formimin e mekanizmit për dhunën në familje dhe përpilimin e strategjisë Komunale kundër dhunës në familje.



Të ftuar në trajnim ishin përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale, Njësi për trajtimin e rasteve të dhunës nga Stacioni Policor Drenas, përfaqësuesit nga Gjykata, drejtorë të shkollave të mesme dhe fillore, zyrtar për ndihmë juridike falas, përfaqësueset e Organizatave joqeveritare, Zyra për Komunitete dhe Kthim, drejtoria për arsim, drejtoria për shëndetësi etj.

Të gjithë të pranishmeve ju shpërndanë materiale, që kanë të bëjnë me trajtimin e dhunës në Familje.

Të gjithë të pranishmit ju shtrua drekë, në Restaurant ”74” në Drenas, ku pjesëmarrës ishin 13 vetë në takim.



2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

- * Takim për Barazi Gjinore në Hotel Pallas i organizuar nga MPL me 13,dhe 14.09.2022, në Mitrovicë.
- * Tryezë diskutimi kundër Dhunës në Familje me dt. 19. 09. 2022, e organizuar nga organizata “Humas Vita”, Drenas.
- * Përpilim i Rregullores së Grupit të Grave Asambleistë të Komunës së Drenasit e miratuar me dt.05.10.2022, nr. 02-052/01-50859, i dt. 05.10.2022.

- * Kërkesë për blerje të videoprojektorit për aktivitete të NJDNJZBGJ, nr.02-070/01-52258, dt.12.10.2022
- * Njoftim për Hapjen e Fushatës kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore i dt.17.10.2022 me protokoll: 02-070/03-53136.
- * Kërkesë për DAP për pagesen e projektit “25 Nëntor-Dita Ndërkomtare Kundër Dhunës në Familje” e dt.31.10.2022, me protokoll nr : 02-070/01-56687.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

- Raport i Fushatës për trafikim të qenieve Njerëzore, nga dt. 18.10.2022 deri me dt.17.11.2022 protokolli, 02-060/04-60208, datës 18.11.202, protokolli, 02-052/01-61724, i datës 29.11.2022
- Plani i Punës për vitin 2023- Njësia për mbrojtje nga diskriminimi dhe drejtat e Njeriut për Barazi Gjinore, protokolli nr. 02-030/01-61904, dt.30.11.2022
- Ftesa dhe agjenda për tryezë për ditën ndërkombëtare kundër dhunës në familje, protokolli nr: 02.060-62064 i dt. 01.12.2022.
- Njoftim DAP për organizimin e Ditës Ndërkombëtare Kundër Kancerit të Gjirit pr. 02-070/03-5387, dt. 07.10.2022.
- Kërkesë Kryesuesit të Kuvendit për organizimin e Ditës Ndërkombëtare Kundër Kancerit të Gjirit, protokolli; 02-400/01 - 53785, i dt. 19.10.2022.
- Ftesa për Ditën Nderkombëtare Kundër Kancerit të Gjirit, 21 Tetor 2022 e dt,21.10.2022, me protokoll, 02-060/03-51532, 07.10.2022.
- Kërkesë për blerje të videoprojektorit e dt,12.10.2022, me protokoll,02-070/01-52258.
- Raport i Kampanjës-fushatës 21 Tetor 2022 – Dita Ndërkomtare Kundër Kancerit të Gjirit me protokoll: 02-052/01-54914, dt. 24.10.202.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

- Takimin e fushatës e shpalli të hapur organizatorja KNJKDNJ, ZBGJ- Zahrie Podrimqaku Subashi me një fjalë rasti dhe tha unë ju garantoj se do të jemi krah jush në çdo nismë sensibilizuese për parandalimin e kancerit të gjirit dhe jo vetëm.

Do të mbështesim çdo iniciativë që lufton kërcënimet e shëndetit, jetës dhe mbarë shoqërinë tonë. Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër kancerit të gjirit, si dhe në vazhden e aktiviteteve që po mbahen për parandalimin e kësaj sëmundje gjatë muajt tetor, që njihet ndryshe edhe muaji kundër kancerit të gjirit nga KNJKDNJ, Zyrtarja për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Grupin e Grave asambleiste dhe Komitetin për Barazi Gjionore është organizuar një Ligjëratë me temë „Kanceri i Gjirit dhe Parandalimi i tij”, të cilën në aspektin profesional e ka mbajtur Kardiologu Dr. Shkelzen Gashi nga QKMF Drenas. Të pranishëm përpos grave pjesëmarrëse ishin, Grupi i Grave Asambleiste, KBGJ, Zonja e parë e Komunës - Shemsie Lladrovci, Maturantët e Mjekësisë të SHMP “Fehmi Lladrovci”. Me një fjalë rasti të pranishmit i përshëndeti dhe Kryetarja e Grupit të Grave Asambleiste Valentina Leku - Gashi mori fjalën i përshëndeti gratë në emër të Asamblesë Komunale të Komunës së Drenasit .

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Foto nga Ligjerata me temë „ Kancerit i gjirit dhe parandalimi i tij”, në Sallën e Kuvendit.



2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Pas ligjeratës vazhduam Kampanjën – fushatën në ecjën „Një hap kundër kancerit të gjirit” me gratë e Komunës së Drenasit.



2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

- Me datën 08.11.2022, isha pjesë në Takimin avokates për Buxhetim Gjinator me Rrjetin e Grave të Kosovës, Qendresa Trshana, Rita Berisha, Jehona Topalla, Ernera Dushica, OJQ “Bliri” [Mahije Ismajli](#), Dorentina Ismaili nga Drejtoria Shëndetësisë, drejtori Arsim Haxhiu dhe Drejtoria e Financave, drejtori Shyqiri Bublaku. U diskutua për shërbimet shëndetësore për gratë dhe vajzat në QKMF në Komunën e Drenasit para, gjatë dhe pas Pandemisë.

Foto e takimit për Bugjetim Gjinator me 08.11.2022 në Sallen e Bordit të Drejtorve



2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

-Raport i fushatës 16 Ditët e Aktivizmi 25 Nëntor deri më 10 Dhjetor për Ditën Ndërkombëtare kundër Dhunës në Familje, pr. 02-052/01-63499,dt.09.12.2022.

Shënimin e 16 Ditëve të Aktivizmit, Ditës Nderkombëtare për Eliminimin e Dhunës në Familje është organizuar nga Njesia për të Drejta të Njeriut-KNJKDNJ, në bashkpunim me Komitetin për Barazi Gjinore e mbështetur dhe financuar nga Zyra e Kuvendit.

Gjatë ditëve të fushatës KNJKDNJ dhe anëtarët e komitetit vizituan institucione të ndryshme të Komunës, shkolla ku bënë shpërndarjen e Posterëve dhe të Fletëpalosjeve.

Në përmbyllje të fushatës kunder dhunës në Familje kemi organizuar tryezën e rrumbullakët, ku pjesë e tryezës ishin të gjitha institucionet.

Foto nga tryeza e mbajtur në Restorantin “Diamant” me datën 07.12.2022.



2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Pjesëmarrës dhe kontribuues në këtë aktivitet ishin: shefi i Kabinetit të Kryetarit, Skënder Berisha. Me një fjalë rasti për eliminimin e dhunës në familje, KNJKDNJ, i cili foli rreth historikut të Ditës Ndërkombëtare Kundër Dhunës në Familje, Drejtoresha e DAP, Laureta Thaqi, nga Gjykata e raportoi statistikën, fakte rreth dhunës në familje Hajrije Krasniqi, dhe sqaroi si trajtohen rastet dhe procedurat e rasteve të dhunës, zyrtarja policore Nazmije Rrukiqi nga policia e SPB Drenas, të cilët raportuan statistikën e dhunës në familje gjatë këtij viti, Qendra për Punë Sociale, drejtori Elmi Dobra, ku sqaroi trajtimin e rasteve të dhunës nga ana e QPS, anëtarët e Komitetit për Barazi Gjinore, drejtori ekzekutiv i shoqatës “Akti” Rexhep Gojnovci, zyrtar Komunal si dhe përfaqësues të OJQ-ve nga Komuna e Drenasit dhe përfaqësuesit e zyrës ndërlidhëse (LMT) KFOR-it.

Në debat diskutuan të gjithë pjesëmarrësit lidhur me shkaqet e dhunës ndaj gruas në familje në Shkollë si dhe u debatua shumë rreth shkaqeve të dhunës në familje, funksionimi i strehimoreve burimet e financimit, mungesën e veprimeve të shpejta në rastet e ndarjes së pronës trashëgimisë, divorcit alimentacionit dhe veprime tjera që shtojnë sigurinë e grave dhe vajzave në vendin tonë. Në tryezë u debatua njëra prej shkaqeve të dhunës ndaj gruas që ndodhë për shkak të gjendjes ekonomike është edhe e drejta se gratë ende nuk e gëzojnë të drejtën e trashëgimisë në prone, ku u diskutua se gratë për këtë arsye të mos realizimit të drejtës në trashëgimi nuk ndihen të sigurt në familje dhe nuk është e barabartë me burrin, ku edhe kjo është njëra prej shkaqeve.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Tryeza u financua nga Zyra e Kuvendit në shumë prej 291.⁰⁰ €, fletëpalosje 100X0.59= 59.⁰⁰€. kordele 200X020= 40.⁰⁰€, pastër 60X1.⁰⁰= 60.00 Raportit ja bashkangjisë edhe listën e pjesëmarrësve në tryezë.

Është bërë shpërndarja e pastërve dhe fletushkave nëpër të gjitha institucioneve të Komunës, si në shkollë, gjykatë, QPS etj.

-Kërkesë për 18-Tetor 17-Nëntor, hapja e fushatës Kundër Trafikimit me Njerëz, prej 18.10.2022 deri me dt. 17.11.2022.

-Raport i Fushatës për trafikim të qenieve Njerëzore, nga dt. 18.10.2022 deri me dt. 17.11.2022, protokoli, 02-052/01-61724, i datës 29.11.2022

- Raport i Fushatës kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore nga Komuna e Drenasit, Njesisë për MD dhe Drejta të Njeriut duke filluar nga 18 Tetori deri më 17 Nëntor, 2022 dhe vazhdon me aktivitete përkatëse pas fushatës.

Me 18.10.2022, kemi shpërndarë Postera dhe Fletushka në institucione të shtetit në Objektin e Komunës në Entin e Punësimit, në Njësinë e Policisë në Drenas, në Kopshtin Ardhmëria, në SHFMU „Rasim Kiçina”.

Me 19.10.2022, Kemi shpërndarë Pastër dhe Fletushka në SHPM”Fehmi LIADROVCI”, në SHML ”GJ. K-Skenderbeu ”, SHFMU ” Gani Sylaj ” në Poklek të Ri.

Më 25.10.2022, kemi shpërndarë postera dhe fletushka në SHFM ” Ali Gashi”Çikatovë e Re dhe SHFM ” Halil Bajraktari”, Drenas Il.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Dorëzimi i Plan-programit të punës për vitin 2023, pr. 02-030/01-61904, me 30.11.2022.

KNJKDNJ, kontakte të rregullta për bashkëpunim të rasteve i ka me Komitetin e Shërbimit Civil të SHPK-së , Qendrës për punë sociale, Avokatin e Popullit dhe OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare.

Në vitin në vijim KNJKDNJ, ZBGJ dhe MB, detyrat e punës do të realizon në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore, Ligjit kundër Diskriminimit, Rregullores nr.03/2017, si Njësi Kundër diskriminimit, do të vazhdon t'i realizoj programet dhe synimet e veta duke mbajtur kontakte të përhershme dhe duke kërkuar ndihmë si nga Drejtorit, zyra e Kryetarit po ashtu MAPL , ZQM edhe nga Agjencinë për Barazi Gjinore në kuadër të Qeverisë.

Vështirësitë dhe pengesat

Krahas sukseseve të arritura në këtë vit ne kemi pasur edhe pengesat të ndryshme të cilat kanë ulur shkallën e suksesit të përgjithshëm të punës; disa nga vështirësitë po veçojmë: Pengesat për buxhet të pa mjaftueshëm sipas plan programit të punës së NJKDNJ –ut dhe

ZBGJ për realizimin e projekteve, Mos njoftimi zyrtar për prezantim në mbledhjet e bordit të drejtorëve

dhe stafit të lartë, në caktim të monitoronit të komisioneve të ankesave të qytetarëve, në grupet e

ndryshme punuese ndër-komunale, dhe gjithashtu në hartimin e legjislacionit dhe politikave komunale.

Mos përkrahja e pjesëmarrjes me ftesa zyrtare në vizita studimore dhe seminareve në kuadër të punës me ftesa zyrtare nga niveli qendror.

2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

- * Strategjitë e tejkalimit të vështirësive dhe pengesave
- * Prezantimi në mbledhjet e organizuara nga komuna për shkak të monitorimit të shkeljeve të drejtave rreth diskriminimit të dy gjinive.
- * Përkrahja e projekteve të Aktiviteteve të parapara në bazë të plan programit të Punës.
- * Ndarja e buxhetit për zyre sipas plan-programit për realizimin e projekteve për vitin 2022/2023, Rregullores nr.03/2017 si dhe Ligjit për Barazi Gjinore.
- * Kontaktet me institucionet tjera rreth bashkëpunimit të punës.

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Raporti i punëve të kryera gjatë vitit 2022 në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme bazohet në Planin e Punës i cili është zbatuar në përpikëri nga menaxhmenti duke ofruar shërbime cilësore, të shpejta dhe të avancuara për qytetarët e komunës së Drenasit.

Raporti paraqet në vija të trasha punët kryesore të Drejtorisë të cilat janë të ndarë në sektorë si: Qendra për Shërbim me Qytetar (QSHQ), Sektori i Gjendjes Civile (ZGJC), Zyra e Prokurimit, Arkivi Komunal, Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta.

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

I. QENDRA PËR SHËRBIM ME QYTETARË


Gjatë vitit 2022, Qendra për Shërbim të Qytetarëve përmes sistemit elektronik ka ofruar të gjitha shërbimet për qytetarët, ka pranuar dhe regjistruar të gjitha lëndët që u janë drejtuar organeve komunale. Bazuar në rregullativën ligjore, Qendra për Shërbim të Qytetarëve pra ka përmbushur të gjitha objektivat e parapara me planin e punës, për organizimin dhe funksionalizimin e QSHQ-së. Përkatësisht, Qendra për Shërbim të Qytetarëve gjatë periudhës 01/01/2022-22/12/2022 ka regjistruar gjithsej 27,234 lëndë të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese, siç janë:

Janar: janë regjistruar	2.049 lëndë të ndryshme;
Shkurt:	1.975 lëndë;
Mars:	2.181 lëndë;
Prill:	1.939 lëndë;
Maj:	2.308 lëndë;
Qershor:	3.970 lëndë;
Korrik	2.733 lëndë;
Gusht	2.708 lëndë;
Shtator	873 lëndë;
Tetor	2.804 lëndë;
Nëntor	2.235 lëndë;
Dhjetor, deri më 22.12.2022-	1459 lëndë;

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Numri i lëndëve në QSHQ gjatë vitit 2022



3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

II. GJENDJA CIVILE

Nga sistemi i Gjendjes Civile janë lëshuar **40335** dokumente, nga e- kioska **1434** dokumente, gjithsej dokumente nga shërbimin e gjendjes civile janë lëshuar **41,769**.

Lloji i dokumentit	Numri
Ekstrate të lindjes	20610
Certifikata të lindjes	7103
Certifikata të martesës	4879
Certifikata të vdekjes	1188
Certifikata të vendbanimit	541
Certifikata të shtetësisë	323
Certifikata e statusit martesor	1274
Certifikata të bashkësisë familjare	3974
Vërtetima nga arkiva	470
Certifikata të anuluar	587
Certifikata nga E-kioska	1434
TOTALI:	41,769 copë

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Statistika e regjistrimit të ZGJC-Gllogoc: Regjistrim i lindjeve të rregullta dhe me vonesë gjithsej 85 lindje, verifikimi në sistem gjithsej 198, rishkrim lindje 43, regjistrimi qytetarit 4, martesë të rregullta dhe jashtë vendit gjithsej 195, rishkrim martese 123, shkurorëzime 26, anulime teknike 0, martesë me element të huaj gjithsej 23 ,regjistrime vdekje të rregullta dhe me vonesë gjithsej 105,regjistrim i qytetarit të vdekur 33.

Statistika e regjistrimit të ZGJC-Komoran, lindje të rregullta dhe me vonesë gjithsej 26, verifikim në sistem gjithsej 17, rishkrim lindje 7, regjistrim i qytetarit 4, martesë të rregullta dhe jashtë vendit gjithsej 129, rishkrim martese në sistem gjithsej 83, shkurorëzime 17, me element të huaj 12, vdekje të rregullta dhe me vonesë gjithsej 37,regjistrim i qytetarit të vdekur 0.

Statistikat e regjistrimit të ZGJC-Dobroshec ,lindje të rregullta dhe me vonesë 6, verifikime në sistem gjithsej 79, rishkrim lindje 6, regjistrim i qytetarit 1, martesë të rregullta dhe jashtë vendit gjithsej 36, rishkrim martese 35, shkurorëzime 6, martesat me shtetas të huaj 2, anulime teknike 1, vdekje të rregullta dhe me vonesë 26, regjistrimi i qytetarit të vdekur 11.

Statistika e regjistrimit të ZGJC-Tërstenik, lindje të rregullta dhe me vonesë gjithsej 12,verifikime në sistem gjithsej 77, rishkrim lindje 7, martesë të rregullta dhe jashtë vendit 62, rishkrim martese 34, shkurorëzime 12, anulime teknike 0, me element të huaj 2, vdekje të rregullta dhe me vonesë 27, regjistrim i qytetarit të vdekur 63.

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Statistika e regjistrimit të ZGJC-Arllat, lindje të rregulla dhe me vonesë gjithsej 13, verifikime në sistem gjithsej 83, rishkrim lindje 7, martesa të rregullta brenda dhe jashtë vendit 33, rishkrim martese 40, shkurorëzime 8, martesa me shtetas të huaj 3, vdekje të rregulla dhe me vonesë 38, regjistrim i qytetarit të vdekur 14.



Statistika e regjistrimit të ZGJC- Abri e Epërme, lindje të rregullta dhe me vonesë gjithsej 8, verifikime në sistem gjithsej 60, rishkrim lindje 3, regjistrim i qytetarit 0, martesa të rregullta dhe jashtë vendit gjithsej 21, rishkrim martese 17, shkurorëzime 3, me element të huaj 2, vdekje të rregullta dhe me vonesë 11, regjistrim i qytetarit të vdekur 4.

-Kërkesa për humbje të shtetësisë së Kosovës.....55

-Kërkesa për fitim të shtetësisë së Kosovës.....5

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

III. SEKTORI I LOGJISTIKËS

Udhëzimi i palëve

Gjatë vitit 2022 kanë qenë rreth 2539 qytetarë që kanë kërkuar shërbime në drejtoratet komunale vetëm në katin II, të cilët janë regjistruar në evidencë.

Shpërndarja e postës

Postieri ka shpërndarë postën për të gjitha Drejtoritë/Zyrat komunale, ku gjatë vitit 2022 ka shpërndarë 2888 shkresa të ndryshme (vendime, aktvendime, ftesa, kërkesa, ankesa etj) nëpër të gjitha fshatrat e komunës së Drenasit dhe në institucionet e ndryshme në Prishtinë.

Fokistet/sigurimi i brendshëm/mirëmbajtës:

Kanë bërë mirëmbajtjen e klimës për objektin komunal, kanë bërë mirëmbajtjen e parkut, ka përcjellur punën e nxemjës për objektin e komunës si dhe punë e detyra tjera brenda dhe jashtë objektit të komunës sipas kërkesave dhe nevojave, (brenda objektit të komunës).

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

III. SEKTORI I LOGJISTIKËS

Udhëzimi i palëve

Gjatë vitit 2022 kanë qenë rreth 2539 qytetarë që kanë kërkuar shërbime në drejtoratet komunale vetëm në katin II, të cilët janë regjistruar në evidencë.

Shpërndarja e postës

Postieri ka shpërndarë postën për të gjitha Drejtoritë/Zyrat komunale, ku gjatë vitit 2022 ka shpërndarë 2888 shkresa të ndryshme (vendime, aktvendime, ftesa, kërkesa, ankesa etj) nëpër të gjitha fshatrat e komunës së Drenasit dhe në institucionet e ndryshme në Prishtinë.

Fokistet/sigurimi i brendshëm/mirëmbajtës:

Kanë bërë mirëmbajtjen e klimës për objektin komunal, kanë bërë mirëmbajtjen e parkut, ka përcjellur punën e nxemjës për objektin e komunës si dhe punë e detyra tjera brenda dhe jashtë objektit të komunës sipas kërkesave dhe nevojave, (brenda objektit të komunës).

Mirëmbajtja e veturave dhe shpenzimet

Mirëmbajtësi i Automjeteve gjatë vitit 2022 ka furnizuar 266 vetura zyrtare me karburant, si dhe furnizime për gjeneratorë dhe nxehje, të cilat i gjeni të detajizuar sipas muajve në tabelën e mëposhtme. Gjatë vitit 2022 janë pajisur drejtoritë/zyrtaret me vetura zyrtare sipas kërkesave të tyre përmes e-mailit.

Për nxemje 763.01 litra, gjenerator 656 litra, Kosa e barit 20 litra, për stadium 88 litra, dhe për të gjitha veturat e komunës nga data 01.01.2022-30.12.2022 janë shpenzuar 13.605.01 litra.

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

IV.– FREE BALANCE, SISTEMI E-PASURIA, SISTEMI E-DEPOSË

Freebalanc

Zyrtarja për pranim-Freebalanc ka bërë është bërë pranimi dhe evidentimi i të gjitha pagesave nga drejtoritë komunale. Raporte të pranimit nga freebalanc- GRNS janë nxjerrë gjithsej 791 raporte, gjatë vitit 2022.

E-Depo

Zyrtarja për E-depo ka bërë shkarkimin dhe ngarkimin me inventarit jashtë përdorimit sipas kërkesave të zyrtareve. Është bërë regjistrimi i 1269 artikujve prej tyre më 985 asete në vlerën 108.519.23. Ndërsa artikuj të ndryshëm më materiale të ndryshme, materiale zyrtare shpenzuese, 284 artikuj të ndryshëm, janë shkarkuar gjithsej 368 asete ku shumica prej tyre kanë qenë jashtë përdorimit.

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

V. ZYRA E PROKURIMIT

Gjatë periudhës 01.01.2022 deri më 31.12.2022 në Zyrën e Prokurimit Publik janë bërë kërkesa për inicim të procedurave nga të cilat:

1. Administrata komunale 110

Nga këto kërkesa kjo Zyrë ka zhvilluar **141 procedura ne Sistem të E-prokurimit**, prej tyre për:

1. Vlera minimale 9
2. Kuotime të çmimeve 24
3. Procedura të hapura 60
4. Procedure me Negociata dhe Aneks Kontrata 9
5. Procedura Minitender 7

Janë nënshkruar **108 kontrata**, prej tyre:

1. Kontrata me vlerë minimale 9
2. Kontrata me vlerë të vogël 24 dhe
3. Vlera të mesme 53 dhe të mëdha 7 (Furnizime , shërbime dhe punë)
4. Procedure me Negociata dhe shtesë 9

d) Anulime (20) dhe Ri-tenderime (25) të njoftimeve për kontratë dhe 2 procedura ne OSHP dhe 2 procedura ne Proces te vlerësimit.

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

VI. ARKIVI KOMUNAL

Në vitin 2018 kemi filluar Arkivimin e Lëndëve sipas ligjit dhe UA-ve në fuqi, ku lëndët duhet të arkivohen në mënyrë Fizike dhe Elektronike. Secila Drejtori ka obligim ligjor që lëndët e përfunduara të kthehen në arkivin komunal për ruajtjen e mëtutjeshme. Mirëpo edhe për kundër faktit që kemi dhënë sqarime të nevojshme ligjore dhe teknike edhe në vitin 2022 kthimi i Lëndëve për arkivim Fizik, nuk është i mjaftueshëm nga ana e Drejtorive, krahasuar me vitin 2021, kemi 698 lëndw mw pak.

Baza Ligjore:

- Ligji nr. 2003/7, për Lëndët Arkivore dhe Arkivat,
- Ligji nr. 04 / L-184 për Administrimin e Punëve në Zyrë.
- Udhëzimi administrativ [MAP] nr-01/2017 për administrimin e punëve në Zyrë ,evidencat themelore dhe detyrat e punës së Arkivistit,
- Rregullore [MAP]nr. 01/2015 për shenjat e klasifikimit të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre.

Ne vazhdim po e paraqesim në mënyrë tabelare numrin e lëndëve që janë kthyer për arkivim në mënyrë fizike sipas Programeve dhe Drejtorive.

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

1.	Zyra e Kryetarit te Komunës	380	Lëndë
2.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme dhe Zyra e Kuvendit	1.189	Lëndë
3.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	0.00	Lëndë
4.	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	0.00	Lëndë
5.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	592	Lëndë
6.	Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	639	Lëndë
7.	Drejtoria për Kadastër ,Gjeodezi dhe Pronë	0.00	Lëndë
8.	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	60	Lëndë
9.	Drejtoria për Arsim	0.00	Lëndë
10.	Drejtoria për Kulturë, Rrini dhe Sport	0.00	Lëndë
11.	Drejtoria e Inspektionit	1.202	Lëndë
12.		0.00	Lëndë
13.	Drejtoria për Shërbime publike dhe Emergjencë	0.00	Lëndë
14.	Zyra për Komunitete dhe kthim	0.00	Lëndë
15.	Drejtoria për Infrastrukturë Lokale	171	Lëndë

Gjithsej-----4233 Lëndë

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Numri i lëndëve të arkivuare në mënyrë fizike për të gjitha programet për vitin 2022 është 4233, krahasuar me vitin 2021 kemi 466 lëndë me pak. Ndërsa, numri i lëndëve të arkivuara në mënyrë elektronike për të gjitha programet për vitin 2022 është 31551, i përafërt me vitet e kaluara. Sektori i arkivit kryen edhe punë tjera në shërbim të qytetarëve si vijon:

1. Deklatatë për ushqim për vitin kalendarik [mbajtës i familjes], për Bashkatdhetarë për të gjitha shtetët.
- 2 Certifikatë për shtesa të fëmijëve ,për Punëtorët që kanë punuar në shtetet e huaja.
3. Vërtetim mbi jetën për të gjithë bashkatdhetarët.
4. Deklaratë e udhëtimit për shtetas të huaj.
5. Legalizimin e të gjitha dokumenteve nga origjinali.

Për këto shërbime ne vitin 2022 kemi proceduar 691 lëndë.

Drejtoritë dhe Programet të cilat nuk i kanë kthyer lëndët në mënyrë fizike për arkivim (që sipas Ligjit janë të obliguar), ne nuk mbajmë përgjegjësi. Janë mbyll te gjitha librat e protokollit në fund te vitit 2022, dhe i kemi vendosur librat e reja për vitin 2023-sipas udhëzimit Administrativ për këtë lëmi. Në vitin 2022 Sektorit te arkivit ju ka nda një zyre e veçantë duke krijuar kushte më të mira për punë në këtë Sektor, e sidomos eshë rritur siguria për ruajtjen e Lëndëve të Arkivuara.

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

VII. ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL

Kuvendi i Komunës së Drenasit gjatë periudhës **Janar- Dhjetor 2022** ka organizuar dhe mbajtur mbledhjet për Komitetin për Politik e Financa dhe mbledhjet e Kuvendit Komunal.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor **2022**, Kuvendi Komunal ka mbajtur **gjithsejtë 17 mbledhje**:

Prej tyre **11 mbledhje** të rregullta të Kuvendit, **mbledhje** Solemne **4**, **mbledhje** Urgjente **0** dhe **mbledhje** të jashtëzakonshme **2**, mbledhje Inauguruese **0**.

Për (11), mbledhje të rregullta të organizuara të Kuvendit janë shqyrtuar (120) njëqind e njëzet pika të rendit të ditës, (12) dymbëdhjetë pika për mbledhje **solemne**, mbledhje të Jashtëzakonshme (10), dhjetë pika të rendit të ditës, gjithsejtë (142), njëqindedyzetedy pika.

Nga incizimet e seancave të Kuvendit janë bërë gjithsejtë 34-procesverbale, prej tyre tri (3) procesverbale të vitit 2021, njëmbëdhjetë (11), të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit, njëmbëdhjetë (11) të mbledhjeve të KPF-ca, një (1) të mbledhjes të jashtëzakonshme ,dhe tetë (8) procesverbale të mbledhjeve nga dëgjimet buxhetore. Sipas raportit të dt. 30.12.2022, Nr. 02-052/01-67071, akteve të miratuara në Kuvendin Komunal të Drenasit janë gjithsejtë shtatëdhjetenëntë (79) akte prej tyre, Vendime shtatëdhjeteshtatë (77), dy (2) Rregullore.

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

VII.ZYRA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Duke e bazuar në zhvillimin dhe avancimin e shërbimeve dixhitale dhe modernizimi i shërbimeve komunale, ne i kemi dhënë prioritet në ngritjen e këtyre shërbimeve. Duke përdorur shërbimet dixhitale, qytetareve u është lehtësuar marrja e shërbimeve. Tani qytetari duke përdorur platformën e re të ueb faqes, i mundësohet informimi me rrjedhjen e zgjidhjes së kërkesës së tij drejtuar organeve komunale po ashtu në Intranet është aktivizuar edhe përgjigjeje me sms për qytetaret me rastin e informimit për kryerjen e shërbimit nga komuna.

Implementimin e proceseve të e-shërbimeve dhe aplikacioneve në komune si:(Intraneti, Ueb-faqja, SMAED-i, SIMBNJ-a, SVMP-ja, e-Arkiva, e-Pasuria, GJC, Arka, etj.) ka lehtësuar punën për zyrtarë dhe qytetarë duke ju ofruar me të lehta dhe me të shpejta. Kemi mbështetur dhe trajnuar stafi për përdorimin e aplikacioneve dhe platformave dixhitale. Është menaxhuar me rrjetin shtetërorë në institucionet komunale, sistemin e TI-ve , dhe proceseve të qeverisjes elektronike në administratën e komunës. Kemi siguruar të gjitha të dhënat që ruhen në serverët e komunës dhe DATA Qendër.

Kemi menaxhuar, mirëmbajtur dhe krijuar llogarit zyrtare për zyrtarë dhe këshilltar komuna, pajisjet zyrtare janë domain. Me implementimin e aplikacioneve të E-Qeverisjes, komuna njihet monitorohet online nga MPL, si mbledhjet e kuvendit, performancën, aplikacioni i Intranetit dhe modulit të lejeve të ndërtimit. Qytetarët mund të marrin shërbimet e Gjendjes Civile në 7ditë/24 orë duke përdorur e-Kioskën, këto shërbime mund të marrin edhe nga distanca duke përdorur ueb faqen e komunës. Tani komuna ka dy e-Kioska për marrjen e shërbimeve të Gjendjes Civile në Drenas dhe Komoran. Është mirëmbajtur sistemi i telefonisë VoIP është aktiv numri i telefonit për thirrje pa pagesë për qytetaret në <tel:080013050>.

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Kam marr pjesë në grupet punuese ne ndërtimin dhe avancimin e aplikacioneve si: Intarnet, ueb faqe, Implementimi i Strategjisë së E-Qeverisja 2020-2025

Kemi mbështet stafin ne përdorimin e sistemeve dhe pajisjeve të TI-së, duke realizuar kërkesat ne fushën e TI-ve për përkrahje. Tani kur proceset për shërbime elektronike po ecin me shpejtësi, ne si zyre bashkarishtë me ASHI-në, duke shkëmbyer te dhëna për shërbimet komunale dhe duke ofruar mbështetje profesional ne platformën shtetërore E-Kosova, kemi ngritur disa shërbime te komunës qe tani mund te shkarkohen nga qytetaret pa pasur nevojë për ti frekuentuar sportelet komunale.

Tani në platformën shtetërore E-Kosova merren këto shërbime:

- Dokumentacioni i Gjendjes Civile,
- Taksa Komunale për regjistrimin e automjeteve ,
- Faturat e Tatimit ne Pronë
- Certifikata mbi të drejtat në pronën e paluajtshme
- Certifikata mbi të drejtat në pronën e paluajtshme për anëtarë të familjes
- Koordinatat e njësisë kadastrale
- Koordinatat e njësisë kadastrale për anëtarë të familjes
- Kopja e planit për njësi kadastrale
- Kopja e planit për njësi kadastrale për anëtarë të familjes

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Raporti i punës bazohet mbi punët e kryera në baza ditore të domosdoshme dhe varësisht nga kërkesat e zyrtarëve komunal. Në raportet ditore që mban zyra për teknologji informative janë të specifikuara se tek cili zyrtarë është bërë intervenimi dhe çfarë problemi ka pasur.

Punët bazike të Zyrës së IT-së gjatë vitit:

- Kontrolli në dhomën e SERVER-ave dhe mirëmbajtja e SERVERA-ve (çdo ditë në fillim të orarit të punës)
- Kontrollimi i rrjetit në Komunë dhe në Zyrat Lokale të Gjendjes Civile , QKMF, QPS, ZP, QRA dhe QKRC (çdo ditë në fillim të orarit të punës)
- Aplikimi për kërkesat e zyrtarëve në SMAED, SIMBNJ dhe kërkesa tjera.
- Dhënia e qasjes, trajnimi në përdorim në të gjitha E- shërbimet tek të gjithë zyrtaret .
- Komunikimi me ministritë varëse rreth problemeve me rrjet dhe qasjeve të cilat kërkohen nga zyrtaret.
- Instalimet, Konfigurimet me asetet e komunës (pajisjet e teknologjisë, kompjuter, server, printer, telefona etj).
- Ruajtja e shënimeve të Zyrtareve nga MAP Draiveri në DATA CENTER
- Ndryshimet në privilegjet e zyrtareve sipas kërkesave në Aplikacione
- Mirëmbajtja e llogarive zyrtare, aktivizimi i llogarive të reja.
- Menaxhimi i Activ Direcory
- Mbledhja e Kuvendit, Mbledhjet e Bordit –Transmetim, incizim, votimi elektronik, postimi në ueb faqe.

3.RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Raporti vjetor i punës në zyrën e Teknologjisë Informative : Nga Data - 03/01/2022 deri me 30.12.2022		
Zyrtari : <u>Msc.Ukë Krasniqi</u>		
Drejtoria	Kërkesa nga Zyrtari	Lloji i intervenimit - Problemit
DAP	GJC	240 intervenime
DAP	QSHQ	312 intervenime
ZK		115 intervenime
DF		222 intervenime
DI		198 Intervenime
DKRS		235 intervenime
DSHMS		324 intervenime
DGJKP		179 intervenime
DUMM		187 intervenime
DIL		212 intervenime
DBP		194 intervenime
DZHE		179 intervenime
DA		238 intervenime
DSHPE		236 intervenime

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

Raporti i punës së Drejtoratit për Arsim (DKA) paraqitur kryetarit të komunës për vitin 2022. Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Drejtorati janë realizuar gjatë kësaj periudhe më përkushtim dhe më përgjegjësi të plotë.

Me prezantimin e këtij raporti do të jeni më afër të njohur dhe të informuar sidomos në aspektin zyrtar për punën, organizimin dhe zhvillimin transparent të politikave arsimore në Drenas.

Procesi arsimor gjatë këtij viti ka qenë vazhdimisht i percjell me kujdes nga Departamenti jonë, ku të gjitha institucionet arsimore janë vizituar disa herë, si nga ana e Drejtorit, ashtu edhe nga zyrtarët e arsimit.

Në fund të **çdo muaji kemi realizuar mbledhje të rregullta me drejtorë** të institucioneve shkollore. Janë mbajtur takime të rregullta edhe me MASHTI-in, ku çdo detyrë e dhënë nga ana e tyre është realizuar me sukses nga ana jonë.

STRUKTURA ORGANIZATIVE - Këtë sektor e përbejnë 10 punëtor:

Drejtori, 1 Udhëheqës sektori administrativ,

1 Udhëheqës sektori për buxhet dhe financa,

1 Udhëheqëse e sektori për arsim,

1 zyrtar për listën e pagave,

1 zyrtar për menaxhimin e projekteve,

1 zyrtare e prokurimit,

1 depoiste-zyrtare për pranimin e mallit,

1 zyrtare për buxhet dhe financave ,

1 zyrtare për çështje pedagogjike ,

1 zyrtar për çështje psikologjike.

Drenasi ka 1 Institucion parashkollor (me 1 paralele fizike), 30 shkolla fillore dhe të mesme të ultë,(2 paralele të ndara fizike), 2 shkolla të mesme të larta, gjithsejtë 36 objekte shkollore.

Ku punojnë gjithsejtë 938 punëtor dhe ndjekin mësimin e rregullt 11535 nxënës. 54 punëtor administrativ, 753 mësimdhënës, 131 punëtor teknik.

22 punëtor në nivelin arsimor 0 (Institucioni Parashkollor),

739 punëtor në nivelin arsimor 1 dhe 2,

177 punëtor në nivelin arsimor 3.

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

Aktivitetet më të rëndësishme të realizuara :

- Mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore janë realizuar në vazhdimësi. Në këto takime është kërkuar angazhim edhe më i madh i mësimeve për ngritjen e cilësisë në arsim, respektim në përpikëri të ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve në fuqi.
- Vlerësimi i performancës së brendshme dhe të jashtme të shkollave nga vlerësimi i brendshëm (DKA) janë vlerësuar 19 drejtor/e të institucioneve publike të arsimit parauniversitare edhe nga vlerësimi i jashtëm me performancë të shkëlqyer dhe të mirë.
- Pranimi i raporteve të rregullta në baza ditore, javore, mujore, vjetore nga të gjithë drejtorët e shkollave. Interesimi dhe angazhimi i të gjithë akterëve (personelit arsimor, prindërve, nxënësve, stafit mbështetës etj.) ka qenë në nivel.
- Është realizuar studimi rapid i të gjitha shkollave me qëllim të identifikimit të pikave të dobëta në secilën shkolle në mënyrë që të jenë inpute për hartimin e strategjisë së arsimit në nivel komunal.
- Në ngritjen e cilësisë së arsimit në përgjithësi ka ngritje dhe kushte më të mira për nxënës dhe personel.
- DKA në Drenas sipas vlerësimit nga zyra e BE-së për arsim në Kosovë i prin të gjitha DKA-ve të Kosovës për respektimin, praktikimin e të gjitha rregulloreve, udhëzimeve dhe akteve tjera nënligjore si dhe për përdorimin e mekanizmave dhe strategjive për ngritjen e cilësisë në arsim.
- Nga Bashkimi Evropian fituese të projektit për vetëvlerësimin e 5 shkollave me vlerësimin e fushave të cilësisë,
- shkollat e përfshiera në këtë fazë janë : “ Arif Shala “ “ Zenel Hajdini “ “ Abedin Bujupi “ “ Halil Bajraktari “
- “ Xheladin Gashi -Plaku “ , projekt ky cili do të shtrihet edhe me shkollat tjera nga DKA-ja , në bashkëpunim me grupin e trajnerëve .
- Komuna e Drenas ka fituar çmimin në garën për “ Çmimin Evropian për Qeverisje të Shkëlqyer (ELOGE) në nivel vendi dhe e ka arritur në një nivel të lartë të qeverisjes, të krahasuar me 12 Parimet e Këshillit të Evropës në kuadër të Qeverisjes së Mirë Demokratike. Disa nga parimet prekin dhe janë përmbushur edhe nga sektori i Arsimit

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

- Drenasi tashmë i prin disa komunave në nivel vendi sa i përket sukseseve në lëndë të ndryshme shkollore, garat komunale dhe ato mbarëkombëtare .
- DKA është vlerësuar nga SIA –MASHTI për zbatueshmërinë e normativit dhe fondit të orëve, ku i prijmë të gjitha komunave të Kosovës.
- DKA është vlerësuar nga divizioni për ngritje dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve MASHTI-për suksesin e lartë të arritur dhe prijmë të gjitha komunave të Kosovës.
- Cilësia mbetet sfidë e sistemit tonë arsimor në nivel nacional dhe atë lokal, prandaj përmes projektit “Avancimi i përsheptuar i cilësisë së arsimit – Strategjia 5 vjeçare e zhvillimit të arsimit në Komunën e Drenasit”, ne kemi krijuar sinergji duke angazhuar ekspert të arsimit me qëllim që shkollat tona të jenë shkolla të Shekullit 21, të cilat do të përgatisin nxënësit tanë që të jenë konkurrent me moshatarët e tyre kudo në rajon e më gjerë.
- Mbikëqyrja në institucionet edukative arsimore, sipas objektivave të paraparë nga ana e zyrtarëve dhe drejtorit të DKA-së, ku zyrtarët kanë mbështetur stafin e shkollave me këshilla profesionale.
- Përgatitjet dhe organizimi e testeve : të arritshmerisë, maturës shtetërore -2022, testi PIRLS, testi TIMMS, testi TALIS, Testi PISA.

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

- Trajnimi “ Edukimi Shëndetësor”, i realizuar nga MASHTI- pjesëmarrës ishin mësimdhënësit e niveli arsimor 1 dhe 2 (nr. i mësimdhënësve pjesëmarrës është 144).
- Janë realizuar planifikimet për fondin e orëve të klasave me kurrikulën e re dhe zbatimi i udhëzuesit për ndarjen e orëve me zgjedhje.
- Sa i përket realizimit të fondit të orëve si dhe procedurave rekrutuese të konkurseve sipas SIA –MASHTI(regjioni i Prishtinës) DKA Drenas i prin të gjitha komunave në regjionin e Prishtinës.
- Mbatja e garave komunale në lëndën: matematikë, fizikë duke bashkëpunuar me organizatat në nivel nacional dhe kombëtare.
- Në marrëveshje me " Flutura Academy "e cila ofron trajnime profesionale (pa pagesë) për nxënës të nivelit arsimor 1,2,3 duke ju mundësuar nxënësve edhe mundësi punësimi, si dhe përmes platformës së saj është realizuar mësimi distancë gjatë muajve të pandemisë. Nga bashkëpunimi DKA- ‘Flutura Academy’ mbi 500 nxënës kanë përfituar trajnime jashtëzakonisht profesionale falas.
- Kemi marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga Parlamenti Evropian, ku gjimnazi ka qenë e vetmja shkolle jashtë vendeve të BE-së pjesëmarrëse në mesin 94 shkollave. Kemi realizuar takime virtuale me vendet si Finlanda, Gjermania, Austria, Zvicëra etj, në funksion të shkëmbimit të përvojave.
- Drejtori i DKA-së ka marrë pjesë në 5 grupe punuese në nivel të Ministrisë së Arsimit për hartimin e udhëzimeve Administrative të cilat janë në proces.
- Pjesëmarrje dhe prezantim në konferencën për ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së arsimit në Kosovë ,e cila Konferencë ishte e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës me temën “ Arsimi parauniversitar: menaxhimi dhe perspektivat në nivel komunal”.

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

- Nxënësit e Gjymnazit "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" kanë marr pjesë në gara kombëtare dhe ndërkombëtare (Gara ndërkombëtare në Schöenberg-Gmünd të Gjermanisë inovacion dhe teknologji Gara dhe projekte të përbashkëta me disa gjymnaze nga Kosova, Finlanda e Gjermania, Vlerësime të larta nga organizatorët dhe mësuesit nga konferenca, seminare e punëtori ndërkombëtare, Rezultate të larta në seminare dhe konferenca ndërkombëtare).
- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet ALLED 2 -Projekti" Harmonizimi i Arsimit dhe Aftësisë me nevojat e Tregut të Punës-faza II-të", ku si rrjedhojë e këtij memorandumi SHMLP "Fehmi Lladrovci" lidh 48 kontrata me biznese të ndryshme, ku nxënësit përfitojnë përvoja të ndryshme.
- Këtë vit DKA e ka siguruar transportin e nxënësve, i cili transport e lehtëson udhëtimin e nxënësve në biznese të ndryshme për të realizuar praktiken profesionale.
- Festa e fëmijëve "1 Qershori", (Aktiviteti është realizuar në bashkëpunim me DKRS, Hendikos në Drenas).
- Mbatja e ligjëratave në shkollë nga psikologu komunal në bashkëpunim me policinë e Kosovës, lidhur me parandalimin e dukurive negative të nxënësit dhe të rinjtë (ligjëratat me tema specifike janë mbajtur çdo muaj, me fokus grupe).
- Karvani 23 i shkrimtarëve (bashkëpunim me DKRS), pjesëmarrës ishin 150 nxënës e 30 institucioneve arsimore publike parauniversitare.
- Publikimi i konkurseve dhe regjistrimi i fëmijëve si dhe nxënësve në institucionet arsimore si: institucioni parashkollor, në klasat e para (1) , (40 klasa të para , nr. i nxënësve planifikohet deri në shtator të përfshihen 899) dhe të klasave e dhjeta (10) shkollat e mesme të larta.
- Drejtori i drejtorisë komunale të Arsimit gjatë kësaj periudhe ka pasur takime bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku janë shtruar tema të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin, mbështetjen dhe avancimin e procesit mësimor dhe reformave në arsim: Ekspert të arsimit nga BE, Fakulteti i Edukimit, përfaqësuesit e GIZ-it, për sa i përket trajnimeve dhe zhvillimit profesional të mësuesve ,Caritasi Zvicëran, QAPA,EDUMEN.

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

- Futja e të dhënave statistikore për numrin e fëmijëve dhe personelit, në sistemin EMIS-MAShTI.
- Futja e dokumenteve (diplomë, kopja e letërnjoftimit , kontrata e punës , përvoja e punës) në sistemin e SIMBNJ(Sistemin e informacionit të menaxhimit dhe burimeve njerëzore në kuadër të MPB.
- Plotësim ndryshim i rregullores për nderjen e subvencioneve(ku përfshihen edhe subvecione për nxënës dhe student).
- Në mënyrë të vazhdueshme bëhet integrimi në institucione arsimore dhe trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Në fushën e psikologjise gjatë punës së vazhdueshme profesionale në vitin 2022 kemi mbajtur trajnime për vetëdijesim të nxënësve lidhur me parandalimin e dukurive negative, në të gjitha shkollat kemi mbajtur në formë rotative trajnime me tema të rëndësishme të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e tyre, si;

1.Bullizmi dhe masat parandaluese, 2. Pasojat e narkotikeve, 3. Dhuna në Familje, 4. Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të Internetit, 5. Parandalimi i ngacmimeve Seksuale dhe masat ndëshkimore ligjore, 6. Respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, 7. Siguria e qarkullimit të këmbësorëve në trafik, 8. Ruajtja e ambientit dhe e trashëgimisë kulturore. Të gjitha këto ligjërata i kam mbajtur me Policin e Kosovës, gjegjësisht stacioni policor i Drenasit e cila ka qen marrëveshje me ta, kështu që në këto ligjërata i kemi përfshirë të gjitha grup moshat e nxënësve për klasa, të gjitha shkollat, për të gjitha nivelet arsimore nga dy/2 herë në muaji, numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve të nxënësve në këto ligjërata ka qenë 1742nxënës.

Në bashkëpunim me TDZ(Therre des hommes) e Kosovës kemi mbajtur katër/4 ligjërata vetëdijesuese në disa prej shkollave, ku qëllimi ka qenë që nxënësit e shkollave të marrin përsipër vetëmbajtjen e ligjëratave në të ardhmen.

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

- Në këtë periudhë kemi pas bashkëpunim me mesësit mbështetës, asistent personal të FAMNV, për të ndihmuar në procesin e mësimi për FAMNV, të asistoj në hartimin e PIA për mësimdhënësit të cilët nuk kanë pasur mundësi të hartojnë këtë plan i cili është mjaft i vështir si punë fillestare për mësuesit të cilët duhet ta kenë si plan të rregullt për këta fëmijë.
- Gjatë kësaj periudhe kemi trajtuar në aspektin psikologjik rastet të cilat kanë pasur nevojë për këtë trajtim; familjet për fëmijët e vet, institucionet arsimore, QPS, ShSP(Shërbimi Sprovues i Kosovës) në disa raste edhe me referime nga disa prokuror të cilët për të mitur Rekomandojnë masën e Diversitetit-Këshillim Psikologjik për të cilën ne si komunë kemi një marrëveshje bashkëpunimi me këto organe që ndihmon të miturit të cilët gjenden në raste të caktuara në formë të vetëdijshme apo jo të vetëdijshme, për situatën e caktuar, për këto raste kam kontribuar në mënyrë shumë efikase që të miturit që kanë qenë të përfshirë në situata të rrezikshme për moshën e vet dhe shoqërinë trajtimi ka reflektuar si mundësi e mirë e rehabilitimit dhe e kthimit në normalitet jetësor si në familje, në shkollë dhe shoqëri.
- Ekipi komunalë për parandalim të braktisjes së shkollës është marr me rastet që kanë pasur tendencë braktisje.
- DKA ishte në disa shkolla pjesëmarrëse në manifestimin e Ditës së shkollës,

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

• Çështjet ligjore dhe të personelit për periudhën janar –dhjetor 2022

• Konkurse -----	27
• Rishpallje të konkursit -----	8
• Shpallje të rezultateve të konkurseve-----	31
• Vendime të komisioneve intervistuese -----	27
• Vendime të lehonisë -----	49
• Aktvendime për pensionim -----	14
• Aktvendime të ndryshme -----	296
• Vendime të ndryshme -----	36
• Njoftime të ndryshme (për ushqim,udhëtim, inflacion, gradim,etj)-----	1040
• Hartimin e pëlqimeve të ndryshme -----	72
• Hartimin e kërkesave të ndryshme-----	13
- Punëtor të rinjë-----	68
- Punëtor të larguar-----	44
- Ndryshime në listën e pagave-----	300
- Retroaktive-----	278
- Transfer bankar-----	34

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

Donacione

- Ambasada Amerikane renovim i ShFMU” Zenel Hajdini” , Tërstenik(është në procedurë),
- Vazhdimi i punimeve në palestrën sportive në gjimnaz,
- Pajisje muzikore nga KFORI për ShFMU” Zenel Hajdini” , Tërstenik
- 4 institucione arsimore publike parauniversitare janë me marrëveshje për efijencë nga fondi për efijencë (1.SHFMU-të: “Gani Elshani”,Krajokovë, "Luigj Gurakuqi",Sankoc,"Dëshmoret e Drenicës",Çikatove e vjetër, " Jusuf Gërvalla", Negroc).
- Eulex, mbjellja e fidanëve (drunjtëve dekorativ dhe pishave) në shkolla.
- Donacion nga shoqata gjermane ‘’ Familien in Not e.V.Rietnerg’’, tavolina per kabinete të shkencave të natyrës dhe pajisje laboratorike për fizik, kimi dhe biologji.

- Investimet kapitale-

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

RAPORT I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT JANAR-Dhjetor 2022, SEKTORI I ARSIMIT

GRANTET QEVERTARE/Fondi 10 /							
SEKTORI I ARSIMIT, KOMUNA DRENAS							
Nr.	Programi/Nënprogrami	Kodi ek.i Nënprogramit	Buxheti i Planifikuar	Shuma e Alokuar	Aktuali/Shpenzimet	Zotim/ Obligimet në pritje	Buxheti në FreeBalance
I.	Administrata e Arsimit	92005					
1.	11 PAGA DHE SHTESA		76,755.00	73,508.93	73,508.93		3,246.07
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME		228,513.00	228,513.00	208,626.66	19,886.03	19,886.34
Ia.	300 / PROJEKTET KAPITALE						
3.	45082 /INVENTARIZIMI I SHKOLLAVE		40,000.00	40,000.00	38,767.00	1,233.00	1,233.00
4.	51368 /REN.I SHKO.OBJE.SHKOLL..NYJEVE SANIT.,NGJYROSJA DHE SUVATIMI		82,000.00	82,000.00	81,999.99	0.01	0.01
II.	ARSIMI PARAFILLOR-QERDHET	92210					
1.	11 PAGA DHE SHTESA		151,501.68	119,979.00	150,161.58	1,333.66	1,340.10
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME		21,482.00	21,482.00	20,148.34	1,333.66	20,148.34
3.	14 SHPENZIME KOMUNALE		6,549.00	6,549.00	6,542.56	6.44	6.44
III.	ARSIMI FILLOR	93000					
1.	11 PAGA DHE SHTESA		4,666,871.99	5,894,989.00	5,395,312.17	-	500.83
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME		434,176.00	434,176.00	349,303.02	61,775.66	23,097.83
3.	14 SHPENZIME KOMUNALE		65,000.00	65,000.00	59,161.75	272.23	5,566.02
IV.	ARSIMI I MESËM	94200					
1.	11 PAGA DHE SHTESA		1,291,135.00	1,522,779.36	1,522,779.36	-	1,499.48
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME		147,743.00	147,743.00	89,602.47	43,744.16	14,396.37
3.	14 SHPENZIME KOMUNALE		22,000.00	22,000.00	14,232.38	-	7,767.62

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

RAPORT I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT JANAR-Dhjetor 2022, SEKTORI I ARSIMIT

TË HYRAT VETANAKE 2022/Fondi 21 /								SEKTORI I ARSIMIT, KOMUNA DRENAS							
		Kodi ek.i Nënprogramit		Buxheti i Planifikuar		Shuma e Alokuar		Aktuali/Shpenzimet		Zotim/ Obligimet në pritje		Buxheti në FreeBalance			
I.	Administrata e Arsimit	92005													
1.	20 SUBVENCIONET			100,000.00		100,000.00		98,849.90				1,150.10			
2.	38 REZERVAT			-		-		-		-		-			
Ia.	300 / PROJEKTET KAPITALE														
1.	49194 /FURNIZIMI I SHKOLLAVE ME PAJISJE TË TIK-ut			70,000.00		70,000.00		70,000.00		-		-			
2.	49195 /FURNIZIMI I SHKOLLAVE ME KABINETE PËR KIMI,FIZIKË DHE BIOLOGJI			50,000.00		50,000.00		48,812.32		0.01		1,187.68			
3.	49197 /RIPARIMI I NXEMJEVE QENDRORE(RADIATOR DHE PAJISJE TJERA PËRCJELLËSE)			10,000.00		10,000.00		9,990.00		10.00		10.00			
4.	51325/DIGJITALIZIMIM I INSTITUCIONEVE ARSIMORE			80,000.00		80,000.00		-		-		-			
5.	51367/NDËRTIMI I FUSHAVE TË JASHTME SPORTIVE DHE RRETHOJAVE			45,000.00		45,000.00		44,999.99		0.01		0.01			
II.	ARSIMI PARAFILLOR-QERDHET	92210													
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME			25,000.00		23,113.70		13,820.22		3,466.46		7,713.32			

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

RAPORT I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT JANAR-Dhjetor 2022, SEKTORI I ARSIMIT

TË HYRAT VETANAKE TË VITIT 2021/Fondi 22 /								SEKTORI I ARSIMIT, KOMUNA DRENAS		
Nr.	Programi/Nënprogrami	Kodi ek.i Nënprogrami	Buxheti i Planifikuar	Shuma e Alokuar	Aktuali/Shpenzimet	Zotim/ Obligimet në pritje	Buxheti në FreeBalance			
I.	Administrata e Arsimit	92005								
1.	20 SUBVENCIONET		1,349.90	1,349.90	1,349.90		1,349.90			
2.	38 REZERVAT		-	-	-	-	-			
Ia. 300 / PROJEKTET KAPITALE										
1.	49196 /RENOVIMI I OBJEKTEVE SHKOLLORE(KULM,DYSCHEME DHE NDRRIMI I DYERVE,DRITAREVE)		34,194.29	34,194.29	34,194.29	-	-			
II. ARSIMI PARAFILLOR-QERDHET								92210		
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME		37,299.94	37,299.94	21,720.62	10,813.61	10,813.61			

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

Gjatë vitit 2022 në Drejtorin e Arsimit janë realizuar këto projekte kapitale:

1. Renovimi i pjesshëm i shkollës “Gani Elshani” në vlerë 90,977.20€

Ky projekt është financuar nga Banka Botërore, përmes kredisë së butë dhe pa kamat, me afat të gjatë të kthimit për një periudhë 20 vjeçare, ndërsa projekti është implementuar nga Fondi i Kosovës për Eficienc të Energjisë. Në kuadër të këtij projekti është punuar fasada e shkollës me izolimi termik lesh guri 10cm dhe tavani i shkollës, pastaj është riparuar mbulesa dhe konstruksioni i kulmit, janë ndërruar të gjitha dyert dhe dritaret e jashtme, është instaluar kaldaja e re me pelet, është rinovuar dhe ngjyrosur komplet rrjeti i ngrohjes, radiatorët janë pastruar, ngjyrosur, është vendosur sistemi eficient i ndriçimit, janë ndërruar prizat, ndërresat dhe siguresat.

2. Renovimi i pjesshëm i shkollës “JUSUF GERVALLA” në vlerë 101,940.20€

Ky projekt është financuar nga Banka Botërore, përmes kredisë së butë dhe pa kamat, me afat të gjatë të kthimit për një periudhë 20 vjeçare, ndërsa projekti është implementuar nga Fondi i Kosovës për Eficienc të Energjisë. Në kuadër të këtij projekti është punuar fasada e shkollës me izolimi termik lesh guri 10cm dhe tavani i shkollës, pastaj është riparuar mbulesa dhe konstruksioni i kulmit, janë ndërruar të gjitha dyert dhe dritaret e jashtme, është instaluar kaldaja e re me pelet, është rinovuar dhe ngjyrosur komplet rrjeti i ngrohjes, radiatorët janë pastruar, ngjyrosur, është vendosur sistemi eficient i ndriçimit, janë ndërruar prizat, ndërresat dhe siguresat

3. Renovimi i pjesshëm i shkollës “Dëshmorët e Drenicës” në vlerë 96,132.70€

Ky projekt është financuar nga Banka Botërore, përmes kredisë së butë dhe pa kamat, me afat të gjatë të kthimit për një periudhë 20 vjeçare, ndërsa projekti është implementuar nga Fondi i Kosovës për Eficienc të Energjisë. Në kuadër të këtij projekti është punuar fasada e shkollës me izolimi termik lesh guri 10cm dhe tavani i shkollës, pastaj është riparuar mbulesa dhe konstruksioni i kulmit, janë ndërruar të gjitha dyert dhe dritaret e jashtme, është instaluar kaldaja e re me pelet, është rinovuar dhe ngjyrosur komplet rrjeti i ngrohjes, radiatorët janë pastruar, ngjyrosur, është vendosur sistemi eficient i ndriçimit, janë ndërruar prizat, ndërresat dhe siguresat.

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

4. Rënovimi i pjesshëm i shkollës “Luigj Gurakuqi” në vlerë 128,589.20€

Ky projekt është financuar nga Banka Botërore, përmes kredisë së butë dhe pa kamat, me afat të gjatë të kthimit për një periudhë 20 vjeçare, ndërsa projekti është implementuar nga Fondi i Kosovës për Efiçenc të Energjisë. Në kuadër të këtij projekti është punuar fasada e shkollës me izolimi termik lesh guri 10cm dhe tavani i shkollës, pastaj është riparuar mbulesa dhe konstruksioni i kulmit, janë ndërruar të gjitha dyert dhe dritaret e jashtme, është instaluar kaldaja e re me pelet, është rinovuar dhe ngjyrosur komplet rrjeti i ngrohjes, radiatorët janë pastruar, ngjyrosur, është vendosur sistemi eficient i ndriçimit, janë ndërruar prizat, ndërresat dhe siguresat

5. Ndërtimi i çerdhes në Drenas

Ky projekt është financuar nga Banka Botërore dhe implementuar nga ministria e Arsimit. Gjatë këtij viti janë punuar muret, kulmi dhe dyert dhe dritaret, instalimet elektrike, të ujit, ngrohjes, dhe një pjesë e suvatimit në objektit të çerdhes së re në Drenas me etazhitet P+1. Gjithashtu është punuar rrethoja e oborrit dhe disa punë të oborrit.

6. Inventarizimi i shkollave ne Drenas në vlerë 40,000€, Grant Qeveritar

Në fazën e parë janë zhvilluar procedurat e prokurimit, është lidhur kontratë në vlerë 31,887.00€, dhe pastaj është kryer furnizimi me inventar kryesisht çerdhet në Drenas dhe Komoran, por janë furnizuar me inventar më të cilën janë formuar këndet e leximit në 4 shkolla (“Halil Bajraktari”, “Ali Gashi”, “Zenel Hajdini” dhe “Bajram Curri”).

Gjithashtu edhe në fazën e dytë janë zhvilluar procedurat e prokurimit dhe është lidhur kontratë në vlerë 6,880.00€, me pas është bërë inventarizimi i zyrës së DKA-së ne rafte dhe është bërë ndarja e hapësirës më xham me profile alumini.

7. Furnizimi i shkollave me pajisje te TIK-ut në vlerë 70,000€

Ky projekt është financuar nga të hyrat vetanake të komunës. Për këtë projekt janë zhvilluar procedurat e prokurimit dhe është lidhur kontrata. Më këtë projekt janë pajisur pjesërisht shkollat me projektor, tabela smart dhe laptop.

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

8. Furnizimi i shkollave me kabinet për Kimi, Fizikë dhe Biologji në vlerë 50,000€

Ky projekt është financuar nga të hyrat vetanake të komunës. Për këtë projekt janë zhvilluar procedurat e prokurimit dhe është lidhur kontrata. Më këtë projekt janë pajisur pjesërisht shkollat me pajisje për kabinete Kimi, Fizikë dhe Biologji.

9. Renovimi i objekteve shkollore, në vlerë 82,000.00€

Ky projekt është financuar nga granti qeveritar. Për fazën e parë të këtij projekti është lidhur kontratë në vlerë 1,867.82€. Më këtë kontratë janë furnizuar me laminat dy kabinete të Gjimnazit.

Në fazën e dytë janë zhvilluar procedurat e prokurimit dhe është lidhur kontratë dy vjeqare në vlerë 186,105.48€. Për vitin 2022 është realizuar e gjithë shuma e paraparë në vlerë 80,132.18€.

Nga ky projekt janë realizuar këto punime:

Në shkollën “Shaban Polluzha” në Korroticë të Epërme është bërë izolimi termik i pllakës së kulmit, instalimet elektrike me priza, ndërpresa dhe siguresa, suvatimi dhe ngjyrosja e brendshme e objektit, riparimi i tërësishëm i njejeve sanitare, ngjyrosja e jashtme dhe riparimi i ulluqeve vertikale dhe strehës. Janë ngjyrosur komplet dy objektet e çerdhës “Ardhmeria” dhe shkolla e Komoranit, janë ndërruar dyert e hyrjes, si dhe është suvatuar dhe ngjyrosur komplet salla e sportit në shkollën Rasim Kiçina. Janë suvatuar dhe ngjyrosur komplet muret e pjesës së vjetër të shkollës “Rilindja” dhe është punuar plafoni me pllaka amstrongu. Në shkollën Halil Bajraktari janë ndërruar dyert e hyrjes, janë suvatuar dhe ngjyrosur disa klasë.

Në shkollën “Naim Frasheri”, janë ndërruar një pjesë e dritareve.

10. Ndërtimi i terreneve sportive dhe rrethojave të tyre 45,000.00€, GQ

Ky projekt është financuar nga të hyrat vetanake të komunës.

Për realizimin e këtij projekti janë zhvilluar procedurat e prokurimit dhe është lidhur kontratë dy vjeqare në vlerë 84,000.00€. Gjatë vitit 2022 janë paguar 45,000.00€ dhe janë rrethuar me rrethojë fusha e sportit në shkollën “Halil Bajraktari”, është në përfundim rrethoja në shkollën “Rilindja” dhe ka filluar të punohet rrethoja në shkollën “Zenel Hajdini”. Për vitin 2023 është paraparë të kryhet rrethoja e fushës në shkollat “Dëshmorët e Drenicës”, “Xhevë Lladrovci” dhe “Gani Elshani”.

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT

11. Riparimi i ngrohjeve qendrore në vlerë 10,000.00€

Ky projekt është financuar nga të hyrat vetanake të komunës. Për këtë projekt, ka qenë e lidhur kontrata gjatë vitit 2021. Sipas kësaj kontrate gjatë vitit 2022 është bërë riparim i ngrohjes qendrore dhe rrjetit të saj në shkollën “Rasim Kiçina”. Pastaj, buxheti i DKA-së nga kategoria mallra dhe shpenzime është iniciuar projekt i ri për riparimin e sistemit në institucionet arsimore. Për këtë projekt janë zhvilluar procedura të prokurimit dhe është lidhur kontratë e re në vlerë 9,719.00€. Sipas këtij projekti janë eliminuar defekte në sistemin e ngrohjes në 12 institucione arsimore dhe është instaluar një kallda e re me elemente përcillëse në shkollën “Gani Syla”.

12. Kontratë nga AQP, me titull LOT 3 Inventar shkollor

Agjencia qendrore e prokurimit publik ka lidhur kontratë për furnizim të shkollave më inventar shkollor. Më buxhetin e tyre vetanak, janë pajisur me inventar shkollorë 13 shkolla.

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar në tërësi plan-programin e vet të punës për periudhën Janar-Dhjetor dhe i ka kryear këto aktivitete:

- Raporti vjetor i DKRS-së për vitin 2021
- Plani dhe programi i punës për vitin 2022

Aktivitetet në DKRS

- Specifikimi i Buxhetit të DKRS sipas Planit të zotimeve dhe shpenzimeve.
- Takim individual me punëtorë të DKRS-së për vlerësim të punës për vitin 2021
- Futja e të dhënave të punëtorëve të DKRS-së në HMRS.
- Vlerësimi i punës së punëtorëve të DKRS-së.
- Takim pune me komisionin për plotësim të Rregullores së Subvencioneve.
- Plotësim i pyetësorit të Bibliotekave për MKRS.
- Takim pune me grupin komunal për Aktivitete në Drenas.

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar në tërësi plan-programin e vet të punës për periudhën Janar-Dhjetor dhe i ka kryear këto aktivitete:

- Përgaditje për Manifestimin e 17 shkurtin Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
- Realizimi i Manifestimit për 17 shkurtin Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
- Takim pune me grupin punues për Strategji Komunale.
- Realizimi i Aktivitetit për datat 5,6,7 Mars-2022.
- Planifikimi i të hyrave të DKRS-së.
- Specifikimi i shpenzimeve Financiare të DKRS-së.
- Realizimi i Filmit „Zgjoi” në Sallën e Kulutrës,
- Takim pune më përfaqësuesit e Arkivit-Prishtinë.
- Takim pune me Kryetarin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës.
- Përgaditja e lëndëve për Auditim.
- Është shënuar aktiviteti kulturorë i Sofrës Poetike “Ymer Elshani” 2022, në bashkëpunim me Karvanin e Shkrimtarëve „ Agim Deva”.
- Përgaditje e kërkesave fillestare për Buxhet të DKRS-së, 2023,2024,2025.

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar në tërësi plan-programin e vet të punës për periudhën Janar-Dhjetor dhe i ka kryear këto aktivitete:

- Në bashkëpunim me DKA-në kemi shënuar Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve-1 Qershorin, ku si DKRS kemi realizuar aktivitetin e ngjyrosjes me të gjithë fëmijët e Çerdhes "Ardhmëria".
- Realizimi i Orës Letrare me shkollat e Drenasit në bashkëpunim me Karvanin e Shkrimtarëve „ Agim Deva”
- Me rastin e shënimit të 23 Vjetorit të Ditës së Çlirimit, qyteti ynë u dekorua me flamuj dhe bilborda, me datë 11.06.2022, ndërsa më 14.06.2022 u mbajt Seancë Solemne e Kuvendit Komunal për të vazhduar me homazhe të shtatoret e heronjve në sheshin “Fehmi Lladrovci”, Komplekset Memoriale në Prekaz dhe Marinë si dhe homazhe tek të gjitha vendvarrezat e dëshmorëve në komunën tonë.
- Mbajtja e Akademisë Solemne kushtuar „Kongresit të Manastirit-1908”
- Hapja e këndit Arkivor të Bibilotekave Shqiptare në Drenas.
- Akademi Solemne për Ditën e Flamurit 28 Nëntor.

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar në tërësi plan-programin e vet të punës për periudhën Janar-Dhjetor dhe i ka kryer këto aktivitete:

Zyrtarja Administrative

- Punë administrative brenda sektorëve të Kulturës .
- Mbajta e protokollit intern për Drejtorin dhe sektorët e DKRS-së (SHKA) .
- Është bërë pranimi i faturave dhe kërkesave të ndryshme DKRS-së.
- Kam përgatitur kërkesa për nevojat e DKRS-së dhe dërgimin e tyre për procedurat e pagesës, skanimin e lëndëve të DKRS-së.
- Mbajtjen e të dhënave në Exell, për DKRS, plotësimin e Tabelave në Exell e të dhënave të të gjitha OJQ-ve Kulturore, Sportive, Rinore së bashku me zyrtarin e Sportit, të pranuar nga Drejtoria e Financave.
- Përgatitjen e raporteve të komisionit për pranim të mallrave për DKRS.
- Pranimin e vendimit për emrim të menaxherit të kontratës “ Furnizim me Buqeta Lulesh të Freskëta për Homazhe”.

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar në tërësi plan-programin e vet të punës për periudhën Janar-Dhjetor dhe i ka kryear këto aktivitete:

Menaxhere e kontratës “ Furnizim me Buqeta Lulesh të Freskëta për Homazhe”, plotësimin e procedurave në E- prokurim, nënshkrimin e planit të menaxherit, përgatitjen e lëndëve dhe procedimin për pagesë në Drejtoratin e Financave etj. Pjesëmarrje në trajnimet të organizuara nga IKAP për katër ditë radhazi për Siguria dhe Shëndeti në Punë, shkëmbim bisedash për Sigurinë dhe Shëndetinë në Punë dhe eliminimi i defekteve në procesin e realizimit të tyre, si dhe komunikimi efektiv, shkëmbim bisedash për Komunikimin Efektiv në Punë dhe eliminimi i defekteve në procesin e realizimit të tyre.

- Kemi përgaditur lëndën për Shpallje të Projektit Shpenzime të Byfes për DRKS.
- Kemi përgaditur lëndën për Shpallje të Projektit Furnizim me Karrige për Palestrën Hysni Jetullahu.
- Kemi përgaditur lëndën për Shpallje të Projekteve “Dekorimi i Qytetit për festat e fundvitit”
- Pjesëmarrje në komisionin për projektin “Invertarizimi i Arkivës i Qendrës së Kulturës”, dhe pranimin e mallit.
- Pranimi dhe përpunimi i 83 lëndëve në Intranet.

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

•Operatori Teknik

- Kemi mbajtur operimin e zërimit për aktivitete Komunale dhe DKRS.
 - Kemi punuar në Palestren Sportive "Hysni Jetullahu" ora 16-22.
 - Kemi bërë inqizimin e mbledhjeve të bordit.
 - Kemi bërë operimin me mjete të zërimit Akademi Përkujtimore.
 - Kemi bërë përgatitjen me zërim për filmin "Zgjoji"
 - Kemi operuar me mjete të zërimit për 1 Qershorin.
 - Kemi operuar me mjete të zërimit në ditën e shkollës në Negrovç.
 - Kemi operu me mjete të zërimit në Aktivitetin e Flutura Academy.
 - Kemi përdorur mjetet e zërimit në aktivitetin e Orës Letrare.
 - Kemi përdorur mjetet e zërimit për dy ditë për ditën e shkollës profesionale "Fehmi Lladrovci"
 - Shërbim me mjetet e zërimit për aktivitetin Nazmi Muja të autorit Ahmet Qeriqi.
 - Sherbim me mjete të zërimit në Shtëpin e Kulturës për aktivitetin e KVRL-së promovimi i dy (2) librave "Në sytë e zemrës" "Shtegu i Pritjes" nga autorja : Anita Istogu.
 - Kemi asistuar në Projektin : "Avancimi i përshpejtuar i cilsisë së arsimit - Strategjia 5 vjeqare e zhvillimit në Komunën e Drenasit " (faza e parë: 12.08.2022 – 11.08.2025)
- Financues :Komuna e Drenasit, implemtues QAPA.
- Kemi përgatitur Sallen e Filmit me mjete të zërimit për të përcjelljen aktivitetin zyrtar që është mbajtur me datën 29.10.2022.nga ART CLUB " Rifat Kukaj " Drenas.
 - Asistim me zërim për aktivitetet e Nëntorit-2022
 - Kemi plotësuar formularët për mbikqyrje të masave detyruese për kursimin e Energjisë të Objekteve Kulturore dhe Sportive.

Arkivi

- Vizitë nga zyrtarët e Arkivit të Kosovës për tu njohur me punën e Arkivit historik të Drenasit si dhe bashkpunimin ndërmjet arkivave, përgatitjen e listës së fondeve arkivore për të përcjellë Arkivit të Kosovës.

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

- Takim pune në Kuvendin e Kosovës për diskutimin e draft-rregullores për arkivat shtetore të Kosovës, Dergimin e një shkrese në Kuvendin e Kosovës tek zyrtari i Lartë për Arsim e Kulturë, kërkesë për plotësimin e disa neneve për Ligjin mbi Arkivat Shtetore të Kosovës.
- Puna me pale : Janë lëshuar gjithsejtë: 10 Çertifikata shkollore të lëshuara për palë; 36 njoftime të lëshuara për palët;lëndë për shtëpi, lokale afriste etj; palë janë ndihmuar me lëndë për hulumtim arkivor për punime të temave të masterit dhe botim të librit etj ; gjithsejtë - 63.
- Skanimin e lëndëve të fondit nr. 31 të Drejtoratit për Ekonomi e Financa.
- Skanimin e gazetave zyrtare me rendësi për komunën e Gllogocit të viteve 1975 -1980,
- Skanimi i librit te Amzës nr. 4 të shkollës fillore “V. Bashkimi” vitet 1973 -1985.
- Regjistrimin e evidencave të nxënësve të librit të Amzës nr. 8 të shkollës së mesme “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në kompjuter.
- Skanimin e lëndëve të shkollave Fillore dhe të mesme, raporte statistikore të viteve 1995/1996 tabela statistikore, etj.

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

- Pas kërkesës nga zyrtarja e Drejtoratit për Urbanizëm, kemi kontrolluar fondin e Gazetave zyrtare për të gjetur numrat 29/78, 39/85, 57/89.
- Kërkesë Arkivit të Kosovës përmes emailit zyrtar për gazetat zyrtare nr. 29/78, 39/85, 57/89.
- Skanimin e lëndëve të Drejtoratit për Urbanizën dhe Planifikim Hapsinor vitet 1980/81, 1993 (Kontrata, vendime kopje të planeve etj)
- Skanimin e lëndëve të fondit nr.1 të shkollës fillore “ V. Bashkimi” librat e procesverbaleve të provimeve private të nxënësve të kësaj shkolle.
- Skanimin e librit të Amzës nr.3 të shkollës fillore listat e nxënësve dhe suksesin e klasëve të përfunduara.
- Rregullimi, përpunimi, evidentimi i lëndëve të fondit nr. 27 të këshillit Popullor të Tërstenikut, historikun e fondit, lista të ndryshme, raporte, procese informata etj.

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Punë të tjera shitesë administrative të DKRS-së

- Në kuadër të komisionit kemi marr pjesë në Vlerësimin e pasurive jo Financiare në organët e Administratës së përgjithshme të Komunës së Gllogocit për vitin 2022.
- Pjesëmarrje në vlerësimin e 14 ofertave të caktuara me vendime nga zyra e Prokurimit.
- Përgatitjen e materialeve për DKRS në kuadër të Grupit punues për rishikim dhe plotësimin e draft-dokumentit "Vlerësimi i rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe tjera".
- Përgatitjen e materialeve për DKRS në kuadër të komisionit punues për monitorim të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të deklaruara në Planin Zhvillimor të Komunës së Gllogocit, 2020 – 2028.
- Pranimin e raporteve Narrative dhe Financiare për OJQ-të dhe Individët përfitues për vitin 2022, i emruar zyrtar për monitorim dhe raportim nga zyra e kryetrit të Komunës.
- Përgatitjen e të dhënave për OJQ-të Kulturore të Subvencionuara për vitet 2017-2021 sipas gjinive dhe shumat për të tri vitet paraprake.

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

- Plotësimin e formularit për OJQ-të kulturore, sportive dhe rinore për DKRS të kërkuara nga Auditorët.
- Janë mbajtur gjithsejtë 14 takime me Grupin Lokal të Veprimit- diskutime të ndryshme me OJQ “Akti” për trajnimin e të rinjëve dhe inkuadrimin e tyre në tregun e punës, inkuadrimin e 22 të rinjëve pas trajnimit në punë.

- Plotësimin e formularit për Trashegiminë Kulturore së bashku me shefin e DKRS-së;
- Pranimin e një kërkesë përmes emaili për të gjetur të dhënat për dëmet e luftës për vitet-1998/1999.
- Pranimi i raporteve Narrative dhe Financiare nga OJQ-të dhe individët përfitues të Subvencioneve për vitin 2022 nga DKRS.

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Raport i Bibliotekave Janar - Dhjetor, 2022

Bibliotekat gjatë vitit **2022** janë paisur nga **MKRS-ja** me **1031** Tituj dhe **1566** ekzemplar

Muaji;Janar-Dhjetor-2022	Nr.i ekzemp	Nr.i titujve	Ekzmp të ri.	Tituj të rinj	Libra të lexuar	Nr.i lexuesve	Lexues të ri	Gjithsej lexues
Drenas	10915	4461	785	519	1921	923	191	1114
Tërstenik	4921	1592	17	7	129	205	23	228
Arllat	5154	954	0	0	454	421	22	443
Komaran	4827	2798	764	505	595	472	41	513
Gjithësej	25817	9805	1566	1031	3099	2021	277	2298

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Sektori i Rinisë në bashkëpunim me KVRL-në gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar këto aktivitete:

- Punë administrative të DKRS.
- Takime të rregullta me KVRL -në.
- Takim pune në MKRS.
- Takime me OSBE-en për politikat rinore.
- Planifikim për trajnimin e të rinjëve në bashkëpunim me MKRS-në dhe OSBE-en.
- Anëtarë i komisioneve të ndryshme brenda Drejtorisë.

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Sektori i Sportit e ka realizuar Plan-Programin e punës për periudhën Janar- Dhjetor dhe ka zhvilluar këto aktivitete.

Raport vjetor Janar-Dhjetor-2022

- Zyrtaari i sportit ka organizuar dhe zhvilluar garat në sporte të ndryshme për ShFMU-ve dhe ShML- ta për garat sipas Kalendarit të garave të Federates së Sportit Shkollor për vitin 2022.
- Në Palestren sportive „Hysni Jetullahu” zyrtari i sportit ka monitoruar garat e ShMFU-ve të nivelit Regjional nga Federata e Sportit Shkollor në Hendboll.
- Zyrtari i sportit i është përgjigjur kërkesave të ndryshme nga klubet tona sportive dhe është dhënë përgjigja adekuate në bazë të ligjit për sport, Udhëzimeve Administrative dhe rregulloreve në fuqi.
- Zyrtari i sportit ka prezentuar dhe ndihmuar në mbledhjet e kuvendeve të punës dhe Kuvendeve zgjedhore të mbajtura nga OJQ- klubet e regjistruara në DKRS.
- Zyrtari i sportit me zyrtarët e objekteve sportive, fushave sportive ka bërë kërkesa për mirëmbajtje dhe rregullimin e tyre.
- Zyrtari i sportit gjatë këtij viti i ka përcjellë OJQ-të, klubet sportive që janë të regjistruar në DKRS në shumë seanca stërvitore dhe ndeshje kampionale, që janë zhvilluar në Drenas dhe jashtë komunës.
- Zyrtari i sportit ka monitoruar, mirëmbajtjen e objekteve sportive.
- Është përcjell dhe zbatuar qarkorja e dërguar nga MKRS për Licencimin dhe regjistrimin e klubeve sportive në Komunë-DKRS.
- Zyrtari i sportit është angazhuar për shënimin e Ditës Ndërkombëtare Olimpikë, ky aktivitet sportiv është shënuar në bashkëpunim me shkollë-nxënës, klube sportive në stadiumin Sintetik ku ishin rreth 100 pjesëmarrës.
- Zyrtari i sportit në bazë të vendimit për komisionin e subvencionimit ka bërë rekomandimin për subvencionim në sferën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- Zyrtari i Sportit, DKRS e ka përgaditë dhe mbajtur aktivitetin e Zgjedhjes së më të mirëve në lëminë e sportit të klubeve, individëve që kanë pasë rezultat gjatë vitit 2022.
- Zyrtari i sportit ka marrë pjesë në komisione të vlersimit dhe shyrimit të ofertave për projekte të ndryshme si dhe komisione tjera. Inventarizimit të pasurive jo financiare, menaxhimi i kontratave në bazë të vendimit të kryetarit të komunës.

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Stadiumi Sintetik – Drenas Raporti vjetor Janar- Dhjetor, 2022

Nr	Muaj	Nr. I	Orë	Nr. I Lojtarëve	Nr. I shikuesve	Ndeshje Kampionale
		stërvitjeve				
1.	Janar	63	77.30	1399	290	2
2.	Shkurt	130	167,50	3275	702	23
3.	Mars	113	139	2798	420	9
4.	Prill	133	149.10	3314	1081	18
5.	Maj	117	145.40	3290	1019	18
6.	Qershor	118	137	3533	631	23
7.	Korrik	136	161.7	3929	1270	24
8.	Gusht	160	241.6	4520	1184	26
9.	Shtator	144	221.2	3281	694	5
10.	Tetor	114	317.7	3545	1238	21
11.	Nëntor	96	150.8	2699	376	14
12.	Dhjetor	50	92	1074	290	10
	Gjithsejt aktivitete	1374	2000.3	36657	9195	193

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

- Klubet dhe Shkollat e futbollit e kan respektuar orarin me përpikëmeri.
- Kemi pas dy termine private me pagesë.
- Kemi bërë mirëmbajtjen e hapsirave të gjelbëruara për rreth objektit të Stadiumit Sintetik.
- Kemi bërë pastrimin e objektit dhe fushës mbrenda dhe jashtë Stadiumit Sintetik.
- Eshtë bërë pastrimi i fushës nga bora.
- Eshtë bërë mirëmbajtja(krehur) barit sintetik në fushë.
- Klubi i futbollit' FORTUNA-DR ' i ka vendosur 14 reflektor në fushë Sintetike .

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Palestra e Sportit ” Hysni Jetullahu ” – Drenas Raport vjetor Janar- Dhjetor - 2022

Raporti më lartë në formë tabelare paraqet të dhënat e detajuara të shfrytëzimit të palestrës “Hyni Jetullahu” për periudhën vjetore të vitit 2022 nga klubet sportive. Palestra është shfrytëzuar sipas orarit të hartuar nga DKRS në bashkëpunim me klubet, ndërsa për lojë zyrtarë të dielave është bërë kërkesë e veçantë përmes email-it apo formës fizike.

Nr.	Muaji	Nr. I stërvitjeve	Orë	Nr. I pjesëmarrësve (lojëtarë të ekipeve, staf)	Nr. I shikuesve	Lojë kampionale
1.	Janar	11	36	133	10	1
2.	Shkurt	64	154	701	57	5
3.	Mars	75	186	1982	1345	32
4.	Prill	17	41	397	49	4
5.	Maj	30	50	523	351	10
6.	Qershor	48	65	895	1168	2
7.	Korrik	/	/	/	/	/
8.	Gusht	/	/	/	/	/
9.	Shtator	18	301	288	111	1
10.	Tetor	52	589	867	956	10
11.	Nëntor	36	969	955	914	25
12.	Dhjetor	17	31	286	19	3
	Gjithsejt aktivite	368	2422	7027	4980	93

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Stadiumi i Futbollit „Rexhep Rexhepi” – Drenas Raport vjetor Janar- Dhjetor - 2022

Nr.	Muaji	Nr. I stërvitjeve	Orë	Nr. I pjesëmarrësve (lojëtarë të ekipeve, staf)	Nr. I shikuesve	Lojë kampionale
1.	Janar	/	/	/	/	/
2.	Shkurt	/	/	/	/	/
3.	Mars	/	/	/	/	
4.	Prill	/	/	/		
5.	Maj	/	/	/	/	/
6.	Qershor	/	/	/	/	/
7.	Korrik	/	/	/	/	
8.	Gusht	/	/	/	/	/
9.	Shtator	15	30.2	499	585	3
10.	Tetor	19	35.4	506	632	2
11.	Nëntor	12	21.4	341	250	2
12.	Dhjetor	0	0	0	0	0
	Gjithesëjtaktivitet ete	46	87	1346	1467	7

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Në kuadër të projekteve kapitale në vitin 2022 nuk ka pasur pengesa në realizimin e tyre. Prandaj projektet e planifikuara në vitin 2022 janë realizuar sipas planifikimit të DKRS-së.

Ndërsa për vitin 2023 vazhdojnë projektet e shënuara si në vijim;

- Vazhdimi i ndërtimit të Stadiumit "Rexhep Rexhepi" faza e dytë;
- Renovimi i Stadiumit Sintetik, Faza e dytë si Projekt Kapital;
- Ndërtimi i Fushave Sportive dhe Rekreacion;
- Rregullimi i Palestres Sportive „Hysni Jetullahu”
- Invertarizimi i Qendrës Kulturore,
- Paisja e Bibliotekave me Lektyrë adekuate.

3.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

Ky Drejtorat gjatë kësaj periudhe një vjeçare janar-dhjetor 2022 ka kryer punët dhe detyrat në të gjitha sektorët përkatëse që janë kompetencë e tij, në bazë të Statutit të Komunës që është obligim dhe përgjegjësi e këtij Drejtorati ti zbatojë dispozitat ligjore.

Drejtorati për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në kuadër të kompetencave, autorizimeve dhe përgjegjësi të tij, funksionon në zbatim të drejtpërdrejt të ligjeve :

- Ligjin për tokën bujqësore Nr.02/L-26 ;
- Ligjin për mbrojtjen e bimëve Nr.02/L-95 ;
- Ligji për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural – Nr.04/L-074
- Ligjin për Gjuetinë Nr.02/L-53 ;
- Ligjin për Bletarin Nr.02/L-111 ;
- Ligjin për kujdesje ndaj kafshëve Nr.02/L-10 ;
- Ligjin për pyjet e Kosovës Nr.2003/3 ;
- Ligjin 03/L-153 për ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit Nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës .

3.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

Në komunën e Drenasit, Bujqësia po shndërrohet në një sektor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik ,duke marr parasysh kushtet e volitshme si nga aspekti pedologjik po ashtu edhe nga ai klimatik .

Komuna e Drenasit ka për qëllim që të zgjerojë kapacitetet në zhvillimet bujqësore ku nëpërmes saj do të hapën vende të reja të punës e po ashtu si qëllim kryesorë do të jetë rritja e prodhimeve vendore dhe ulja e importit.

3.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

➤ SEKTORI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL KA KRYER KËTO PUNË:

- Përgatitja e raporti vjetor 2022 si dhe Plani i punës për vitin 2023,
- Përgatitja e Projekteve të Propozuara për vitin 2023 ,
- Këshillime, udhëzime fermerëve rreth aplikimit për Grande në MBPZHR,
- Këshillime rreth aplikimit për subvencione për pagesa direkte 2022,
- Regjistrimi i fermerëve të rinjë në regjistrin e fermës,
- Është bërë leshimi i Certifikatës së fermerit(NIF-i,si dhe informata përcjellëse e fermerit- ANEKSI),
- Është bërë planifikimi dhe realizimi i mbjelljeve pranverore 2022 (të planifikuara 2635 ha , prej tyre janë realizuar 2477 ha),
- Është bërë planifikimi dhe realizimi i mbjelljeve vjeshtore 2022/2023 (të planifikuara 3150-ha , prej tyre janë realizuar 2880ha),
- Është bërë thirrja publike dhe pranimi i aplikacioneve të fermerëve për pagesa direkte për qumësht/litër sipas Cilësisë dhe majmërisë së viçave për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021,
- Janë dorëzuar në MBPZHR aplikacionet e fermerëve për pagesa direkte për qumësht/litër sipas cilësisë dhe Majmërisë së viçave për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021,
- Është bërë vlerësimi i dëmeve në kulturat bujqësore nga fatkeqësitë natyrore: breshëri, vërshimet, përmbytjet, erërat ,ngricat dhe fatkeqësitë tjera,

3.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

- Pas vlerësimit të kërkesave të fermerëve nga fatkeqësitë natyrore, kërkesat janë dorëzuar në MBPZHR për kompensim të dëmit,
- Është bërë pranimi i kërkesave të ndryshme të fermerëve në sektor e ndryshëm të bujqësisë,
- Janë dhënë këshilla direkte për fermër në të gjithë sektorët e bujqësisë, për fermeret që janë të interesuar për aplikim për projektet e DBPZHR dhe të MBPZHR
- Shpërndarja e broshurave për fermerë në të gjithë sektorët e bujqësisë,
- Pranimi, shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të fermerëve dhe kthimi i përgjigjeve,
- Përgatitja rreth Korrje -Shirjeve ,bashkëpunimi me MBPZHR ,auto-kombajneret ,fermërt dhe pikat grumbulluese të drithërave në territorin e Komunës së Drenasit,
- Është formuar komisioni për korrje-shirje që të bëjë përcjelljen dhe realizimin e korrje-shirjeve në territorin e komunës së Drenasit,
- Çmimi i korrje-shirjeve është përcaktuar nga MBPZHR 130 € për ha.
- Është bërë thirrja publike dhe pranimi i aplikacioneve të fermerëve për pagesa direkte për qumësht/litër sipas cilësisë dhe majmërisë së viçave për gjashtëmujorin e parë për vitin 2022,
- Janë dorëzuar në MBPZHR aplikacionet e fermerëve për pagesa direkte për qumësht/litër sipas cilësisë dhe Majmërisë së viçave për gjashtëmujorin e parë për vitin 2022,
- Ndërmarrja “IBËR LEPENCË” Njësia e Punës në Komoran ka të rregulluar rrjetin e ujitjes për 2970 ha sipërfaqet e ujitura për vitin 2022 janë rreth 600 ha,
- Punime në komisione të ndryshme,

3.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

- Janë kryer punë shtesë nga zyrtarët e drejtoratit tonë në bazë të vendimit të zyrës së Kryetarit,
- Takime me Ministrin e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural rreth perkrahjes së projekteve,
- Takime me OJQ të ndryshme me qëllim përkrahje në projekte për Bujqësi,
- Takime me IADK-ën me qëllim përkrahje në projekte të ndryshme,
- Po ashtu në kuadër të drejtoratit është bërë azhurimi i lëndëve në mënyrë elektronike;
- Janë publikuar thirrjet publike për projektin e serrave,
- Janë dhënë këshilla fermerëve për plotësim të aplikacioneve, komplementimin e dokumentacionit për aplikim për këtë projekt-serra,
- Janë bërë kërkesat për zotime për pagesa të faturave për shpenzimet e drejtoratit,
- Me kërkesën e auditorëve të jashtëm është dorëzuar lista e projekteve dhe vlerat e paguara të projekteve të zhvilluara gjatë vitit 2021,
- Përgatitja e raporteve mujore dhe dërgimi në Qendra Informuese Këshilluese -QIK në MBPZHR-Departamentin e Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike-DSHKT,
- Punime për plotësimin e formularit për agjencinë për barazi gjinore për gratë përfituese të subvencioneve nga

Drejtorja prej viti 2019–2021,

- Azhurimi i lëndëve në mënyrë elektronike në kuadër të DBPZHR-së,
- Monitorimi i kompanisë veterinarë që merret me trajnimin (vaksinimin) e qeneve shtëpiak,

3.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

- Është punuar në komision për Rregulloren e Komunës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Subvencioneve në Sektorët e Bujqësisë,
- Është punuar për Hartimin e Udhëzuesit Administrativ me temën: Mbrojtja e Fëmijëve nga Punët e Rrezikëshme në Bujqësi dhe Pylltari,
- Pjesëmarrja në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) në koordinim me Komunën e Drenasit dhe mbështetjen e National Demokratik Institute (NDI) lidhur me draft dokumentin sipas Rregullores së re me Nr.25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.
- Është punuar për zhvillimin e planit të integritetit për vitet 2022-2026,

3.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

- Është punuar në komision për Rregulloren e Komunës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Subvencioneve në Sektorët e Bujqësisë,
- Është punuar për Hartimin e Udhëzuesit Administrativ me temën: Mbrojtja e Fëmijëve nga Punët e Rrezikëshme në Bujqësi dhe Pylltari,
- Pjesëmarrja në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) në koordinim me Komunën e Drenasit dhe mbështetjen e National Demokratik Institute (NDI) lidhur me draft dokumentin sipas Rregullores së re me Nr.25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.
- Është punuar për zhvillimin e planit të integritetit për vitet 2022-2026,
- Është punuar në Hartimit të Draft Planit të Veprimit Komunal për Energji dhe Klimë,
- Me kërkesën e auditorëve të jashtëm është dorëzuar lënda e kompletuar për projektin e serrave (thirrja e aplikuesve, vendimi i komisionit për përzgjedhjen e përfituesve, lista e aplikuesve, lista e përfituesve vendimi i komisionit për pranimin teknik).

3.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

➤ Projektet nga Komuna: të realizuar gjatë vitë 2022

- **Furnizimi i fermerëve me serra me sipërfaqe 50m²**

Është nënshkruar Memorandum bashkëpunimi për bashkëfinancimin e projektit të serrave në mes: Komunës -Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Organizatës “Islamic Relief Kosova”. Në këtë projekt kanë aplikuar 365 fermer, janë përzgjedhur 105 fermer përfitues-2022.

- **Furnizimi i fermerëve me ujë nga ndërmarrja “Ibër Lepenci” për ujitje e tokave për kulturat bujqësore.**

Është nënshkruar Memorandum bashkëpunimi për bashkëfinancimin në mes: Komunës-Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ndërmarrjes IBËR -LEPENCI, në këtë projekt janë ujitur rreth 600 ha, kultura të ndryshme bujqësore nga ndërmarrja IBËR -LEPENCI, ku fermerët janë furnizuar me ujë pa pagesë për ujitjen e kulturave bujqësore, sipërfaqe e arritur me e madhe që nga pas lufta ku gjithësejt kanë ujitur tokat bujqësore rreth 84 fermer.

3.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

➤ Projektet nga Komuna: të realizuar gjatë vitë 2022

- ***Furnizimi i fermerëve me serra me sipërfaqe 50m²***

Është nënshkruar Memorandum bashkëpunimi për bashkëfinancimin e projektit të serrave në mes: Komunës -Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Organizatës “Islamic Relief Kosova”. Në këtë projekt kanë aplikuar 365 fermer, janë përzgjedhur 105 fermer përfitues-2022.

- ***Furnizimi i fermerëve me ujë nga ndërmarrja “Ibër Lepenci” për ujitje e tokave për kulturat bujqësore.***

Është nënshkruar Memorandum bashkëpunimi për bashkëfinancimin në mes: Komunës-Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ndërmarrjes IBËR -LEPENCI, në këtë projekt janë ujitur rreth 600 ha, kultura të ndryshme bujqësore nga ndërmarrja IBËR -LEPENCI, ku fermerët janë furnizuar me ujë pa pagesë për ujitjen e kulturave bujqësore, sipërfaqe e arritur me e madhe që nga pas lufta ku gjithësejt kanë ujitur tokat bujqësore rreth 84 fermer.

- ***Furnizimi i qytetarëve me puse-bunar me ujë të pijes***

Është nënshkruar Memorandum bashkëpunimi në mes: Komunës-Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Organizatës” Qatar Charity”, për hapjen e bunarëve (puseve) për pije, ku gjithësejt kanë qënë përfitues 15 ,(gjashtëmbëdhjetë) familje me kushtë të rënda ekonomike.

3.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

➤ Projektet nga MBPZHR në bashkëpunim me Komunën

- Është bërë thirrja Publike, Aplikimi, Kompletimi dhe Dorëzimi në AZHB i lëndëve për pagesat direkte qumësht/litër sipas cilësisë të gjedhit dhe majmërisë së viçave për gjashtëmujorin e dytë të vitit -2021.
- Është bërë thirrja Publike, Aplikimi, Kompletimi dhe Dorëzimi në AZHB i lëndëve për pagesat direkte qumësht/litër sipas cilësisë të gjedhit dhe majmërisë së viçave për gjashtëmujorin e parë të vitit -2022.
- Kanë aplikuar 35 fermër për pagesat direkte qumësht/litër sipas cilësisë për gjashtëmujorin e dytë -2021, sipas kategorive : Ekstra klasë **0.06 €**, klasa e parë **0.04€**, klasa e dytë **0.02 €** , për majmëri të viçave subvencionimi për 1 viçë ka qenë **10 €**.
- Kanë aplikuar 45 fermër për pagesat direkte qumësht/litër sipas cilësisë për gjashtëmujorin e parë -2022, sipas kategorive : Ekstra klasë **0.07 €**, klasa e parë **0.04€**, klasa e dytë **0.02 €** , për majmëri të viçave subvencionimi për 1 viçë ka qenë **25 €**.
- Është bërë informimi i fermerëve përmes thirrjes publik për aplikim rreth subvencioneve për pagesa direkte: Grurë, Sasi të grurit të dorëzuar në sillose, mullinjë ose pika grumbulluese, Farë Gruri, Elb, Thekër, Misër, Luledielli, Vreshta, Pemë, Perime ne serra ,Perime në fushë të hapur, Lopë dhe Buallica qumështore, Dele, Dhi, Bletë, Pula vojse, Bimë aromatike ,etj.
- Është bërë DIGJITALIZIMI i parcelave të mbjellura me kultura të ndryshme, janë bërë të gjitha pranimet e aplikacioneve të fermëve që kanë aplikuar në programet e ndryshme për subvencionime nga MBPZHR, janë kompletuar dokumentacionet dhe janë dorëzuar në AZHB, gjithsejtë 1005 aplikacione të fermereve aplikuesne në të gjitha sektorët e bujqësisë.

3.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

- **Subvencionimi i të mbjellurave me grurë**, është bërë digjitalizimi i parcelave prej **1913.93** ha, subvencionimi për 1 hektar **150€ - sipërfaqe , 150 € - plehërim ,54 € - derivate si dhe 0.03€ -kg të grurit të dorëzuar.**
- **Subvencionimi i të mbjellurave me elb**, është bërë digjitalizimi i parcelave **28.52** ha subvencionimi për 1 hektar **150€-sipërfaqe,54 €-derivate.**
- **Subvencionimi i të mbjellurave me tërshër**, është bërë digjitalizimi i parcelave **60.55** ha subvencionimi për 1 hektar **150€-sipërfaqe, 54 €-derivate.**
- **Subvencionimi i të mbjellurave me misër** është bërë digjitalizimi i parcelave **1917.18** ha subvencionimi për 1 hektar **175€-sipërfaqe,100€-plehërim, 54€-derivate.**
- **Subvencionimi i Plantacioneve me pemë** është bërë digjitalizimi i parcelave **170.44** ha subvencionimi për 1 hektar **-450€,derivate- 54 €,**
- **Subvencionimi i Perimkulturës** është bërë digjitalizimi i parcelave **94.92** hektar ,subvencionim për një hektar në fushë të mbyllur-serra **850€**,në fushë te hapur **500 €**,,kunguj dhe kunguj misirit **150 €.**
- **Subvencionimi i BMA-së** është bërë digjitalizimi i parcelave **3.33** ha, subvencionimi për 1 hektar **450€.**
- **Subvencionimi i lopëve qumështore** – fermerët kanë aplikuar për **1450** krerë lopë qumështore subvencionimi për 1 lopë qumështore ka qenë **90€.**
- **Subvencionimi i deleve qumështore** – fermerët kanë aplikuar për **3922** krerë dele qumështore subvencionimi për 1 dele qumështore ka qenë **25€.**
- **Subvencionimi i dhive qumështore** - fermerët kanë aplikuar për **632** krerë dhi qumështore subvencionimi për 1 dhi qumështore ka qenë **25€.**
- **Subvencionimi i shoqërive me bletë-** fermerët kanë aplikuar për **4369** koshere subvencionimi për 1 koshere ka qenë **20€**
- **Subvencionimi i pulave për vezë** ka aplikuar 1 fermër për **10,000** copa pula për vezë, subvencionimi për një pulë ka qenë **0.50€**

3.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

➤ Projekt ,Trajnime nga IADK

- Trajnimi i fermerëve nga IADK-ja në sektorin e pemëtarisë ku janë përzgjedhja e (7)shtatë fermërve përfitues ku kanë përfituar pajisje për pemëtari me vlerë prej **5000€** për fermer.
- Trajnimi i fermereve nga IADK-ja në sektorin e blegtorisë, ku janë zhvilluar trajnime direkte në ferma rreth menaxhimit të fermës dhe rritjes së sasisë dhe cilësisë së qumeshtit , ku rreth 15 fermer janë trajnuar ne këtë sektor.
- Trajnimi i fermerëve nga IADK-ja, ne sektorin blegtoris - përpunimin e qumështit dhe konzervimi pemëve dhe përimeve.

3.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

- Drejtoria e Inspeksionit, punët dhe detyrat e punës për periudhën janar-dhjetor 2022 i ka kryer duke u bazuar në planin e punës.
- Edhe në vitin 2022 Drejtoria për Inspeksion ka qënë në nivel të detyrave të punes së arritjes së objektivave dhe zhvillimit të aktiviteteve në fushat që i takojnë. Vlenë të theksohet se gjatë kësaj periudhe është bërë edhe punë shtesë dhe jashtë orarit të punës, ndërsa kompensimi është bërë me ditë të lira.
- Gjatë periudhës raportuese janar –dhjetor 2022 inspektorët vazhdimisht çdo ditë pune kanë sjellë raportet ditore të punës, ndërsa nga Shefi i Inspeksionit janë hartuar raportet javore si dhe raporti gjashtëmuor 2022 për punët e kryera në këtë Drejtori. Në vazhdimësi janë përcjellë dhe paguar të gjitha obligimet (faturat) për mallra dhe shërbime.
- Është hartuar buxheti kërkesat fillestare për periudhën 2023-2025 për Drejtorinë për Inspeksion, si dhe zbatimi i planit të zotimeve dhe shpenzimeve për paga, mallra dhe shërbime për perioda për vitin 2022.

3.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 janë kryer punët dhe detyra e punës nën mbikëqyrjet inspektuese si vijon :
- Inspektimet rreth mbrojtjes nga pandemia COVID-19 sipas Manualit të IKSH, Ligjit për mbrojtje të sëmundjeve ngjitëse dhe Vendimeve të Qeverisë së Kosovës, për periudhën janar- shkurt 2022 ndërsa pas kësaj periudhe inspektori sanitar ka kaluar ne AUV Prishtinë, ndërsa prej shtatorit 2021 është paguar nga kjo njësi buxhetore.
- • Inspektimet lidhur me tregtimin me pakicë, pajisjen e subjekteve afariste me certifikata të biznesit si dhe inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, deklinacionin e mallit, mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin e orarit të punës etj.
- • Inspektimet e ndërtimit në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje të ndërtimit, si dhe ndalimi i punimeve të objekteve pa leje dhe marrja e masave të nevojshme.
- • Inspektimi rreth ndotësve të ambientit, inspektimi i tregjeve, rrugëve, trotuareve, e sidomos inspektimi rreth ujërave të zeza në zonat rurale.
- • Inspektimi i kompanive të transportit në komunikacionin rrugorë, taxit ilegal, orari i udhëtimit, lejet e operimit, rendet e udhëtimit, stacionet, parkingjet etj..
- • Inspektimi i mënyrës se shfrytëzimit të tokës bujqësore dhe mbikëqyrjes, nëse toka bujqësore shfrytëzohet për qëllime jo bujqësore. Mbikëqyrjen e ndotjes së tokës bujqësore nga ndotësit dhe urdhërimin e marrjes së masave për parandalimin e ndotjes së tokës bujqësore.
- Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesave dhe nevojave në teren.

3.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

- Nga lëmia e Inspektorit Sanitar është bërë:
- • Inspektimet rreth parandalimit COVID-19 ku janë lëshuar aktvendime për izolim të personave të infektuar nga COVID-19
- • Inspektimet rreth higjienës, kontrollues së përgjithshme të artikujve ushqimorë dhe atë për periudhën janar – shkurt 2022 ngase pas kësaj periudhe inspektori sanitar ka kaluar në AUV dhe me tutje nuk janë lëshuar aktvendime për izolim sipas rekomandimeve të MSH dhe IKPSH-së
- • Janë bërë 18 inspektime, janë hartuar 896 Aktvendime për izolim, 04 pëlqime sanitare si dhe të gjitha lendet nga kjo lëmi janë zgjedhë në sistem dhe janë proceduar për arkiva.
- Nga lëmia e tregut dhe çmimeve për periudhën janar-qershor 2022 është bërë inspektimi mbi certifikimin e ushtrimit të biznesit, licencat, çmimet e mallrave të ekspozuara, mbarëvajtja e tregut në Drenas dhe Komoran, orari për fillimin dhe mbarimin e punës së barnatoreve, deklinacioni i mallit si dhe punëve tjera nga kjo lëmi.
- • Konform Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e Tregut nr. 03/L-181 dhe në koordinim të plotë me MINT-në janë inspektuar subjektet afariste (mallrat bazike elementare ushqimore vaj, miell etj.), rreth përmbushjes së standardeve të mallrave për vendosjen e tyre në treg, çmimeve, deklaracionit të mallit etj. në mbrojtje të konsumatorit.
- • Në zbatim të Ligjit Nr. 08/L-018 dhe U.A. 03/2022 lidhur me tregtimin e derivateve janë kontrolluar çmimet e përcaktuara çdo 24 orë nga MINT.
- • Po ashtu janë inspektuar furrat e bukës, kontrollimi i përdorimit të njësive matëse dhe peshoreve në qarkullim.
- • Inspektimet e subjekteve afariste rreth regjistrimit të bizneseve.
- • Kontrolle rreth zbatimit të orarit të punës, deklaracionit të mallit dhe kontrollit të çmimit të artikujve ushqimorë gjegjësisht rreth çmimeve bazike..
- • Inspektimi i sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve.
- • Inspektimet e herëpashershme sipas kërkesave dhe në bashkëpunim me MTIN-në në bazë të Ligjit të Tregtisë së Brendshme.
- • Janë bërë 343 inspektime, janë lëshuar 48 pëlqime për ushtrimin e veprimtarisë, janë shqiptuar 07 gjoba mandatore në shumën prej 2,120.00 €.

3.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

- Nga lëmia e ndërtimtarisë janë përcjellë në vazhdimësi ndërtimet rreth lejeve të ndërtimit dhe tërë dokumentacionin e nevojshëm ndërsa për shkelësit e ligjit janë marrë masat e nevojshme. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë inspektuar objekte të ndërtimit të kategorisë së I-rë dhe të II-të, mure rrethuese, rrethoja të ndryshme, rrugë të dëmtuara etj.
- Gjatë kësaj periode krahasuar me periodën e vitit të kaluar ka pasur më pak ndërtime për shkak të rritjes së çmimeve të materialit ndërtimor ku çdo herë janë zhvilluar procedurat rreth pajisjes me leje ndërtimi, ku problem në vete paraqet definimi i pronave, për shkak të problemeve rreth trashëgimisë dhe behën vonesa për tu pajisur me leje. Për të gjithë ata që nuk kanë respektuar urdhrat e inspektorit janë marrë masa ndëshkuese.
- Gjatë kësaj periudhe raportuese është bërë rrënimi i një objekti të ndërtuar në pronë publike në Komoran, si dhe janë rrënuar dy ish-objekte të vjetra shkollore në oborret e shkollave në Çikatovë të Vjetër dhe Arllat, si dhe në ngastren katstrale 414 në oborrin e Komunës janë rrënuar: objekti montazhë i barakës P+0, objekti i vjetër depo dhe garazhë P+0 si dhe objekti i pa perfunduar P+2.
- Këto rrënime janë bërë nën mbikëqyrjen e DI si dhe bartjen e shpenzimeve të rrënimit i ka bartur kjo Drejtori.

3.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Gjatë kësaj periudhe janë bërë:

- • Inspektimi i ndërtimeve në sektorin publik dhe privat që përfshinë ngritjen instalimin, renovimin, zgjerimin, ndryshimin apo adaptimin e të gjitha strukturave ndërtimore.
- • Inspektimi i lejeve të ndërtimit
- • Inspektimi i kushteve urbanistike (leja urbanistike).
- • Inspektimi i dokumentacionit teknik (projektet ndërtimore, lejet ndërtimore).
- • Lëshimi dhe modifikimi i sanksioneve dhe përgatitja e vendimeve për ndërprerjen e ndërtimeve ilegale.
- • Gjatë kësaj periudhe janë bërë 300 inspektime, 36 Aktvendime për pezullim të punimeve me destinim të ndryshëm, 20 draft-urdhra për ekzekutim (në procedurë për konfirmim), 06 rrënimë të objekteve , 01 kallzime penale si dhe 07 gjoba mandatore në shumë prej 6,500.00 €

Në lëminë e mjedisit gjatë kësaj periudhë Inspektori i mjedisit ka qenë i angazhuar rreth mbrojtjes së mjedisit nga ndotja, mbeturinat, zhurma e me theks të veçantë

inspektimi rreth ujërave të zeza sidomos në zonat rurale sipas kërkesave të qytetarëve, pastaj hyrja e qytetarëve në sistem të menaxhimit të

mbeturinave.

3.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Gjatë kësaj periudhe është bërë:

- Inspektimi i hedhjes së mbeturinave afër rrugëve, parqeve dhe vendeve tjera publike.
- Inspektimi i largimit të mbeturinave inerte në vendet ku ka pasur ndërtime,
- Inspektim dhe identifikim i deponive ilegale në tërë territorin e komunës së Drenasit,
- Inspektimet sipas kërkesave të qytetarëve rreth kanalizimeve, ujërave të zeza, plehrave, etj. sidomos në zonat rurale,
- Inspektim i varrezave të makinave mbeturinë në asistim të Ministrisë së Mjedisit,
- Inspektimi i Gurthyesve, dhe fabrikave të tjera që shkaktojnë ndotje në mjedis sipas kërkesave që kemi pasur;
- Inspektim i të gjitha objekteve natyrore me vlera të veçanta dhe identifikimi i gjendjes së tyre;
- Punë të tjera inspektuese që bien në Drejtorinë e Inspektionit, konkretisht në sektorin e Mjedisit.
- Gjithsejtë janë bërë 186 inspektime, si dhe janë shqiptuar 15 gjoba mandatore në vlerë prej 10,570.00 €.

3.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Inspektori i Komunikacionit është angazhuar konform Ligjit për transportin rrugor dhe Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Drenasit ku problem i vazhdueshëm është edhe më tutje operimi i kombi-taxive (8+1).

Për këtë Inspektori i komunikacionit së bashku me inspektorët e lëmive tjera e nën asistimin e PK-ës kanë zhvilluar aksione në parandalimin e punës së taxive ilegal dhe për këtë janë marrë masa ndëshkuese si gjoba mandatore, konfiskim të përkohshëm të automjeteve dhe tabelave të regjistrimit. Janë inspektuar Operatorët Ekonomik-autobusët rreth respektimit të rendin të udhëtimit sipas Ligjit për transportin rrugorë Nr.04/L179.

Nga kjo lëmi është punuar me sa vijon:

- Inspektimi në komunikacionin rrugor të udhëtarëve të operatorëve ekonomik (autobusët, kombibusët, autotaxit).
- Inspektimi i pajisjes së transportueseve me leje operimi, orar të udhëtimit.

3.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

- Inspektimi në stacionin e autobusëve, rrugë, parkingje etj,
- Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Njësiti në Drenas janë zhvilluar aksione për largimin e taxive ilegal (8+1) nga komunikacioni.



• Për këtë janë bërë 207 inspektime, janë hartuar 38 aktvendime dhe janë konfiskuar përkohësisht 38 automjete dhe tabela të regjistrimit, si dhe janë shqiptuar 03 gjoba mandatore në vlerë prej 600.00 €.

3.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Inspektori i Bujqësisë i cili ka filluar me punë nga 01.02.2022 sipas planit të punës ka bërë mbikëqyrjen inspektuese rreth ruajtjes së tokave bujqësore dhe të komosacionit, e sidomos rreth shfrytëzimit të tyre për bujqësi. Në kuader të kësaj është përcjellë që tokës bujqësore të mos i ndrrohet destinimi e sidomos që mos të fillojnë gjërmime apo rrafshime të terrenit për qëllime tjera në toka bujqësore.

Nga kjo lëmi është punuar me sa vijon:

- Inspektimi i mënyrës se shfrytëzimit të tokës bujqësore dhe mbikëqyrjes, nëse toka bujqësore shfrytëzohet për qëllime jo bujqësore.
- Mbikëqyrjen dhe parandalimin e ndotjes së tokës bujqësore nga ndotësit
- Inspektimet e barnatoreve bujqësore dhe kontrollimi i imputeve bujqësore (farërat, plehurat artificiale).
- Mbikëqyrja e tregjeve të kafshëve në Drenas dhe Komoran e sidomos ndalimi i therjes së kafshëve në treg.
- Inspektimi i tregut të gjelbër në Drenas rreth ekspozimit dhe shitjes së produkteve bujqësore brenda tregut.
- Punët dhe detyrat tjera sipas urdhrit të Shefit apo Drejtorit.
- Gjithsejtë janë bërë 156 inspektime, 06 aktvendime si dhe janë shqiptuar 02 gjopa mandatore në vlerë prej 1,000.00 €.

3.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Pasqyra e punës në shifra për periudhën janar-dhjetor 2022



Inspektime	1210
Aktvendime për izolim (COVID-19)	896
Aktvendime për ndërprerje të punimeve	36
Aktvendime për konfiskim të tabelave dhe automjeteve	38
Pëlqime sanitare	04
Pëlqim për ushtrim të veprimtarisë	48
Gjoba Mandatorë	34 (20,790.00 euro)
Draft-urdhër për ekzekutim	20
Rrenim të objekteve	06
Kallzime penale	01

3.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Gjatë këtij viti ka pas bashkëpunim më shumicën e ministrive në të cilën kemi respektuar masat e marra nga Qeveria.

Inspektoret edhe përgjatë “Muajit të Mërgatës” por edhe vikendeve kanë qënë në kujdestari varësisht prej nevojave të cilat kanë rrjedhë si rezultat i dinamikes së punëve.

Është mese e nevojshme plotësimi i vendit të punës me një inspektor të shërbimeve komunale në përputhje me nevojat e Drejtorisë, si dhe të bëhet rregullimi i kushteve të tregut të gjelbër dhe të kafshëve në Drenas dhe Komoran.

3.6. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa punët dhe detyrat e punës i ka kryer duke u bazuar në Plan-programin e punës, të mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03 / L-049, Ligjin për vetëqeverisjen Lokale nr. 03 / L-040, rregulloret, vendimet, udhëzimet e MEF-it dhe Kuvendit të Komunës, si dhe në bazë të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit.

Ky Drejtorat, punën e vetë kryesisht e ka orientuar në këto lëmi:

Raporti i punës dhe financiar për vitin 2022,

Pasqyrat financiare 2022,

Procesi buxhetor-Strategjia Fiskale 2024-2026, sipas kërkesave fillestare,

Aprovimi i shpenzimeve dhe certifikimi për buxhetin komunal sipas programeve,

kryerja e pagesave lidhur me shpenzimet operative dhe kapitale, si dhe barazimi me raportet e SIMFK,

Punët lidhur me arkën e parave të gatshme (arkëtimi dhe pagesat),

Regjistrimi në sistemin kompjuterik i të gjitha të hyrave të arkëtuara nga burimet vetanake dhe barazimi ditor, javor, mujor dhe periodik me SIMFK,

Autorizimi i shpenzimeve për D.B.F,

Përcjellja e të hyrave publike të akorduara nga B.K.K,

Përgatitja e transfereve të parave të depozituara në llogaritë e thesarit të MEF-it,

Caktimi i tatimit në pronë- shpërndarja e faturave për vitin 2023,

3.6. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Evidentimi i objekteve të reja si pasuri e paluajtshme dhe rimatja e objekteve,

Përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal,

Raporti i punës dhe financiar sipas periodave të vitit /2022,

Propozim Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026,

Shlyerja e pagesave për tatimin në pronë,

plotësimi i formularëve për buxhetin 2024-2026, sipas kërkesave fillestare,

Trajnimin e punëtorëve të D.B.F,

Punë dhe detyra tjera të punës për pushtetin lokal dhe qendror,

Punët me palë në lëmin e buxhetit dhe financave.

Struktura e përgjithshme organizative për funksionet e Drejtoratit për Buxhet dhe Financa, tani më është e bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës, sipas Sektorit të Buxhetit, Thesarit dhe Financave.

3.6. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Sektori i Buxhetit - Për periudhën janar-dhjetor/22, do të realizohen këto punë dhe detyra pune:

Zhvillimi i aktivitetit lidhur me planifikimin e buxhetit komunal 2024-2026, sipas kërkesave fillestare,

Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026,

Vërtetime tjerë për qytetarët lidhur me rregullimin e dokumentacionit,

Numri i kërkesave të regjistruara dhe koduara për shpenzime nga shfrytëzuesit e buxhetit komunal,

Lëshimi i faturave sipas kërkesës së palëve,

Ruajtja e databases për të dhënat e regjistruara,

Objektet e reja të matura – rimatura,

Fatura të shpërndara përmes postes,

Numri i ankesave të pranuar,

Pranimi i kërkesave për regjistrimin e objekteve të reja.

3.6. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Sektori i Thesarit - Në këtë sektor, punët dhe detyrat e punës do të kryhen si vijon:

Arkëtimin e parave të imta për shërbime në ofiçari, arkiv, Gjeodezi, Urbanizëm, shërbimet e pagesës së tatimit në pronë, dhe për shpallje të tenderëve - shërbime për arkëtim të parave të imta. Përveç arkëtimit, është bërë përgatitja dhe depozitimi ditor i parave në llogarinë bankare të Komunës.

Regjistrimi i të hyrave vetanake të arkëtuara është bërë për çdo ditë në database dhe në sistemin e Freebalancit,

Transferi i të hyrave vetanake nga llogaria bankare komunale në llogari të thesarit MEF për çdo fund muaji,

Barazimi i raporteve të arkës me raportet e bankës dhe kontrollimi i tyre për çdo ditë,

Hartimi i raporteve mujore për të hyrat vetanake për nevoja të ekzekutivit dhe MEF-së,

Zotimi i parave publike për qëllime të pagimit të shpenzimeve operative dhe kapitale, sipas modulit të blerjes, dhe sipas modulit të aprovimit,

Kryerja e pagesave nga buxheti i Sektorit të Përgjithshëm (drejtoritë dhe zyrat komunale) për të gjitha lëndët që janë të kompletuara,

Certifikimi UOP sipas Modulit të aprovimit ,

Certifikimi i UOP sipas modulit të blerjes,

Certifikimi i avanseve për udhëtime zyrtare jashtë vendi,

Aprovimi i avanseve për udhëtim jashtë vendit ,

Regjistrimi i UOP,

Dorëzimi i UOP në arkiv,

Përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal sipas sektorëve kryesor dhe programeve.

3.6. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Sektori i Financave

Përgatitja e pasqyrave financiare për vitin /2022,

Certifikimi i dokumentacionit financiar për buxhetin komunal sipas programeve – drejtorateve dhe zyrave komunale me modulin e blerjes,

Certifikimi i lëndëve për pagesë sipas modulit të aprovimit,

Përgatitja e regjistrit të faturave të paguara për dosjet e dokumentacionit financiar, për 12 muajt e vitit.

mbajtJA evidencëS analitike për të gjitha lëndët e certifikuara sipas shpenzimeve veç e veç

(raporti analitik i SIMFK-së),

Raporti i punës-financiar për periodën Janar-Mars /2023,

Raporti i punës-financiar i periodës janar-qershor/ 2023,

Raporti financiar për periodën janar-Shtator/2023,

Plani i punës për vitin 2023.

3.6. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Zyra e Tatimit në Pronë

Evidentimi i raste të reja,

Verifikimet në teren,

Lëndë të miratuara,

Pagesa të pranuar në arkë,

Prona të regjistruara,

Modifikimi i të dhënave të pronës dhe tatimpaguesve,

Fshirjen e pagesave të TPR nga arka deri në 10 euro,

Lëndë të anuluar,

Regjistrim i tatimpaguesve,

Verifikime Burimore,

Certifikata të pagesës për TPr,

Shpronësimet dhe ndërrimet e pronarëve,

Referime kadastrale,

Modifikim i objekteve dhe tatimpaguesve,

Korrigjime dhe kalkulim manuale të pagesave,

Riprogramim i marrëveshjeve,

Kontrata shitblerjesh,

Vendime nga komisioni i ankesave,

Certifikata të tatimpaguesve,

Certifikata për jo tatimpagues.

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale gjatë vitit 2022 ka punuar me dy punëtorë administrative në dy sektore organizative

1. **Spektori i Shëndetësisë**
2. **Spektori i Mirëqenies Sociale**

Punët dhe aktivitetet e DSHMS-së për vitin 2022 janë të bazuara në planin e punës, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë të cilat janë në kuadër të DSHMS



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY OF GLOGOVAC



Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes

03/01/2022 - 30/12/2022, Drejtoria: DSHMS

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezullua r	Ceduar	Anuluar	Perfundu ar	Totali
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	3	120	827	58	7	0	0	6	0	1,021
		3	120	827	58	7	0	0	6	0	1,021

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Paraqitja e lëndëve në intranet ne kaudër të DSHMS-së :

Banimi Social – përmes shpalljes publike për aplikim janë kryer të gjitha procedurat e shpalljes, shqyrtimit të aplikacioneve dhe vendosjes së përfituesve të banimit të perkohshëm social, në periudhën dy vjeçare ku në të dy blloqet e banimi janë vendosur gjithësej 49 familje, një banesë është shpallur e pabanueshme sipas komisionit për çështje të banimit të perkohshëm social.

Programi i D.SH.M.S. i furnizimit me miell për Skamnorrë, Subvencionimi nga të hyrat vetanake të Komunës Drenasit

Furnizim me miell	10,000 Kg	0.56	5.600 euro
Subvencione Rehabilitim/shërim	51 raste		8.220 euro

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

HYRJA

Duke u bazuar në Ligjin e Shëndetësisë së Kosovës si dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale i cili ka inkorporuar në tërësi konceptin e Mjekësisë Familjare duke e definuar atë si “formë themelore e ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor, për individët dhe familjet e tyre”, KPSH në Komunën e Drenasit shërbimet shëndetësore i ofrohen në bazë të konceptit të Mjekësisë Familjare bazuar në legjislacionin në fuqi.

Infrastruktura dhe objektet e ka një trend të përmirësimit përjashtimisht objekti I QKMF në Drenas që konsiston me një kosto të lartë të mirëmbajtjes për arsye të amortizimit të rrjetit të ujit, rrjetit të rrymes, instalimit të nxemjes qendrore dhe gupave perçjellës të ujërave të zeza si dhe problemet me ujë atmosferik amortizim I qatës dhe gypave perçjellës. Përkundrazi amortizimit të objektit në realizimin e impaktit të shërbimeve në këtë gjashtë muor ka ndikuar edhe gravitimi I kërkuarëve të shërbimeve shëndetësore, fluksi I madh I pacientëve përkundrazi rrjetit institucional që ka shkruar në trend të funksionalizimit.

Duke u nisur nga ky fakt kapaciteti ofrimit të shërbimeve shëndetësore është në disproporcion me fluksin e pacientëve të orientuar në QKMF Drenas dhe QMF Komoran. Ky disproporcion ulë pritshmërinë e lartë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe kërkesën e pacientëve në ofrimin e këtyre shërbimeve. Ndikim në realizimin e objektivave indirekt ka ndikuar edhe moshë mesatare e personelit shëndetësor dhe mungesa e mjekëve specialist nga lëmia e Mjekësisë familjare.

Një studim i organizuar nga Agjencioni për Bashkëpunim Zvicëran dhe e implementuar nga Projekti i AQH ka treguar se ofrimi i shërbimeve me theks në Sëmundjet Kronike Masovike Jo Ngjyëse por dhe në fushat tjera ka treguar se nevojitet përmirësim dhe vetëdijësim, si nga ana e personelit shëndetësor ashtu edhe të komunitetit në mënyrë që të parandalohen dhe trajtohen këto patologji duke siguruar një efikasitet më të mirë të shërbimeve, parandalimin e sëmundshmërisë si dhe përmirësimin e kualitetit të jetës. Pajimi i departamenteve dhe sektoreve pothuajse është kompletuar nga buxheti I aprovuar nga DSHMS dhe donacioni nga MSH, UNICEF, AQH –ja.

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Misioni i QKMF „Dr.Hafir Shala’ Drenas është mbrojtja,përmisimi dhe promovimi I shendetit dhe mirëqenies për të gjithë banoret e komunës së Drenasit duke ofruar sherbime mjekësore dhe duke siguruar një progress të qendrueshëm të sistemit shëndetësor primar.

Vizioni i QKMF-së është: *“Njerëz të shëndetshëm në komunitet të shëndetshëm”* duke zbatuar konceptin e shërbimit të mjekësisë së familjare nga ekipi Mjekë dhe infermier familjar në komunitetin që mbulohet nga QKMF dhe njësit pëkatëse.

QKMF është qendër me shërbim 24 orë dhe jep shërbim shëndetësor për një popullatë prej 58531 banorësh dhe me një sipërfaqe mbulimi 275.8 km². QKMF është njësi Urgjente në nivel të organizimit regjional përgjigjet për urgjencat e në nivelin local dhe regjional dhe në bazë të vendimeve nga MSH ne tërë teritorin e RK. Në dispozicion të komunitetit për çdo rast urgjence mjekësore është edhe mjeti i Autambulancës dhe ekipa mjekësore per mbrojtje të avancuar të jetës (MAJ).

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Vlerat në QKMF, QMF, AMF

1. **Dinjiteti:** Trajtimi me respekt dhe konsideratë i çdo pacienti, anëtari të stafit dhe anëtari të komunitetit si dhe mirëkuptimi i ndryshimeve ndërmjet tyre;
2. **Angazhimi:** Çdo anëtar i stafit është i dedikuar ndaj misionit të ISH, komunitetit në përgjithësi dhe çdo pacienti në veçanti;
3. **Përsosmëria:** ISH arrin nivel të lartë përsosmërie në plotësimin e misionit të saj duke promovuar integritetin personal e profesional, përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si dhe përdorimin e njohurive dhe teknologjive bashkëkohore;
4. **Integriteti:** Stafi përdor standartet më të larta të etikës dhe profesionalizmit si dhe siguron nivelin më të lartë të besimit, nëpërmjet ndershmërisë në praktikën e përditshme;
5. **Dhimbshuria:** Stafi tregon vazhdimisht mirëkuptim, ndjeshmëri dhe kujdes ndaj pacientëve;
6. **Bashkëpunimi:** Anëtarët e stafit në ISH pranojnë të punojnë mirë me njëri-tjetrin, pacientët, organizmat qeveritare e jo-qeveritare, donatorët dhe komunitetin.

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Struktura organizative e QKMF-së bazohet në Statutin e QKMF dhe përbëhet nga Departamentet, Sektorët dhe Njësitë

I. Departamenti i Mjekësisë Familjare me Sektorë dhe Njësi:

1. Sektori i Mjekësisë Familjare

2. Sektori i Shëndetit Oral

3. Sektori i Diagnostikës

a) Njësia e Labororit dhe

b) Njësia e Rentgenit

4. Sektori i Shëndetit Publik

a) Njësia e Vaksinit dhe Imunizimit

5. Njësia e Sistemit Informativ Shëndetësor.

6. Sektori i Kujdesit Urgjent

II. Departamenti i Administratës:

a. Njësia për Buxhet dhe Financa

b. Njësia Juridike dhe personelit dhe

c. Njësia për transportin e pacientëve

ç. Njësia e mirëmbajtjes së higjienës dhe rrobalarja

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Struktura organizative e QKMF-së bazohet në Statutin e QKMF dhe përbëhet nga Departamentet, Sektorët dhe Njësitë

I. Departamenti i Mjekësisë Familjare me Sektorë dhe Njësi:

1. Sektori i Mjekësisë Familjare

2. Sektori i Shëndetit Oral

3. Sektori i Diagnostikës

a) Njësia e Labororit dhe

b) Njësia e Rentgenit

4. Sektori i Shëndetit Publik

a) Njësia e Vaksinit dhe Imunizimit

5. Njësia e Sistemit Informativ Shëndetësor.

6. Sektori i Kujdesit Urgjent

II. Departamenti i Administratës:

a. Njësia për Buxhet dhe Financa

b. Njësia Juridike dhe personelit dhe


c. Njësia për transportin e pacientëve

ç. Njësia e mirëmbajtjes së higjienës dhe rrobalarja

III. Barnatorja Qendrore – e cila funksionon në kuadër të QKMF-së që bënë distribuimin dhe disperzimin e barnave nga lista e barnave esenciale në të gjitha QMF-të dhe Ambulancat Shëndetësore.


3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

ORGANOGRAMI – STRUKTURA ORGANIZATIVE E QKMF ,Dr.Hafir Shala’



3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

TRUPAT PROFESIONALE DHE UDHËHEQJA E QKMF , Dr. Hafir Shala' DRENAS



3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

OBJEKTIVAT TË QKMF- së

Bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe misionin që ka QKMF si objektivin strategjik për vitin 2022 e ka përkufizuar si:

Sigurimi i shërbimeve shëndetësore themelore dhe cilësore të ofrohen në kuadër të KPSH dhe duke u bazuar në konceptin e Mjekësisë Familjare.

Ojektivat specifike:

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore
- Forcimi i kapaciteteve profesionale, të menaxhimit dhe llogaridhënës
- Zhvillimi i resurseve humane - Promovimi shëndetësore dhe pjesëmarrja e komunitetit në shërbime e ofruara
- Përmirësimi i komunikimit ndërsektorial dhe ndërinstitutional
- Fuqizimi i i punës ekipore
- Evalumimi dhe monitorimi

Objektivat janë zbatuar duke u udhëhequr nga parimet :

- Barazia
- Cilësia
- Ndershmëria dhe përgjegjësia
- Gjithëpërfshirja dhe jo diskriminimi
- Financimi i qëndrueshëm
- Financimi kosto-efektiv
- Bashkëfinancimi

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

OBJEKTIVAT TË QKMF- së

Shërbimet shëndetësore që ofrohen nga rrjeti i institucioneve të KPSH-së përfshijnë:

- Shërbimet e promovimit shëndetësorë, përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin
- Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese
- Shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrje të vogla kirurgjike
- Shërbime të kujdesit akut dhe urgjent
- Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike
- Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinjë
- Shërbimet e kujdesit ante/peri dhe post natal
- Shërbimet e shëndetit oral prevenues
- Shërbimet e shëndetit mendor
- Shërbimet e vizitave shtëpiake përfshirë këtu shërbimet e kujdesit të nënave dhe fëmijëve deri në moshën tre vjeçare, kujdesin terminal/palativ
- Shpërndarjen e barërave nga lista esenciale.

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Aktivitetet në nivel të QKMF

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore përmes:

- * Organizimit dhe menaxhimit më efikas të resurseve në dispozicion përmes racionalizimit dhe distribumit më adekuat.
- * Ngritja e numrit të personelit shëndetësor me theks në ata me përgaditje superiore dhe në këtë mënyrë është arrit mbulimi më i mirë i të gjitha shërbime mjekësore ku gjatë vitit 2022 pas kompletimit të procedurave të rekrutimit janë punësuar 7 doktor të mjekësisë, dhe 6 infermier.
- * Përmirësimi i raportimit nga përgjegjësit e departamenteve dhe sektoreve si dhe të përgjegjësve në nivel të QMF-ve dhe AMF-e ku është synuar komunikimi si dhe koordinimi më efikas i aktiviteve, delegimi i përgjegjësive si dhe shkëmbimi i informatave.
- * Përmirësimi i rrjedhës së pacientëve në të gjitha sektoret si dhe në QMF-t me theks në Sektorin e Mjekësisë Familjare në partneritet me Projektin e AQH.
- * Zvogëlimi i ankesave nga ana e kërkuësve të shërbimeve.
- * Ofrimi të shërbimeve më afër qytetarit përmes projektit shërbimeve të kontraktuara me KOSOVAMED

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Aktivitetet në nivel të QKMF

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore përmes:

- * Mbikqyrja më efikase dhe racionalizimi i shpenzimit materialit të punës në të gjitha sektoret.
- * Ngritja e komunikimit në vijë horizontale dhe vertikale si dhe ngritja e përgjegjësi dhe llogaridhënjës.
- * Menaxhimi më efikas i disperzimit të medikamenteve dhe materialit shpenzues nga LEB në pajtim me prenotimin komunitar si dhe të Insulinave si medikament jetik për personat me sëmundjen e diabetit të tipit 1.
- * Ngritja e shërbimeve në Sektorin e Shëndetit Oral përmes shërbimeve të kontraktuara me OE Kosovamed ,Vizitat e nxënësve për shëndetin oral
- * Vazhdimësia e ofrimit të shërbimeve laboratorike me të gjitha analizat të cilat kryhen në KPSH, përmes furnizimit kontinuel, aktivizimit në njësi në QMF-ve si dhe ngritjen e numrit të personelit përmes O.E. Kosovamed.
- Ngritja e përvshirjes së fëmijëve në vaksinimin e rregullt sipas kalendarit të vaksinimit si dhe imunizimit dhe vaksinimit kundër COVID-19.
- * Përvshirja e numrit të personelit në aktivitetet e ZHVP-së si dhe pjesëmarrja në trajnimet e organizuara nga AQH, UNICEF UNFPA
- * Përmirësimi i vizitave shtëpiake për nënën dhe fëmijun, e aprovuar nga MSh dhe përkatëse nga UNICEF.
- * Bashkëpunimi me të gjitha palët e interesit me theks të veçantë me DSHMS dhe MSH

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Departamenti i Mjekësisë Familjare

Sektori i Mjekësisë Familjare

Si sektor më i madh në aspektin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, burimeve njerëzore, objekteve dhe hapësirave punuese ky sektor edhe gjat vitit 2022 ka qenë një nga bartësit kryesor të aktiviteteve dhe implementimit të konceptit të Mjekësisë Familjare. Një nga objektivat ka qenë ngritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara si dhe shërbimet me pacientin në qendër.

Ofrimi i kujdesit dhe shërbimeve shëndetësore në mënyrë kontinuele për të gjithë kërkuesit e shërbimeve shëndetësore.

Ofrimi i kujdesit shëndetësor për pacientët me sëmundje kronike si dhe atyre me nevoja të veçanta e të cilët për shkak se nuk kan pasur qasje në Institucioneve shëndetësore përmes projektit të shërbimeve të blera nga O.E. Kosovamed janë kryer vizitat dhe shërbimet e shëndetit paliativ.

Ne këtë vit përmes DSHMS është realizuar rekrutimi i kuadrove dhe është arritur që të stabilizohet numri i profesionistëve shëndetësor mjekë në KPSH sipas U.A.04/2020, por ende mbetet sfida plotësimi i kriterit me Mjekë specialist të mjekësisë familjare. Një trend i tillë është duke e përcjellur KPSH-në për arsye të mos interesimit për specializim nga kjo lëmi përkundër përkrahjes nga Institucioni dhe DSHMS-ja.


Me qëllim të ofrimit të shërbimeve bazike shëndetësore në KPSH AMF janë paisur me pajisje shëndetësore elementare nga bugjeti vetanak dhe në bazë të standardit për ofrimin e këtyre shërbimeve. Ky proces i plotësimit të standardit bazik është plotësuar pothuajse komplet edhe me pajisje mjekësore.

Plotësimi i standartit me pajisje mjekësore në AMF-të sipas UA 04/2020. (Foto : AMF Tërstenik)



3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Riorganizimi i ofrimit të shërbimeve në Sektorin e Urgjencës, Mjekësisë Familjare, Shëndetit Oral, Imunizimit dhe Vaksinit për t'u kthyer në normalitet pas aplikimit të vaksinimit kundër COVID 19. Përkunder senzibilizimit të komunitetit për rëndësinë vaksinimit interesimi për vaksinim është jo i knaqshëm.



3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në diagram janë të paraqitura totali i vizitave dhe shërbimeve në QKMF,QMF dhe AMF.Ne bazë të këtijë diagrami vërehet se qasja në vizita dhe shërbime shëndetësore, kerkuesit e shërbimeve shëndetësore janë të përqendurur në QKMF Drenas dhe QMF Komoran.Një dispropocion i tillë është duke na përcjellur në vazhdimësi për shkak të pritshmerisë së lartë të pacientëve për shërbime shëndetësore në këto dy qendra. Dy qendra për arsye të renovimit nuk kanë funksionale dhe qasja në shërbime shëndetësore nuk ka qenë e arritshme.

VIZITAT DHE SHËRBIMET NË SEKTORET E MJEKËSISË FAMILJARE



	Vizitat shtëpiake shëndetit paliativ	Vizita në MF	Referi në QKUK	Vizita në Emergjencë	Shërbime	Infuzione	Injeksiione	Inhalim	EKG	Imazheri	Laborator marrja e gjakut për analizë	Laborator Numri i parametrave të analizave	Plagë pastrim Lidhje
QKMF		43289	7102	38172	232073	21705	42355	318	2771	7697	5501	82641	17.253
QMF Komoran		38213	6861	17871	107530	12904	29775	1096	1284	0	4794	47790	4771
QMF Arllat		2480	231		2419	58	1282	8	0	0	75	75	809
QMF Gllanasel		1382	78		1054	6	656	8	0	0	27	27	285
QMF Tersteni		2067	161		1948	141	1111	6	0	0	109	109	415
QMF Baicë		1102	78		1975	113	1195	0	0	0	21	21	567
AMF Nekoc		1398			990	15	557	1	0	0	5	5	377
AMF Sankoc		33	10		52	0	12	0	0	0	1	1	36
AMF Poklek		0			0	0	0	0	0	0	0		0
AMF Gradic		284	13		104	0		0	0	0	7	7	13
AMF Abri e Epërme		0			0	0	0	0	0	0	0	0	0
AMF Terdec		0			112	0	69	0	0	0		0	43
AMF Dobroshec		554	46		301	0	116	1	0	0	31	31	62
Shërbimi Paliativ	8342		3		20220	5571	6307	0	0	0	20	1348	2133
Totali	8342	90802	14583	56043	368778	40477	83435	1438	4055	7697	10591	132055	26764

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Numri total i vizitave dhe shërbimeve në të gjitha njësitë e QKMF

Vizita mjekësore-----184233

Shërbime mjekësore-----348556



3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

VIZITAT NË SHTEPI PËR GRATË SHTATËZANA DHË FËMIJË DERI 3 VJEÇ

Programi I vizitave në shtëpi për gratë shtatëzana dhe femijet deri në moshën 3 vjeç nuk shënuar një trend të knaqëshëm në bazë të objektivave të planifikuara. Për arritjen e performacës së duhur është e nevojshme të bisedohet me stafin profesional për rëndësinë e këtij programi dhe implementimin domosdoshmërisht.

Komuna e _Drenas2022		Total
1	Numri i vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç	1228
2	Numri i vizitave në shtëpi për shtatëzana	261
3	Numri total i vizitave në shtëpi të kryera	1489
4	Nr. i fëmijëve vajza 0-3 vjeç të cilat janë vizituar për herë të parë	215
5	Nr. i fëmijëve djem 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë	225
6	Nr. total i fëmijëve 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë	440
7	Numri i vizitave të dyta për fëmijët 0-3 vjeç	72
8	Numri i vizitave të treta për fëmijët 0-3 vjeç	62
9	Numri i vizitave të katërta për fëmijët 0-3 vjeç	10
10	Numri i vizitave të pesta për fëmijët 0-3 vjeç	9
11	Nr. i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas lindjes	116
12	Numri i shtatëznave që janë vizituar për herë të parë	112
13	Numri i shtatëznave që kanë pranuar vizitën e dytë	16
14	Numri i fëmijëve 0-3 vjeç nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	0
15	Numri i grave shtatëzana nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	0
16	Numri i fëmijëve të referuar tek specialistët mjekësorë nga ekipi i mjekësisë familjare	11
17	Numri i vizitave shpesh për fëmijë dhe shtatëzana (Jashtë standardit të programit të vizitave në shtëpi)	383
18	Numri i baballarëve të përfshirë gjatë vizitave në shtëpi	235
19	Numri i rasteve sociale të identifikuar dhe të referuar	78
20	Numri i rasteve të dhunës të identifikuar (nga observimi gjatë vizites në shtëpi)	0
21	Numri i fëmijëve të identifikuar me ngecje në zhvillim dhe të referuar (nga observimi gjatë vizites në shtëpi)	1
22	Numri i infermierëve që janë angazhuar në zbatimin e vizitave në shtëpi	3

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Sektori i Diagnostikës.

Sherbimet Laboratorike

Gjatë kësaj periudhe shërbimet janë ofruar me personel të plotë në mënyrë që të arrihet qasja më e lehtë dhe cilësore e këtijë shërbimi . Edhe pse kërkesat për analiza ka qenë të larta për arsye të qetsimit të situatës pandemisë, gjatë gjithë kohës qytetarëve u janë ofruar analizat të cilat janë në kuadër të KPSH. Pas një fluksi të shtuar të pacientëve ka rifilluar edhe caktimi i termineve e cila ka qenë variabël prej 1 deri në 2 ditë. Duhet theksuar se analizat emeregjente janë kryer brenda ditës. Kryerja e analizave laboratorike është realizuar në kontinuitet gjatë gjithë kohës.

Kërkesat jashtëzakonisht të mëdha për analiza laboratorike shpeshëherë të panevojshme qoftë nga mjekët në KPSH dhe mjeket konsulent , (gjë e do jetë prioritet rregullimi i kësaj qështje por edhe nga klinikat dhe ordinancat private kanë qenë një nga sfidat edhe gjatë këtijë viti. Kjo anomali është edhe si rezultat i pamundësisë së aplikimit të zonimit dhe hapjes së kartelave shëndetësore. Një audit i realizuar grupi punues ka treguar se më shumë se 80% të analizave të kërkuara kanë qenë në vlera normale gjë që ka shkaktuar mbingarkesë të aparturës dhe personelit e me këtë është rrezikuar edhe siguria e vet analizave. Mirëmbajtja dhe servisimi i paisjeve nga serviserët e autorizuar ka ndikuar që të realizohen shërbimet laboratorike, edhe pse në fillim kemi pasur vështirësi deri sa është nënshkruar kontrata me OE për mirëmbajtje dhe kalibrim të paisjeve mjekësore.

Në bashkpunim me projektin e AQH-së është në perfundim zgjerimi i hapësirës së laboratorit në QKMF Drenas ,ku me këtë investim është arritur që të krijohet një hapësirë e mjaftueshme dhe standard në kryerjen e analizave laboratorike. Ky investim për AQH-së dhe miratim të DSHMS do të lehtësojë punën e profesionistëve shëndetësor dhe një qasje të knaqëshme për pacient në kryerjen e shërbimeve laboratorike.

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Renovimi dhe zgjerimi i hapsirës në laboratorit përmes projektit të AQH


Foto 2. Renovimi i hapsirës së Laboratorit QKMF



3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Shërbimet e imazherisë


Ky shërbim ka vazhduar në trendin e ofrimit të shërbimeve të imazherisë, mamografisë dhe ehosonografisë. Numri i shërbimeve të imazherisë është i kënaqshëm ,por shërbimet e ehosonografisë pritja në termine është e gjatë me përjashtim të rasteve urgjente që kanë prioritet të menjëhershëm nga radiologu. Me qëllim të uljes së kohës së termineve ne bashkpunim me DSHMS jemi në hartim të planit në trajnimin e mjekut familjarë në aplikimin e ultrasonografisë që do të ndihmojë në fuqizimin e diagnozës nga mjeku familjar.



QKMF - Drenas - Sektori	
IMAZHERIA-SHERBIMET	Diagnostik / Rentgeni
Echosonografia (88.78 / 88.79)	949
Rtg. pulmo	1979
Rtg. gjymtyrëve	1655
Rtg. sinusëve	180
Rtg. vertebrave cervikale	444
Rtg, vertebrave L - S	540
Rtg. komblikut	76
Rtg. toraks	98
Rtg. Kraniogram	0
Rtg. urotrakt nativ	71
Rtg. mastoide	0
Rtg. abdomen	7
Eksponime	7648
Mamografi	49


3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në shërbimin e rengenit është funksionalizuar aparati i ri i rengenit me bartje të imazheve në ordinacën e mjekut dhe egzaminimet e vertebrogramit i stardartizun për të gjitha moshat.



3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Shërbimet Laboratorike dhe imazherisë janë në trend të kënaqshëm dhe realizohen në bazë të U.A. 04/2020. Në diagram janë të përfshira aktivitetet në analizat laboratorike në QKMF,QMF,AMF dhe shërbimet e imazherisë në QKMF.Sherbimet laboratorike në bazë të U.A. relizohen edhe në AMF si analiza të domosdoshme bazike në ndihmesë të Mjekut familjar.



Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
“Dr. Hafir Shala”

Mjekësia Familjare –Sherbimet e vaksinimit sipas programit kombtarë Vaksinimi i obliguar
 Periudha Janar - Dhjetor 2022
 Qendra e Vaksinimit - QKMF-Drenas
 Raporti mbi suksesin e Vaksinimit te Rregullt në Komunen e Drenasit

<u>Lloji i Vaksinave</u>	Dozat e dhëna	Planifikimi	Perqindja
BCG	148	148	100%
Hep B	148	148	100%
IPV1	807	823	98,05%
IPV2	797	823	96,84%
IPV3	808	823	98,17%
DTP+Hep+Hip1	807	823	98,05%
DTP+Hep+Hip2	797	823	96,84%
DTP+Hep+Hip3	808	823	98,17%
MMR	721	811	88,90%
DTP-r1	728	811	89%
OPV-r1	728	811	89,76%
DT-pediatrik	867	867	100,00%
OPV-r2	867	867	100%
MMRr	867	867	100%
dt-proadultis	841	853	99%
OPV-r3	841	853	98,59%
dt-proadultis kl.XII	734	745	98,59%
dt-tek te lenduarit	416	416	97,05
Tetabulin 250 IU	229	229	97,05
Vaksiflu	2400	2400	100%
Hep B per te rritur	57	57	100%

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Suksesi i vaksinimit në bazë të planifikimit 92.6%



QKMF-Drenas Qendra e Vaksinimit	
Numri i personave të vaksinuar me vaksinën kundër Covid-19 në vitin 2022	
Pfizer doza -I	1011
Pfizer doza -II	1471
Pfizer doza -III	2284
Pfizer doza -IV	37
Data:21.12.2022	

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Shërbimi i vaksinimit në kuadër të KPSH ndër vite ka treguar një performancë shumë të mirë në përfshirjen e fëmijëve në kalendarin e rregullt të vaksinimit. Gjatë këtij viti janë realizuar aktivitetet e vaksinimit në bazë të programit kombëtar për vaksinim të obliguar. Ky aktivitet vazhdon edhe gjatë vitit në realizimin e planifikimit të vaksinimit të rregullt. Në kuadër të këtij shërbimi është realizuar edhe vaksinimi kundër COVID 19 në bazë të Planit të veprimit me kapacitete të mbuluara me profesionist shëndetësor infermier nga MSH deri në muajin Qershor ku edhe u është ndërprerë kontrata. Në këtë vit shërbimi i vaksinimit në Drenas dhe njësitë tjera të QF është furnizuar me 7 frigorifer për ruajtjen e zingjirit të ftohtë nga UNICEF përmes M.SH.

- 13000 femije janë vaksinuar me vaksina të rregullta
- 4803 persona të vaksinuar me vaksinen kundër Covid19
- 2216 persona të vaksinuar me vaksinën e gripit

Prej muajit janar deri me datë 15 qershor në shërbimin e vaksinimit kanë shërbyer 6 ekipe të vaksinimit, përfshirë këtu mjekët dhe infermierët e punësuar nga Ministria e Shëndetësisë me kontratë deri me 15.06.2022

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

- 4 ekiye të vaksinimit (4 mjekë dhe 8 infermierë) kanë shërbyer në Qendrën e Vaksinimit në QKMF - Drenas në dy ndërrime paradite - pasdite nga 2 ekiye në ndërrim, me rotacion.
- 1 ekip ka shërbyer në QMF-Komoran dhe
- 1 ekiye në teren për vaksinimin e personave paliativ.
- Në koordinim dhe bashkëpunim me DKA, kemi organizuar vaksinimin e nxënësve nëpër shkolla, duke vaksinuar gjithsej **4307** nxënës me vaksina të rregullta sipas kalendarit të vaksinimit.
- 2601 nxënës të klasave të para
- 1706 nxënës të klasave të gjashta dhe
- 734 nxënës të klasave të dymbëdhjeta.

Gjatë vitit 2022, punëtorët shëndetësor të vaksinimit kanë mbajtur shumë trajnime të organizuara nga MSH dhe IKSHPK.

Pas përfundimit të trajnimit për regjistrimin e vaksinave të rregullta dhe me indikacion në sistemin BHIS, kemi filluar me regjistrimin në sistem të gjithë fëmijëve që i kemi të evidentuar me numra personal duke

ju regjistruar secilën dozë të vaksinës që e kanë marrë paraprakisht dhe dozën që e merr fëmiju aktualisht. Ky proces vazhdon.

Prej fillimit të muajit nëntor deri në fund të muajit dhjetor kemi vaksinuar 2212 persona me vaksinën kundër gripit sezonal, kjo vaksinë vazhdon deri në fund të muajit maj. Më 28.12.2022 e kemi organizuar Karvanin e Vaksinimit në sheshin “Fehmi Lladrovci” ku personat e interesuar kanë pasur mundësinë të vaksinohen me vaksinën kundër gripit sezonal dhe vaksinën kundër Covid19.

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Njësia e SISH-it

Ndërsa njësia e SISH është ballafaqur më disa vështirësi me theks në funksionimin e sistemit, kryesisht për shkak të problemeve me operatorët e rrjetit të komunikacionit elektronik por edhe mungesës së personit për IT.

Edhe në këtë segment situata e krjuar ka pas ndikim në përmbushjen e objektivave.

Ndonëse nga MSh ka pas progres në funksionalizimin më të mirë, mund të thuhet se ka pas edhe dështime në funksionalizimin e plotë të BHIS në AMF me çka është pamundësuar kompletimi dhe i funksionimit të këtij sistemi.

Në këtë periudhë a pasur mungesë të letres për arsye të mos përmbushjes së kontratës nga OE i kontraktuar nga niveli qendror.

Futja e të dhënave nuk është në nivel të dëshirueshëm qoft për shkaqe objektive por edhe atyre subjektive gjë që po shkakton probleme në përgaditje e raporteve dhe tabelave numerike periodike.

Për arsye të mos funksionalizimit të Web aplikacionit në të gjitha njësitë e Qendrave familjare një pjesë e profesionistëve shendetësor kanë vështirësi në aplikimin e Web aplikacionit.

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Sektori i Urgjencës

Si Njësi e Urgjencës në nivel regjional me kapacitetet e disponueshme ka arritur që të realizojë objektivat në qasjen e shërbimeve urgjente. Ky sektor është në trend të riorganizimit deri sa të zbatohet sistemi i integruar i emergjencave në nivel kombëtar.

Si njësi e KPSH ka vështirësitë e organizimit dhe kostos së lartë operimit për arsye të kapaciteteve të plota në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe mbrojtjen e avancuar të jetës(MAJ).

Në këtë sektor është e domosdoshme të intervenohet në trajnimin e personelt në MAJ duke marrë parasysh rritjen e numrit të aksidenteve , traumave dhe veprimin e shpejtë dhe profesional në trajtimin e rasteve urgjente dhe Emergjente. Ky sektor ka kryer edhe të gjitha aktivitetet dhe detyrat e regullta në menaxhimimin e rasteve urgjente si dhe rasteve tjera të cilat kanë kërkuar ndihmë në këtë sektor.

Sektori është i paisur me aparaturë dhe ka pas furnizim kontinuel me medikamente, material shpenzues, mjete për mbrojtje personale si dhe dezinfektues. Vështirësitë të cilat e kanë përcjellë këtë sektor është, fluksi i shtuar i rasteve joemergjente, mungesa e gazit medicinal, futja jo e mjaftueshme në databazë e të dhënave në SISH

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

VIZITAT DHE SHERBIMET E SEKTORIT TË URGJENCËS NË QKMF DRENAS DHE QMF KOMORAN	QKMF - Drenas - Emerxhenca	QMF - Komoran / EMERGJENCA
Totali i Vizitave	36350	34478
Injektimi IM (A55.00)	19895	9161
Injektimi IV (A55.00/2)	1688	1425
Infuzioni IV (A55.00/3)	4031	4867
Injektimi i antikoag.(99.19)	1190	495
Inhalimi (93.94)	16	415
Përplagës/me qepje(A54.00/3)	130	12
Përplagës/pa qepje(A54.00/4)	1007	63
Lidhja e plagës (A54.00/5)	3003	1267
Heqja e pejve (A54.00/6)	42	141
Shplarja e syrit (96.51)	4	94
Kateterizimi uretral (59.8/97.62)	276	23
Heqja e rriqnave	57	0
Imobilizimi (A54.00/2)	612	184
Terapia me Oksigjen (93.96)	369	229
Elektrokardiografia (89.52)	1836	580
Rastet të transportuara me autoambulancë në Q.Emergj.	979	0
Numri i trans. me Aut.Amb.pacientet paliativ SHSKUK	78	0
Shkuarja në R.Shqiprisë transport.i rastit në Spit.Nënë Tereza	2	0
Asistimi në Ndeshje Sportive I ekipeve Mjeks.me Auto amb.	29	0
Asistimi në manifestime	5	0
Asistimi në funerale I ekipeve mjekësore	2	0
Shpërlarje / Albotyl	27	0
TOTALI I SHERBIMEVE	35283	18961

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Barnatotja Qendrore

Barnatorja Qëndore gjatë vitit 2022 ka qenë një nga sektorët kyq në trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të cilët kanë kërkuar shërbime. Furnizimi kontinuel me medikamente dhe material shpenzues, distribuimi dhe disperzimi i tyre në rrjetin Institucioneve të QKMF kanë qenë disa nga prioritetet në këtë digaster. Planifikimi i furnizimit dhe realizimi i kërkesave gjatë 6 mujorit ka shkuar përmes Sistemit të Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF), ku për çdo artikull është futur në këtë sistem gjë që ka mundësuar qasjen dhe kontrollin më të mirë të stokut dhe distribuimit të medikamenteve. Prioritet në furnizim ka pas Sektori i Emergjencës ku asnjëherë nuk kanë munguar medikamentet ampulare për trajtimin e rasteve me prioritet. Furnizimi nga Divizioni Farmaceutik ka qenë më i mirë si në aspektin kualitativ por edhe kuantitativ. Furnizimi me Insulina ka qenë në nivel, nuk ka pasë vështërsi të theksuara në furnizim.

Përveç furnizimit nga MSh përmes operatorit jemi furnizuar me medikamenteve të cilat nuk janë ofruar nga DF/Msh. Hapësira e vogël dhe jo e përshtashme për farmaci ku kryhet dhënja e barnave dhe insulinës për pacientë si dhe hapësira e depos qëndrore ku ruhen medikamentet janë një nga vështërsitë më të cilat ballafaqohen në këtë sektor.

Furnizimi me barna dhe material shpenzues nga Divizioni Farmaceutik ka qenë i kënaqshëm në krahasim me vitet paraprake megjithëse nuk i plotëson kërkesat e pacientëve në trajtimin dhe menagjimin e sëmundje kronike, jo ngjitëse. Shumica e buxhetit të Listës së barnave esenciale është e dedikuar për pacientët Insulinë varës.

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Hyrjet nga MeSH - furnizimet e rregullta mujore	€ 197 772,48
---	--------------

1. Insulina	€ 95 538,40
-------------	-------------

2. Veshje mbrojtëse antiCovid	€ 7 574,00
-------------------------------	------------

3. Material shpenz.mjekësor dhe barera	€ 94 660,08
--	-------------

Hyrje nga blerjet vetanake-buxhetore :

1. Material shpenzues mjekësor dhe barera	€ 8 228,00
---	------------

SEKTORI I SHENDETIT ORAL

Shërbimet e shëndetit Oral përveç në objektin e QKMF-së nuk ofrohen në njësitë tjera të KPSH, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më afër popullatës dhe plotësimit të të standardit ne bazë të U.A. 04/2020. Një mjekë stomatolog në 6000 banorë DShMS është në shqyrtim të plotësimit të këtij standardi . Edhe ky sektor është i pajisur me pajisje stomatologjike dhe material për punë në nivel të kënaqëshëm gjatë këtij viti. Mbetët që me një menaxhim më adekuat nga ana e përgjegjëseve të eliminohen dhe përmirësohen dobësitë subjektive dhe qasje më e mirë ndaj aktiviteteve punuese gjë që duhet dëshmuar me rezultate konkrete.

MATERNITETI DHE VIZITAT E KONSULENTËVE NË KPSH

Materniteti si Departament në KPSH gjatë kësaj periudhe ka punuar sipas trendit të ofrimit të shërbimeve profesionale të lindjeve dhe kujdesin postnatal të foshnjeve të posalindura nga mjekët pediatër. Numri i lindjeve në maternitet ka një trend të shprehur të rënies së tyre, ku gjatë kësaj periudhe janë kryer gjashtë lindje.


Kujdesi ndaj shendetit të gruas është realizuar në kuadër të vizitave të mjekut konsulent (gjinekologut) me referim nga mjeku familjar.

Vizitat e mjekut konsulent pediatër janë realizuar në bazë të udhëzimeve nga mjeku familjar në kujdesin parësor shëndetësor ku janë të paraqitura në diagramet e më poshtë.

Vizitat e mjekut konsulent Dermatologu ne bazë të referimeve nga mjeku familjarë janë të pasqyruara në diagramet më poshtë.


QKMF - Drenas - Departamenti i Maternitetit

■ QKMF - Drenas - Departamenti i Maternitetit



Sektori Konsultativ

■ vizita ■ shërbime



Programi i vizitave në shtëpi për gratë shtatëzana dhe fëmijet deri në 3 vjeç nuk ka shkuar sipas dinamikës së parashikuar. Implementimi i këtij program që është mbështetës UNICEF e që është njëri prej shërbimeve të KPSH I paraparë në Ligjin për shëndetësi dhe U.A.04/2020. Me qëllim të implementimit të këtij shërbimi është i domosdoshëm mobilizimi dhe trajnimi i personelit shëndetësor.

Komiteti i sigurimit të cilësisë

Sigurimi i cilësisë nënkupton mbajtjen e një cilësie të lartë të kujdesit shëndetësor duke matur vazhdimisht efektivitetin e njësive që e ofrojnë atë, përmes instrumenteve të ndryshme e të cilat ndihmojnë në vlerësimin e nivelit të cilësisë së shërbimeve të cilat ofrohen për qytetarët, detektohen mangësitë eventuale dhe hulumtohen e propozohen masat dhe rekomandimet e mundshme për përmirësimin e devijimeve dhe ngritjen e standardit apo standardeve të synuara të cilësisë. Rrjedhimisht “sigurimi i cilësisë” paraqet një metodë të vlefshme për evaluimin e kujdesit shëndetësor i cili ofrohet për pacientët. Komiteti për Sigurimin e Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore (KSCSHSH), gjatë periudhës gjashtë mujore ka realizuar një varg aktivitete të parapara me planin vjetor të punës për sigurimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Qëllimi:

- Sigurimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore përmes, hulumtimit, analizës, vlerësimit dhe përmirësimit të mangësive të konstatuara në procesin e punës.

Objektivat:

- Rritja e përgjegjësisë në punë dhe vetëdijësimi i stafit për nevojën e zhvillimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të ofruara.
- Ruajtja e vazhdimësisë së implementimit të Auditeve, Rishqyrtimeve Kolegiale, monitorimeve dhe hulumtimit të kënaqshmërisë së pacientëve me shërbimet shëndetësore të cilat u ofrohen dhe hulumtimit të kënaqshmërisë së stafit me punën, kushtet e punës dhe motivimin për punë
- Zhvillimi i aktiviteteve për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore është bazuar në planin e punës, të hartuar dhe të dakorduar nga anëtarët e Komitetit për Sigurimin e Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore;
- Është përcaktuar orari për realizimin e aktiviteteve të parapara për t’u realizuar sipas planit të punës përgjatë tërë vitit;
 - Aktivitetet janë zhvilluar nëpërmes grupeve punuese - Menaxhmenti i QKMF ka përkrahur, krijuar mundësi dhe lehtësira për lirimin nga aktivitetet e rregullta të punës për bartësit e aktiviteteve (anëtarët dhe kryesuesit e grupeve punuese) për realizimin e aktiviteteve të parapara për t’u zhvilluar. Gjatë kësaj periudhe përkundër vështirësive evidente për arsye të pensionimit të Kordinatorit të cilësisë, komiteti i për ngritjen e cilësisë ka punuar në hartimin e rregullore në plotësimin e standardeve bazike ato optimale dhe të së ardhmes.
- Me qëllim të realizimit të objektivave të komitetit të cilësisë është autorizuar një infermieri i Imazherisë Daut Gjinovci për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të Kordinatorit të cilësisë. Ky veprim është marrur me qëllim të mbarëvajtjes së procesit të vaksinimit sipas planit të veprimit nga MSH dhe përmbushjen e objektivave të Komitetit të Cilësisë.

Në këtë periudhë nga Komiteti i Cilësisë dhe grupet punuese janë hartuar një numer i Draft Rregulloreve dhe procedurat standard të Operimit.

Rregullore dhe procedura standardet aprovuara :

- Rregulloren per menagjimin e mbetjeve mjekësore;
- Rregullore pe kontrollin e infeksionit ;
- Sherbimi i kujdesit mjedisor –Standardet e Hixhenes dhe Pastrimit;
- Rregullore e Dosjeve personale;
- Rregullore e menagjimit të rrezikut;
- Rregullore per mirëmbajtjen e paisjeve Mjeksores;
- Procedurat standarde të Mirmbajtjes së Objektit;
- Procedurat standarde të Dezinfektimit dhe sterilizimit;
- Dokument prezantues QKMF (MISIONI ,VIZIONI);
- Program orientues i Infernierëve të sapopunësuar ;
- Programi Orientimi i mjekëve të sapopunësuar
- Dokument vlerësues i infernierëve për trajnim;
- Rregullore e menagjimit të mbetjeve spitalore;
- Vlerësimi i infermierëve për trajnim në KPSH - Formular;
- Korniza e komunikimit;
- Procedurat standard për matjen e tensionit arterial;
- Rregullore e regjistrimit dhe raportimit të incidenteve;
- Vlerësimi dhe permirsimi i cilësisë QKMF Drenas;
- Rregullore dezinfektimit dhe sterilizimit - Procedura standard;
- Rregullore e përdorimit të Autoambulancave dhe veturave zyrtare;

Në proces të përfundimit nga grupi punues është:
Draft rregullorja e burimeve njerëzore, risistemimit, organizimit dhe detyrave e përgjegjësi.
Draft Plani i reagimit emergjent.

Komiteti i cilësisë me qëllim të realizimit të objektivave si mbështetje ka AQH-në, përmes programit kujdesi shëndetësor cilësor dhe i qasshëm.

- Departamenti për Administrat- Zyra Juridike dhe Financa

Emërtimi I punëve juridike	Sasia
Përgaditje te kontratave të rekrutëve doktor dhe infermier Maj 2022	13
Anëtare në komision për hartimin e draft-rregulloreve të ndryshme	20
Vendime per pushim vjetor 2021/2022	238
Autorizim	10
Njoftim per nderprerje te marrëdhënjes së punës për hixhenoteknik	15
Vendim për ndërprerje të marrdh. së punës me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës	15
Vendim per pushim të lehonisë	3
Vendim për ndërprerje të marrdhënjes së punës-dalja në pension	5
Vendim për zv.Koordinator të cilësisë	1
Vendim për formimin e komisioneve të ndryshme	27
Vendim per nderprerje te marrdhanjes se punes sipas fuqise ligjore - vdekja e personit	1
Raport per shkelet e supozuara	3
Vërtetim për pervojë pune	53
Vendim për kalimin e pagës nga 00 në 100%	1
Vendim për pushim të përdëllimit me pagesë	5
Kërkesë për pelqimin e shpalljes se konkursit shkurt 2022	1
Referencë	9
Vendim për sistemim të përkohshëm	10
Vendim per ndryshim te koeficientit -specializim	3
Vendim per pune jashte orarit drenas janar 2022	15
Vendim per pervojë të punës	7
Vërejtje me shkrim	2
Vendim për ndërprerje të marrdhënjes së punës sipas kërkesës së punëtorit	2
Kërkesa për deklarata me shkrim	11
Inicimi i procedures disiplinore	3
Raport per shkelet e supozuara	3
Kërkesa të ndryshme	15
Aprovim I kërkesave të ndryshme	15
Përgaditje të procesverbalit	7
Njoftime zyrtare të ndryshme	10
Dëshmi për punëtorin që nuk ka masë disiplinore të pa shuar	6
Vendim për ndërprerje të marrdhënjes së punës për shkak të mosparaqitjes në punë	1

RAPORTI PERMBLEDHËS I SHPENZIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN


Kodi ekonomik - 73100

Periudha Janar-Dhjetor 2022

Kategoria ekonomike	Kodi	Alokimi	Shpenzimi	Zotimi	Shp. & Zot.	Mbetja
1	Paga	10/611/111	1368410	1358308	1358308	10102.26
2	Mall/Sherb	10/611/130	382134	376760.2	376760.2	5373.79
3	Komunali	10/611/132	54000	44761.04	44761.04	9238.96
4	Paga	21/111			0	0
5	Paga	22/111			0	-
6	M/sh+Kom	21/130	32000	29333	29333	2667
7	M/sh	22/130	29195.17	29087.17	29087.17	108
8	Inv. Kap.	10/300	322856	319836	319836	3020.01
9	Inv. Kap.	21/300			0	0
10	Inv. Kap.	22/301			0	0
11	Donacion	59/300	35000	35000	35000	0
TOTALI		2223595	2193085	0	2193085	30510.02

Pjesëmarrja e kategorive ekonomike ne totalin e shpenzimit te buxhetit

Kategoria ekonomike		Kodi	Alokimi	Shpenzimi	Mbetja	Realiz. në %
1	Paga	111	1368410	1358308	10,102	99.26
2	Mall/Sherb	130	443329.2	435180.4	0	98.16
3	Komunali	132	54000	44761.04	9,239	82.89
4	Inv. Kap.	300	322856	319836	3020	99.06
5	Donacione Ap. RTG	95	35000	35000	0	100.00



- Koment:
- Pagat dhe Meditje** : janë realizu sipas planifikimit.
(Pagat e rregullta 1.240504.77 dhe Mj. Nga Prog. I Rimëkëmbja 127.905.12)
 - Mallra dhe sherbime** : Janë relizuar nga tri burime: BKK dhe të HV nga KPSH
 - Komunalit**: Perfshihen shp e Rymëe, Uji, Mbeturinat dhe Tel fix
 - Investimet kapitale** : janë realizu 99.06%.

Konkluzionet

- *Përvojat e fituara gjatë kohës së pandemisë janë në aplikim në raste tjera emergjente eventuale.
- * Duhet gjetur mënyrën për furnizim me gaz medicinal si artikull me rëndësi të madhe në trajtimin e rasteve me theks atyre emergjente.
- * Duhet shiquar mundësia për blerjen e aparateve oksigjenues për QMF sidhe për autoambulanca çka për një periudhe të konsiderueshme do të zgjidhej problemi me furnizim kontinuel me këtë artikull shumë të rëndësishëm.
- * Përdorimi i mjeteve për mbrojtje personale dhe dezinfektuesve ka qenë një nga përparsitë gjatë pandemisë. Ka gatishmëri të personelit për respektimin dhe përmbushjen e obligimeve punuese.
- * Duhet të punohet në përkufizimin dhe implemetin e Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë aq sa lejonjnë kushtet. Për këtë është formuar edhe grupi punues.
- * Duhet të ndërtohet sistemi i vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut.
- * Implementimi i Sistemit Mbikqyrës Mbështetëse. Edhe këtu është i formuar grupi për implementim.
- * Fuqizimi i Komitetit për Ngritjen e Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore si dhe Koordiantorit të Cilësisë.
- * Ngritja e vetiniciativës dhe motivimit të personelit në përbushjen e detyrave punuese.
- * * Mbikqyrja e respektimit të orarit përmes instalimit të aparturës për hyrje –dalje në të gjitha ISh.
- * Furnizimi me uniforma dhe mbathje për të gjithë personelin.
- * Aplikimi i Udhërrëfyesve dhe Protokoleve Klinike të miratura në menaxhimin e pacientëve.
- * Zvogëlimi i përshkrimit të terapisë parenterale.

- * Dërgimi dhe përkrahja financiare i mjekëve por edhe i gjithë personelit në kurse, seminare, kongrese dhe evenimente tjera me interes për QKMF.
- * Ngritja e përgjegjësisë të grupit për realizimit të kornizës së monitorit dhe evaluimit të Master planit.
- * Delegimi i detyrave në përmbushjen sa më kualitative të përgjegjësisë dhe obligimeve tek i gjithë stafi e me theks në Përgjegjësat e Departamenteve/Sektoreve si dhe Përgjegjësve në QMF.
- * Përmes indiaktorëve të paracaktuar në mënyrë kontinuele duhet të maten rezultatet dhe performanca në aritjen e objektivave të parashtruara.
- * Aktivitetet në ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe njëkohësisht të shiqohet progresi përmes instrumenteve matëse.
- * Monitorimi i zbatimit e aktiviteteteve përmes indikatorëve të paraqitur në planin për vitin 2022.
- * Synimi në përmbushjen e planit për vitin 2022
- * Punësimi i personelit shëndetësor mjek/infermier duke synuar arritjen e standardeve të paracaktuara.
- * Implementim i UA dhe akteve tjera nënligjore të miratuara.
- * Miratimi i Statutit të QKMF në Asamblen Komunale.
- * Vazhdimi i bashkëpunimit me agjencionet nacionale dhe ndërkombëtare si dhe Institucione të nivelit qendror dhe lokal duke u fokusuar në prioritett dhe planin për vitin 2022.

- Identifikimi i palëve të interesit si dhe mbajtja e komunikimit me qëllim të realizimit të objektivave me theks në ndërtimin e objektit të QKMF-se si dhe intervenimeve në infrastrukturë .
- Duhet punuar në fuqizimin e zonimit si një nga principet kryesore të konceptit të M.F si ofrimin e shërbimeve sa më afër vendëbanimeve të tyre dhe shkarkimin e fluksit dhe presionit në QKMF si dhe do të rritej efektiviteti dhe cilësia e shërbimeve.
- Fuqizimi i rolit të ekipit të mjekësisë familjare (mjek familjar/infermier/e familjare).
- Angazhimin e Sektorit të Shëndetit Oral në zvogëlimin e prevalencës së kariesit me theks të fëmijët shkollor dhe parashkollor.
- Mbulueshmëria e fëmijëve në kalendarin e vaksinimit me theks në komunitetet minoritare (Rom).
- Kontinuiteti i imunizimit kundër gripit sezonal dhe SARS- COV.
- Implementimi i rrjetit të SISH BHIS në të gjitha Institucionet e KPSH, si dhe ngritjen e cilësisë së futjes së dhënave në databazë.
- Punësimi i IT për mirëmbajtjen e paisjeve hardverike, softverike si dhe rrjetit të internetit.
- Mbikqyrja e disperzimit të medikamenteve nga LEB planifikimit dhe rerealizimit të planifikimit si dhe regjistrimi në SMSF.
- Racionalizimi i analizave laboratorike bazuar në diagnozë, aplikimi i termineve.
- Aplikimi i i trendeve e reja në menaxhimin e aktiviteteve dhe personelit si implementimi i shpërblimeve por edhe dënimeve sipas legjisllaciniot

Veprimtaria e Shërbimeve Sociale të Qendrës për Punë Sociale gjatë këtij viti raportues është orjentuar në mbrojtjen e këtyre kategorive:

- Mbrojtjen sociale të fëmijëve dhe rinisë,
- Përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindor,
- Mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta dhe atyre me sjellje të çrregulluara.,
- Mbrojtjen sociale të të rriturve në gjendje të nevojës sociale,
- Mbrojtjen e të rriturve me nevoja të veçanta,
- Mbrojtjen e të moshuarve pa kujdes familjar dhe pa mjete për jetesë,
- Punët e kujdestarisë dhe
- Mbrojtja e familjes në realizimin e të drejtave juridike.

Përveç detyrave të përmendura, Shërbimet sociale kanë kryer edhe punë tjera profesionale nga veprimtaria e saj:

- ka zhvilluar aktivitete preventive me qëllim të pengimit të dukurive negative dhe në zbutjen e problemeve sociale,
 - ka ofruar shërbime dhe punë këshilluese qytetarëve me probleme të ndryshme me qëllim të tejkalimit të tyre,
 - ka ofruar ndihmë familjeve me mardhënje të çrregulluara dhe raporte të prishura martesore,
 - i ka propozuar gjykatës mendime lidhur me besimin e fëmijëve kontaktimin e tyre me prindin tjetër,
 - ka zbatuar vendimet e gjykatave për besimin e fëmijëve dhe mbajtjen e kontakteve personale të fëmijëve me prindin tjetër,
 - ka kryer punët rreth përcaktimit të përshtatshmërisë së adoptuesve potencial,
 - ka bërë strehimin e fëmijëve në familje tjetër,
 - Ka bërë punë tjera administrative si: Certifikata, vërtetima që nuk ju ka marrë zotësia e veprimit dhe që nuk janë nënkujdestari
- Realizimi i detyrave programore është bërë në bazë të dispozitave të lartpërmendura, në bashkëpunim përmanent me Drejtorinë Komunale për SHMS, MPMS-DPSF, OSBE, Institucionet sociale, Shëndetsore, Edukativo-arsimore, OJQ-të dhe me subjektet tjera veprimtaria e të cilave është e lidhur me problematikën sociale.

Raporti Statistikor-Përfundimtar për vitin 2022 i Shërbimeve Sociale

Kategoria		Të bartura nga Viti 2021	Levizja e lëndëve (gjate vitit-2022)		Lëndët që bartën per Vitin 2023	
			Të reja	Te mbyllura		
1.	1.a-Fëmijët e braktisur	10	2	2	10	
	1.b-Fëmijët jetim (pa dy prinder)	2	/	1	1	
	1.c-Fëmijët e prindërve të penguar ne kryrjen e detyrave prindore	4	/	1	3	
	1.d-Fëmijët te strehuar ne Familje Strehuese, apo SOS-fshatin	3	1	1	4	
2	Familje Strehuese	1	1	/	1	
3	Kërkesa për Adoptim vendor	/	1	/	1	
4	Kërkesa për Adoptim Nderkomb.	/	/	/	/	
5	Fëmijë të keqtrajtuar	12	11	8	15	
6	Fëmijët me sjellje asociale	11	26	10	27	
7	Të miturit në konflikt me ligjin	8	16	7	17	
8	Viktimat e dhunës familjare	20	28	9	39	
9	Viktimat e Trafikimit	1	1	/	2	
10	Viktimat e Krimeve seksuale	/	1	/	1	
11	Martesa e të miturëve	/	/		/	
12	Punë të rënda(rrezikshme)te fëmijëve	/	/	/	/	
13	Kërkues të këshillimit martesor	19	6	2	23	
14	Të moshuarit	6	1	1	6	
15	Kl. Tjerë:	1.a-Nënat vetushqyese	6	2	1	7
		2.b-Persona me aftësi të kufizuar	4	2	1	5
		3.c-Pers. me aft. kufiz. me pagesë	73	30	8	95
		4.d-Dok. Administrative	/	378	378	/
		5.e-Arësye tjera	6	2	/	8
Gjithsej:		187	509	430	266	

Numri i shfrytezuesve të ndihmës sociale sipas muajve për vitin 2022



Muaj	Nr.i familjeve
Janar	1211
Shkurt	1209
Mars	1230
Prill	1194
Maj	1220
Qershor	1207
Korrik	1208
Gusht	1161
Shtator	1152
Tetor	1078
Nentor	1026
Dhjetor	1020

REALIZIMI I PUNËVE DHE DETYRAVE NË SHËRBIMIN E SKEMES SË ASISTENCES SOCIALE

Prioritetet	Aktivitetet e realizuara	Afatet	Resurset	Pengesat	Verejtje
Procedimi i kërkesave të reja për ndihmë sociale.	Te gjitha kërkesat e reja janë proceduar sipas afatit të parapar ligjor, në këto vite kanë qenë gjithsej 78 kërkesa të reja				
Procedimi i lendeve me rastin e riaplikimit	Eshtë bërë procedimi sipas afatit ligjor dhe të gjitha kërkesat për riaplikim janë plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm dhe janë verifikuar në terren.	përherë	Vetura zyrtare		
Vendosja e shënimeve në bazën e re të të dhënave	Të gjithë nëpunësit e SNS, kanë azhuruar më kohë lëndet sipas afatit të paraparë dhe kanë proceduar shënimet për bazën e të dhënave.		Udhëzimi administrativ		
Procedimi i ankesave në komisionin e ankesave pranë DPSF	Në këtë periudë raportuese janë përcjellë gjithsej 57 ankesa, prej tyre dy (2) janë aprovuar, (46) refuzuar, në procedurë (9)				
Procedimi i lendeve në komisionin mjekësor	Lëndet e kategorisë së parë janë proceduar në komision mjekësor sipas afatit ligjor.				
Raportimi dhe informimi i DPSF dhe DSHMS	Raportimi është bërë i rregullt dhe sipas nevojës				
Kërkesa për ndihmë të njëhershme	Në këtë periudë janë paraqitur gjithsej 4 kërkesa për ndihmë njëhershme, prej tyre 4 janë aprovuar (me nga 100 euro).		QPS, DPSF		
Numri i kërkesave për autorizim	Në këtë periudë ka pasur gjithsej 7 kërkesa për autorizim, të gjitha të aprovuara		QPS, DPSF		
Procedimi i lendeve për					

3.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Në sektorin e planifikimit urban jemi angazhuar si drejtori në përmirësimin e procedurave për aplikimin e lejeve, kërkesave të qytetarëve, investorëve dhe përkrahjen e iniciativave për të pasur një planifikim të qëndrueshëm të qytetit. Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban janë trajtuar brenda afatit ligjor kërkesat dhe janë dhënë kushtet e ndërtimit dhe leje të ndërtimit për objektet të cilat janë në harmoni me dokumentet e planifikimit hapësinor që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, duke filluar nga Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale e Komunës.

Në vitin 2022, është miratuar Harta Zonale e Komunës në mbledhjen e rregullt të kuvendit, si dokumenti më i rëndësishëm i planifikimit hapësinor në të cilën përcaktohen hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës së Glllogocit.

3.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Është filluar me realizimin e projektit Hartimi i Planeve Rregulluese të Hollësishme për të kompletuar legjislacionin në fushën e planifikimit hapësinor, me planet rregulluese të hollësishme do të përcaktohen kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane, rurale të përcaktuar me dokumentet e planifikimit hapësinor, i cili tashmë është në proces të finalizimit dhe pritet hapja e shqyrtimit publik.



3.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Tokës 22 prill 2022, është rregulluar hapësira e gjelbër publike, në pjesë të ndryshme të Komunës së Drenasit, duke i dhënë qytetit një pamje gjelbëruese.



3.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Tokës 22 prill 2022, është rregulluar hapësira e gjelbër publike, në pjesë të ndryshme të Komunës së Drenasit, duke i dhënë qytetit një pamje gjelbëruese.



3.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Duke qenë në prag të sezonit të verës, në kuadër të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit është bërë mbjellja e dhjetëra llojeve të luleve dhe drunjëve në pjesë të ndryshme të Komunës së Drenasit.



3.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Mjedisit me 5 qershor 2022, u mbollën fidane në shkolla dhe qytet. Aksioni për mbjelljen e mijëra fidaneve ka vazhduar në tërë muajin qershor.



3.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

USAID, Programi për Qeverisje Ekonomike në Kosovë, ka përzgjedh Komunën e Drenasit për mbështetje në procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, dhe në bazë të kësaj ka vazhduar procesi i legalizimit në mbështetje të USAID, Programi për qeverisje ekonomike në Kosovë, janë mbajtur aktivitete për informimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve për procedurat e aplikimit dhe përfitimet nga procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje në Komunën e Drenasit, janë promovuar video vetëdijesuese për qytetarët që të aplikojnë për legalizimin e ndërtimeve pa leje, është mbajtur dhe takimi me qytetarë për të diskutuar procesin e legalizimit, dhe mobilizuar për aplikim të legalizimit. Në takim është shpjeguar dhe procedura e aplikimit për legalizim, dokumentet e nevojshme për aplikim, dhe çështjet tjera që ndërlidhen me këtë proces.



3.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT



3.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Komuna e Drenasit në bashkëpunim me Keep It Green, mbështetur nga EULEX Kosova, mbolli 30 pemë në shkolla të Komunës së Drenasit si pjesë e iniciativës për kompensimin e karbonit përmes mbjelljes së pemëve, në kuadër të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, mbetet përkushtimi për forcimin e angazhimit institucional dhe bashkëpunimin me partnerë për mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm.



3.9. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Përpilimi dhe hartimi i Raporteve të Punës nga Institucionet Komunale është prezantim i punës përballë transparencës dhe llogaridhënës ndaj qytetarëve tanë.

Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka prezantuar në vazhdimësi punën e saj përmes raporteve javore e mujore, të cilat kanë pasqyruar ofrimin e shërbimeve gjeodezike e kadastrale për qytetarët dhe personat tjerë relevant dhe veprimet ligjore administrative për pronën publike duke dëshmuar njëkohësisht transparencën dhe llogaridhënien përballë përgjegjësive që i takojnë.

Raporti i Punës për vitin 2022, vë në pah rritjen konstante të efikasitetit në ofrimin e shërbimeve kadastrale, gjeodezike ndaj qytetarëve, zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore gjatë përmbushjes së detyrave të punës, trajtimin profesional të kërkesave të palëve, kryerjen e shërbimeve në afat ligjor, ndërmarrjen e veprimeve konkrete për trajtimin e pronës komunale, rritjen e vazhdueshme të të hyrave vetanake, menaxhimin efikas të buxhetit të drejtorisë etj.

3.9. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Misioni dhe organizimi

Misioni

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është kompetente dhe përgjegjëse për organizimin e kapaciteteve kadastrale, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ mbi tokën dhe pronën në përgjithësi, planifikimin e rrjetit gjeodezik me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave kontrolluese.

Misioni primar i saj është krijimi i një ambienti ligjor në sferën e kadastrit dhe pronës komunale.

Puna e drejtorisë orientohet që përmes matjeve kadastrale, sistemit informativ të tokës dhe regjistrave zyrtar të siguroj të drejtat mbi pronat e paluajtshme me krijimin e parcelave tokësore, ndërtesave si dhe përcaktimin e kufijnjëve të tyre në komunën e Drenasit.

Qëllimi i drejtorisë është ofrimi i shërbimeve profesionale dhe shërbime të tjera subjekteve të ndryshme, përmirësimi i transferimit të tokës, menaxhimi i tokës komunale dhe efikasiteti në taksimin e tokave, evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve, shtëpive, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, etj.

Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi procedon shfrytëzimin e tokave komunale, zbaton vendimet e gjykatës për ndarje, bartje të pronësisë.

Ajo ka bashkëpunim të mirë me institucionet qendrore, konkretisht me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencinë Kadastral të Kosovës si autoritet qendror i menaxhimit të të dhënave kadastrale.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ofron shërbime profesionale dhe shërbime të tjera në fushën e kompetencave dhe përgjegjësi të saj për subjektet e së drejtës dhe organeve shtetërore, dhe me një bashkëpunim të mirëfilltë arrijnë që ti realizojnë punët e caktuara.

Organizimi


Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është e organizuar në këta sektorë:

1. Sektori i Gjeodezisë,
2. Sektori i Kadastrit,
3. Sektori i Pronës.

Në përbërjen e saj ka 11 zyrtarë aktiv

3.9. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

2. Organogrami



3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë është përgjegjëse për:

- a. zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjene, sigurimin e hartave Orto-Foto, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informative për tokën dhe pronën,
- b. sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e kontesteve për tokën,
- c. përmirësimin e transferimit të tokës, menaxhimin e tokës shtetërore dhe efikasitetin në taksimin e tokave,
- d. planifikimin e rrjetit me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave të reja kontrolluese,
- e. digjitalizimin e pikave poligonale dhe trigonometrike, vektorizimin e planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale),
- f. azhurnimin e pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe transformimin me parametrat e dhëna për transformim,
- g. shërbimin e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës,
- h. ndarjen e ngastrave dhe shënimin e kufijve në rastin e shpronësimit, dhe zhvillimin e procedurave.
- i. inspektimin e sipërfaqës së ndërtesave dhe përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa,
- j. regjistrimin e pronës së paluajtshme dhe regjistrimin e tokës komunale,
- k. zhvillimin e procedurës së regjistrimit, sipas detyrës zyrtare dhe kërkesave të palëve,
- l. korrigjimin e regjistrit (RDPP) sipas procedurave dhe zbatimi i të gjitha dispozitat pozitive në fuqi, m.azhurnimin e pronës, në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor, azhurnimin e regjistrit të ndërrimeve të mjeteve nga terreni,
- n. kryerjen e procedurave rreth transaksioneve të pronës publike dhe kryerjen e procedurave të blerjes dhe shitjes së pronës për komunën,
- o. shqyrtimin dhe kryerjen e procedurave administrative për rikthimin e tokës pronarëve të mëparshëm,
- p. mbrojtjen e pronës komunale – publike dhe kryen procedurat lidhur me këtë çështje,
- q. vërtetimin dhe zbatimin e shitblerjes së pasurisë së patundshme

- r. regjistrimin e ndërtesave kolektive dhe organizon mirëmbajtjen e pjesëve të përbashkëta të tyre,
- s. udhëheqjen me kadastrën etazh të banesave, ndërtesave, si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë të ndërtuara banesat,
- t. regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave,
- u. aktvendimet mbi regjistrimin e servituteve, qirambajtjeve dhe barrave të ndryshme,
- v. lëshimin e çertifikatave personave që nuk kanë patundshmëri,
- ë. mirëmbajtjen, korrigjimin dhe harmonizimin e evidencave të vendbanimeve, fshatrave, shesheve, rrugëve dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave,
- x. nxjerrjen e aktvendimeve për miratim ose refuzim të kërkesave,
- y. nxjerrjen e konkluzioneve për plotësimin e kërkesave të pakompletuara,
- z. përgatitjen e projektprogramit të punës për nevojat e Drejtorisë dhe raportin e punës,
- aa. kryerjen e punëve të tjera në pajtim me dispozitat ligjore (shpalljet publike, kërkesat për nevojat e Kuvendit, të gjykatave dhe të institucioneve tjera),
- bb. mbajtjen e shënimeve për tërë tokën dhe objektet, të cilat i posedon apo i shfrytëzon Komuna,
- cc. zhvillimin e procedurës së eksproprijimit, shpronësimit dhe deeksproprijimit të tokës në pronësi të Komunës,
- dd. trajtimin dhe zhvillimin e procedurës administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë është përgjegjëse për:

- a. zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjene, sigurimin e hartave Orto-Foto, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informative për tokën dhe pronën,
- b. sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e kontesteve për tokën,
- c. përmirësimin e transferimit të tokës, menaxhimin e tokës shtetërore dhe efikasitetin në taksimin e tokave,
- d. planifikimin e rrjetit me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave të reja kontrolluese,
- e. digjitalizimin e pikave poligonale dhe trigonometrike, vektorizimin e planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale),
- f. azhurnimin e pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe transformimin me parametrat e dhëna për transformim,
- g. shërbimin e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës,
- h. ndarjen e ngastrave dhe shënimin e kufijve në rastin e shpronësimit, dhe zhvillimin e procedurave.
- i. inspektimin e sipërfaqës së ndërtesave dhe përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa,
- j. regjistrimin e pronës së paluajtshme dhe regjistrimin e tokës komunale,
- k. zhvillimin e procedurës së regjistrimit, sipas detyrës zyrtare dhe kërkesave të palëve,
- l. korrigjimin e regjistrit (RDPP) sipas procedurave dhe zbatimi i të gjitha dispozitat pozitive në fuqi, m.azhurnimin e pronës, në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor, azhurnimin e regjistrit të ndërrimeve të mjeteve nga terreni,
- n. kryerjen e procedurave rreth transaksioneve të pronës publike dhe kryerjen e procedurave të blerjes dhe shitjes së pronës për komunën,
- o. shqyrtimin dhe kryerjen e procedurave administrative për rikthimin e tokës pronarëve të mëparshëm,
- p. mbrojtjen e pronës komunale – publike dhe kryen procedurat lidhur me këtë çështje,
- q. vërtetimin dhe zbatimin e shitblerjes së pasurisë së patundshme

3.1. Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë brenda kompetencës lëndore, kryen punët si në vijimë:

- Shërbimet e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës,*
- Ndarjen e parcelave,*
- Bashkimin e parcelave sipas kërkesës së palëve,*
- Përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa,*
- Rilevimi i sipërfaqes së ndërtesave,*
- Përsëritja e kufijve të parcelës,*
- Shënimi i kufijve në rastin e eksproprijimit,*
- Identifikimi i ngastrave dhe objekteve kadastrale,*
- Nxjerr konkluzione lidhur me kërkesat e palëve,*

Punët tjera gjeodezike

Ndersa pas hyrjes në fuqi të udhëzimit administrative MMPH-NR 12/19 të dt.21.11.2019

Sektori i Gjeodezisë nuk kryen shërbime gjeodezike për prona private, por kryen shërbime vetëm për nevoja të Drejtorisë dhe Komunës- vetëm për prona komunale, dhe sipas këtij udhëzimi të drejta për kryerjen e shërbimeve Gjeodezike kanë vetëm Gjeodetet e

Licencuar nga AKK.

Gjatë vitit 2022 sektori për gjeodezi në tërësi ka zbatuar punët e planifikuara për këtë periudhë të vitit ku me sukses kemi përfunduar këto planifikime.

3.1. Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë në vazhdimësi kryen të gjitha këto shërbime gjeodezike sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi, si: Sektori i Gjeodezisë ka bërë një angazhim dhe një përkushtim të madh për të azhuruar autostraden N9 në pjesën grafike dhe në RDPP edhe pse kjo autostrada është shpronësuar në vitin 2009 dhe është dashur të jetë e përfunduar por ka qenë një mos interesim nga Ministria e Infrastrukturës, por me insistimin e DGJKP-së që ka bërë ndaj Ministrisë së Infrastruktures kemi siguruar shenimet e pjesëshme të autostrades N9, ku këto shënime nuk na janë dhënë në formën fizike fare, vetëm në formën digjitale.

Është kompletuar dosja për elaboratë për rrugën regjionale për Caralevë, me kërkesë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimin Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Drejtorja ka arritur të bëjë azhurimin e autostrades N9 në pjesën grafike dhe RDPP gati në të gjitha zonat të cilat janë jashtë masës komasative ndërsa autostrada që kalon në zonat kadastrale që janë masen komasative kemi bërë azhurimin vetëm në pjesën grafike ndërsa në pjesën tekstuale RDPP do të bëhet azhurimi pas përfundimit të komasacionit.

Drejtorja e Gjeodezisë, Kadastër dhe Pronë ka qenë e angazhuar në ndarjen dhe bashkimin e parcelave të cilat parcela janë në listen e veçantë për tu dhënë në shfrytëzim afatëgjatë për 99 vite.

Gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2022 janë azhuruar në pjesën grafike dhe janë futur në sistemin RDPP parcelat të cilat kanë të bëjnë me rastin i Gjykatës Themelore Prishtinë- Dega në Drenas, si dhe rastin i Stacionit të Policisë në Drenas.

3.1. Sektori i Gjeodezisë

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2022 Sektori i Gjeodezisë ka trajtuar kërkesat, si në vijim:

-Kërkesa për ndarje të parcelave kanë qenë 255 raste

-Bashkim parcelave 339 raste

-Modifikim i attributeve të parcelave 165 raste

-Regjistrim të ndertesave të legalizuara 65 raste

-Koordinata dhe vektor 521 raste

-Korigjim kufiri të parcelave 520 raste

-Kopje plani gjithësejtë 1377 raste

*-Gjithsejt 24 përgjigje kemi kthyer për Gjykatën në Drenas,
34 përgjigje për Gjeodet të Licencuar dhe 17 përgjigje për palë.*

3.1. Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë është i ndërlidhur ngushtë me sektorin e kadastërit dhe është e pa mundur të funksionoj njëra pa tjetrën, të gjitha lëndët që fillojnë nga sektori i gjeodezisë dhe pas shqyrtimit dhe përpunimit të këtyre lëndëve aprovohen nga ky sektor dhe pastaj nga pala parashtrohet kërkesa në sektorin e kadastrit për t'i regjistruar në SIKTK-T.

Sektori i Gjeodezisë bashkëpunon me sektorin e pronës si në raste për definimin e pronave komunale, për përcaktimin e kufijve të parcelave, konstatime të ndryshme që janë të uzurpuara pronat dhe marrim pjesë gjatë lirimit të pronave komunale për t'i caktuar kufit e parcelave etj.

Përveq punëve që kemi në sektorin e gjeodezisë gjatë këtij viti kemi qenë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme, si:

Komision për harta zonale.

Komision për vlerësimin e dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore.

Komision për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore

Komision për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim më pak se një vit

Komision për krijimin e elaborative në z.kad Nekoc

Ekipi Komunal për Hartimin e Planit të Veprimit për vitet 2023-2024 të SZHEL, i bazuar në dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 (Drenas).

3.1. Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë në kordinim me Agjensionin Kadastral të Kosovës kemi bërë azhurimin e komosacionit në pjesën grafike për tri zona kadastrale Zabel i Ulët, Zabel i Epërm dhe Shtrubullojë.

Sektori i Gjeodezisë bashkëpunon edhe me drejtoritë tjera për të ndihmuar në realizimin e projekteve, identifikimin e pronave komunale apo kërkesave të ndryshme.

Gjatë vitit 2022 kemi panuar nga drejtoritë e Komunës së Drenasit, **6081** kërkesa të ndryshme të cilat janë kryer në një afatë kohor të shpejtë me qëllim që të ofrohet lehtësira për realizimin e projekteve të ndryshme që kanë ndikuar direkt në mirëqenien e qytetarëve.

Sektori i Gjeodezisë ka realizuar **87** kërkesa për Sektorin e Pronës të cilat kërkesa janë parashtruar nga administratorët e fshatërave që kryesisht kanë qenë kërkesa për lirim të rrugëve publike dhe pronave komunale.

Kërkesa të ndryshme ka pasur edhe në piketimin e rrugëve publike me qëllim që të bëhet asfaltimi i tyre dhe kërkesa të ndryshme për realizimin e kanalizimeve dhe kolektorëve.

Të gjitha këto kërkesa që kemi realizuar për drejtoritë në fjalë ka qenë punë me përgjegjësi dhe është dashur një përkushtim më i shtuar profesional me qëllim që të jemi sa më të saktë në konstatimet tona.

3.2. Detyrat e Sektori të Kadastrit

Sektori i Kadastërit brenda kompetencës lëndore, kryen punët si në vijim:

- Themelon regjistrin mbi pronën e paluajtshme,
- Zhvillon procedurat e regjistrimit sipas detyrës zyrtare,
- Zhvillon procedurat e regjistrimit sipas kërkesës së palëve,
- Bën korrigjimin e regjistrit sipas procedurave,
- Zbaton të gjitha dispozitat pozitive në fuqi lidhur me regjistrimin e pronës,
- Bën azhurnimin e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor,
- Bën azhurnimin e regjistrit të ndërrimeve të matjeve nga tereni,
- Nxjerr Aktvendime dhe Çertifikata sipas ligjit mbi kadastërin dhe udhëzimeve administrative për kadastër,
- Nxjerr Aktvendime dhe Konkluzione lidhur me kërkesat e palëve,
- Koordinon punët dhe zbaton udhëzimet e Agjencisë Kadastral të Kosovës.

Gjatë vitit 2022 sektori i kadastrit ka kryer kërkesa të ndryshme po shumica dërmuese e kërkesave kanë qenë për :

Dhënia e çertifikatave të pronës së paluajtshme

Dhënia e çertifikatave që nuk posedojnë pronë

Regjistrimin e shitëblerjes së pronës së paluajtshme

Modifikime attributeve të parcelës

Modifikime të attributeve të pjesëve të ndërtesave

Regjistrimin e ndarjeve të parcelave

Regjistrimin dhe fshirjen e hipotekave etj.

Sektori i Kadastërit gjatë vitit 2022 ka pranuar, shqyrtuar, regjistruar këto kërkesa:

Lloji i shërbimit	Total
Bartja e posedimit - Ndarje fizike	19
Bartja e posedimit - Blerje	192
Bartja e posedimit - Dhurim	198
Bartja e posedimit - Këmbim	6
Bartja e posedimit - Shpronësim	6
Bartja e posedimit - Trashëgimi	120
Bashkimi i parcelave	327
Bashkimi i personave të njëjtë me ID te ndryshme	100
Bashkimi i personave të njëjtë me ID te ndryshme pa njësi	33
Fshirja e drejtës së shfrytëzimit	3
Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit	49
Fshirja e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK	7
Krijimi i kopjes zyrtare te planit	3177
Modifikimi atributive të ndërtesës	17
Modifikimi atributive të parcelës	152
Modifikimi i atributive të pjesës së ndërtesës	6
Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale	69
Modifikimi i të drejtave	36
Modifikimi i vërejtjes	3
Ndarja	29
Regjistrimi (krijimi) i parcelës së re	28
Regjistrimi i hipotekës	40
Regjistrimi i ndërtesës	65
Regjistrimi i ngarkesës tatimore	7
Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës	23
Regjistrimi i posedimit të pronës shoqërore sipas detyres zyrtare	30
Regjistrimi i qiramarrjes/nënqiramarrjes	5
Regjistrimi i servitutit	1
Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit	3
Regjistrimi i vërejtjes me kërkesë të palës	2
Regjistrimi i vërejtjes me vendim të gjykatës	5
Regjistrimi i vërejtjes sipas kërkesave tjera	2
Shërbimi i të dhënave - nxjerrja e Certifikatës	3000
Shërbimi i të dhënave / Vërtetim që nuk posedon pronë	917
Fletëpagesa nga intraneti	1237
Totali	9914

3.3. Detyrat e sektorit të Pronës

- Zhvillon procedurat e shpronësimit të tokave në pronësi private për interesat e përgjithshme shoqërore,
- Zhvillon procedurat e deeksproprijimit, gjegjësisht nulimit të aktvendimeve të plotfuqishme rreth shpronësimit në rastet kur plotësohen kushtet ligjore,
- Kujdeset për mbrojtjen e të dhënave pronësore, ku bartës i së drejtës së shfrytëzimit është Komuna e Drenas-it,
- Udhëheq procedurën administrative lidhur me uzurpimet arbitrare,
- Mbanë evidence për lëndët e uzurpimeve,
- Kujdeset për procedurat në përputhshmëri me ligjet në fuqi,
- Kryen procedurat e eksproprijimit,
- Nxjerr aktvendime, konkluzione lidhur me kërkesat e parashtruara, etj.

Në periudhën raportuese gjegjësisht nga Janari e gjerë në fund të muajt Dhjetor 2022,

Në sektorin e pronës, janë kryer këto punë dhe detyra:

Në teren janë realizuar 36 kërkesa nga drejtoritë e ndryshme të komunës si dhe nga administratorët e fshatrave.

Në zyre janë mbajtur takime me palë, si dhe janë kthyer përgjigje në kërkesat të cilat nuk ka pasur mundësi që të kryhen në teren.

Është bërë sistematizimi dhe kalsifikimi i dosjve të sektorit të pronës në foldera të vacant, sipas viteve dhe llojit të dokumenteve. Është krijuar dosja elektronike e dokumenteve të skanuara dhe të evidentuara në formë tablare e sketorit të pronës.

3.3. Detyrat e sektorit të Pronës

Është bërë identifikimi i parcelave të pronave komunale të cilat janë të uzurpuara nga persona të ndryshëm, me objekte, rrethoja, parkingje, kullosa etj.

Kemi pranuar kërkesa për heqje dorë nga Pronësia dhe t'i jipet Komunës gjithsej 3, po ashtu edhe janë përpiluar Deklaratat e Mirëkuptimit dhe janë bërë regjistrimet në RDPP, dhe është bërë bartja nga prona private në emër të KK Glllogoc.

Janë përgaditur të gjitha pagesat e kompensimit të pronarëve për pronave e shpronësuara, ku janë kompletuar 5 pagesa për banesat e shpronësuara në Drenas.

Janë shpallur 2 uzurpatorë si dhe është një (1) rast në procedurë.

Të hyrat vetanake sipas programeve dhe fushave kryesore të të hyrave të planifikuara për vitin 2022- janë gjithsej 70,277.00 euro, si më poshtë:

Taksa për regjistrim të pronës/pagesa për shërbime gjeodezike 52,346.00 euro

Taksa për fletëposeduese dhe kopje plani 17,882.00 euro

Pagesë për regjistrim të matjes gjeodezike 49.00 euro

OE e cila ka fituar tenderin për ofrimin e shërbimeve për përfundimin e komasacionit në pjesën tekstuale RDPP dhe pjesën grafike KADMAP për 18 zona që janë në komasacion dhe të cilat nuk janë të regjistruar pranë zyrës kadastrale në Drenas, ka filluar punën dhe ka përfunduar 6 zona kadastrale.

Lëndet e intranetit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY OF GLOGOVAC



Raporti sipas departamenteve dhe statusit te zgjidhjes

03/01/2022 - 30/12/2022, Drejtoria: DGJPK

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezullua r	Ceduar	Anuluar	Perfundu ar	Totali
DGJPK	Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	3	0	6,037	10	0	0	1	30	0	6,081
		3	0	6,037	10	0	0	1	30	0	6,081

5. Baza ligjore mbi të cilën funksionon DGJKP

Statuti i KK Drenas.

Ligji nr. 2002/5 mbi themelimin e Regjistrit të të Drejtave në Pronë të Paluajtshme.

Ligji nr 2003/13 mbi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit nr. 2002/5.

Ligji nr 2003/25 mbi Kadastrin.

Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës nr. 06/L-092.

Ligji nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore.

Ligji nr. 03/L-205 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Udhëzimi nr. 2004/3 Administrativ i MShP.

Udhëzimet administrative të AKK nr. 2003/1 dhe nr. 2004/1.

Udhëzim pune AKK nr. 01/131/06.

Udhëzim Administrativ (Mea) Nr. 09/2020 Për Tarifat E Shërbimeve Për Regjistrimin E Të Drejtave Të Pronës Së Paluajtshme

Udhëzim Administrativ Mmph Nr 08-2019 Për Tarifat E Produkteve Dhe Shërbimeve Të Agjencisë Kadastrale Të Kosovës

Udhëzim Administrativ (Mmph) Nr 13-2019 Për Licencimin E Kompanive Gjeodete Dhe Të Gjeodetëve

Udhëzim Administrativ Mmph – Nr 09-19 Për Ndarjen E Zonave Kadastrale

Udhëzim Administrativ Mmph – Nr 10-19 Për Matjet Kadastrale Për Regjistrim Në Kadastër

Udhëzim Administrativ Mmph – Nr 11-19 Për Ndarjen E Ndërtesës Dhe Të Pjesës Së Ndërtesës

Udhëzim Administrativ Mmph – Nr 12 19 Për Ndarjen Dhe Regjistrimin E Parcelës

Udhëzimi Administrativ Nr.14 2019 Për Caktimin E Emërimit Dhe Numërimit Të Adresave Për Zona Të Qarkullimit Publik, Ndërtesa,

Shtëpi, Objekte Dhe Parcela Kadastrale Të Lira

Udhëzim Administrativ Nr.15 2019 për renditjen e elementeve të adresave dhe caktimin e formatit të shkronjave, numrave dhe të tabelave të adresave

Udhëzim Administrativ Mmph Nr 16 Për Procedurat E Krijimit Dhe Administrimit Të Regjistrit Komunal Të Adresave Dhe Regjistrin Shtetëror Të Adresave

Udhëzim Administrativ Mmph Nr. 17 Për Krijimin Dhe Administrimin E Listës Alfabetike Për Emërtime, Listës Rezervë Dhe Vendosjen E Tyre Në Regjistrin Komunal Të Adresave

Udhëzimi Administrativ Nr.18 2019 Për Vendosjen Fizike Të Tabelave Të Adresave Në Zona Të Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte Dhe Parcela Kadastrale Të Lira

3.10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Arritjet/progresi/përformanca kyçe gjatë vitit 2022

Në pajtim me nenin 17 pika f e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Drenasit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, gjatë vitit 2022 është angazhuar që të realizojë punët dhe detyrat që kanë qenë të parapara me Plan programin e punës.

DSHPE me dt. 22/04/2022 shënoi 22 Prillin - Ditën Ndërkombëtare të Tokës, më datën 05/06/2022 Ditën Botërore të Mjedisit (biodiversitetit) dhe 21.09.2022 Ditës Botërore të Pastrimit.

Në këto dy ditë mjedisore janë realizuar aktivitete të rëndësishme si:

- **Pastrimi i hapsirave publike në Qendër të qytetit;**
- **Mbjellja e Drunjëve dekorativ në sheshin “Fehmi Lladrovci” dhe në parkun e qytetit,**
- **Largimi i disa deponive ilegale;**

Për të arritur objektivat Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, përkatësisht aktivitetet që janë të parapara në këtë plan janë realizuar këto aktivitete:

Ka vazhduar procesi i shpërndarjes së shportave dhe rritja e numrit të klientëve që ju ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave nga KRM “PASTRIMI” me bashkëveprim me inspektorin e Mjedisit. Ky proces në vazhdimësi është duke u realizuar dhe si rezultat i këtyre aktiviteteve gjatë këtij gjashtë muaji janë duke hyrë në sistem të menaxhimit të mbeturinave edhe disa ekonomi familjare, dhe biznese. Për ta arritur qëllimin, jemi duke bashkpunuar me Drejtoratin e Inspektoriatit.

Janë kryer aktivitetet për Hartimin e Planit komunal për Menaxhimin e mbeturinave dhe Rregullorës Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave, ku jemi ndihmuar edhe nga GIZ-zi, dhe të njëjtët kanë dalë për debat publik dhe do të miratohen në Kuvendin e komunës këtë vit(2023)

Për realizimin e projekteve kapitale janë kryer këto aktivitete kryesore:

- **Hartimi i deklaratave të nevojave për projektet e DSHPE-së;**
- **Hartimi i kërkesave për zotim të mjeteve;**
- **Hartimi i projekteve ideore për secilin projekt;**
- **Hartimi i paramasave dhe parallogarive;**
- **Caktimi i menaxherve për mbikqyrjen e projekteve;**
- **Faza e implementimit të projekteve;**
- **Faza e pranimit teknik të projekteve.**

Gjatë këtij viti janë realizuar projektet një vjeçare dhe ato që janë me kontratë kornizë, të cilat po i paraqesim si më poshtë :

•**Rregullimi i rrethojave të varrezave në Komunën e Drenasit: Për këtë projekt janë kryer procedurat e prokurimit publik dhe është bërë rregullimi i varrezave në fshatin Gllanasellë, Poklek dhe Baicë, si dhe riparimi i rrethojës së varrezave në Sankocë dhe Vërboc.**

•**Rregullimi i parkingut për autotaxi: Projekti është i realizuar sipas planit dinamik dhe sipas kontratës, ku në këtë rast është bërë rregullimi i 513 m² parking me kubza me t=8 cm, dhe është lëshuar në funksion.**

•**Riparimi dhe zgjerimi i vendndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre: Është realizuar projekti për rregullimin e 17 vendndalje (stacione të autobusve), në**

fshatrat: Tërstenik (1), Vërboc (1), Nekoc (2), Dobroshec (1), Baicë (1), Kizharek (1), Shtuticë (1), Damanek(1), Krajkovë(1),

Gradicë(1), Likoshan(1), Qikatovë e vjeter(1), Tërdec (1), Sankoc (1), Gllansellë (1), Abri (1). Vlenë të theksohet se për këtë

projekt kemi fituar donacion nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, pas aplikimit të DSHPE-se në vlerë për 50,000.00€.

•**Zgjerimi dhe mirëmbajtja e kamerave në komunën e Drenasit: Është bërë rregullimi i defekteve për 25 kamerat e qytetit, të**

cilat janë dal jashtë sistemit dhe tani më janë në funksion. Po ashtu janë vendosur edhe disa kamera Mobile në disa lokacione ku komuna e ka parë të arsyshme

se bashku me Policinë dhe njëherit ju janë dhënë 5 kamera mobile në shfrytëzim për nevoja të sigurisë publike , stacionit të policisë në Drenas.

3.10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

- **Mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit Publik:** (kontratë kornizë), ky porojekt është duke u realizuar duke u bërë mirëmbajtja e ndriçimit publik në vazhdimësi, kryesisht kemi të bëjmë me ndërrimin e trupave ndriçues, ngjyrosjen e shtyllave të ndriçimit, lidhjen e kablllove aty ku ka dëmtime, ndërrim të kontaktorëve, fotoreleve etj.
- **Blerja e kontejnerve dhe shportave për mbeturina:** Ky projekt është përfunduar dhe është bërë furnizimi me dy kontejnerë të tipit Abroll me kapacitet prej 36 m3 dhe janë sjellur nga OE, të cilët i janë dhënë në shfrytëzim të përkohëshëm, KRU “Pastrimi”, ku do të bëjë bartjen e mbeturinave nga stacion transferi, deri në deponinë e Mirashit.
- **Blerja dhe furnizimi me Ulëse dhe shporta për shesh dhe parqe:** Në këtë projekt është bërë furnizimi dhe montimi i 35 ulëseve dhe 83 shportave, ku është krijuar një mjedis me miqësor për të gjithë qytetaret që e shfrytëzojnë këto hapësira.
- **Shenjëzimi Vertikal dhe Horizontal i rrugëve (Kontrat Kornizë) :** Projekti i shenjëzimit vertikal dhe horizontal është duke u realizuar në të gjitha vendet ku kemi pasur kërkesa si: Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në qender të qytetit, parkingjeve, shenjëzimi vertikal për vendndalje të autobusve, shenjëzimi horizontal në stacionin e autobusëve, kompletimi me shenjëzim vertikal tek rruget ku atakohen me hekurudhën, shenjëzimi horizontal dhe vertikal i zebrave në rruget në qendër të Drenasit, dhe vendbanime tjera ku ka qenë e nevojshme, sidomos në rrugët që janë në afërsi të shkollave.

3.10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

- **Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonës dimërore** për vitin 2021- 2022. Projekti ka filluar sipas sezonës dimore dhe ka përfunduar sipas kontratës. Në këtë projekt kanë qenë të përfshira për mirëmbajtje dhe pastrim nga bora rreth 530 km rrugë dhe 26,405 m², sipërfaqe me parkingje, sheshe dhe trotuarë, dhe është e lidhur kontrata kornizë me kompanin “PASTRIMI”
- **Mirëmbajtja e rrugëve gjatë verës (projekt kornizë)**- Ky projekt është duke u realizuar sipas kontratës, dhe OE, është duke bërë fshirjen dhe larjen e rrugëve në qytetin e Drenasit dhe në Komoran.
- **Mirëmbajtja e kanalizimeve fekale dhe atmosferike dhe gropave septike(kontrat kornizë:**

Ky projekt është duke u implementuar në gjithë teritorin e Komunës, në bazë të kërkesave të ardhura nga administratoret e fshatrave dhe detyrës zyrtare që është e paraparë me ligj për mirëmbajtje të ambientit (kanalizimeve atmosferike, fekale dhe gropave septike), të cilat po kryhen në mënyren më të mirë të mundëshme duke zhbllokuar kanalizimet të cilat me vite kanë qenë të pazgjidhura. Në këtë rast janë bërë debllokime të kanalizimeve me gypa duke filluar nga ata Ø (200, 250, 315, 400) (mm), dhe pastrami i gropave septike dhe kanalizimit atmosferik, vendosjen e kapakëve metalik dhe atyre të betonit etj.
- **Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt me zhavor** - Ky projekt ka përfunduar në bazë të kërkesave dhe gjendjes në teren dhe ju janë dhënë prioritet atyre rrugëve që kanë qenë të dëmtuara edhe nga vërshimet.
- **Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimi i qytetit të Drenasi (kontratë kornizë):**

Ky projekt është duke u implementuar sipas paramasës dhe parallogarisë dhe njëherit është duke vazhduar me punët si: pastrimi, fshirja dhe larja e Sheshit, kositja e barit, prashitja e tokës për rrethë drunjëve dekorativ, plehrimi, largimi i mbeturinave, krasitja dhe mbjellja e fidaneve të reja.
- **Projekti i eliminimit të deponive ilegale**, ky projekt është i implementuar dhe janë eliminuar 24 deponi të egra sipas lokacioneve që janë identifikuar nga GIZ-i dhe zyrtarët komunal.

3.10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

- **Projekti për mirëmbajtjen e deponisë inerte në Llapushnik;**

Ky projekt është projekt me kontratë kornizë dhe është duke u mirëmbajtur nga OE, sipas kontratës, por duhet theksuar se shumë kopmani të pa përgjegjshme po i hudhin mbeturinat e amvisërisë dhe atyre të marketeve në këtë deponi, andaj kërkojmë që të mirren masa dhe kontrole më të shpeshta nga inspektorët komunal, për të parandaluar këtë dukuri negative.

- **Projekti për Intervenimet Emergjente:** (kontratë kornizë), Ky projekt është realizuar në teren sipas kërkesave të adresuara nga qytetarët, si largimin e kafshëve/shpezëve/ të ngordhura dhe groposjen e tyre.

- **Trajtimi i qenëve endacak në komunën e Drenasit:** Është hartuar paramasa dhe paralogaria dhe është lidhur një marrëveshje bashkpunimi me Fondacionin StrayCoCo / Stiftung Steinbüelëeg 8, CH-8332 Russikon nga Zvicra dhe është duke u bërë trajtimi i tyre sipas marrëveshjes.

- **Projekti për Shërbimet e varrimit për qytetarët e Komunës së Drenasit:**

Ky projekt është duke u implementuar në bazë të shërbimeve të kryera nga Bashkësia Islame konform paramasës dhe paralogarisë për të gjitha rastet/përsonat e vdekur/ , i cili projekt ka ndikuar sado pak në lehtësimin e familjeve në këto raste.

- **Efiqienca e Energjisë:** Pas aplikimit të komunës për 10 projekte në Fondin e Kosovës për Efiqencë të Energjisë të cilat projekte janë

në listën e Planit komunal të Veprimit për Efiqencë të Energjisë, komuna ka qenë përfituese e këtyre projekteve dhe më pastaj në muajin

prill kanë filluar dhe në muajin dhjetor kanë përfunduar implementimi i 5 projekteve në riparimim e këtyre objekteve me masa efiqiente,

konkretisht në SHFMU "Luigj Gurakuqi" Sankoc, "Dëshmorët e Drenicës" Çikatovë e Vjetër , "Gani Elshani" Krajkovë, SHFMU "Jusuf Gërvalla" në Negroc,

(ku në këtë rast është bërë termoizolimi i mureve dhe kulmit me leshë guri, ndërrimi i dritareve, ndërrimi i kalldajës dhe ndërrimi i trupave ndriçues efiqient).

Pritet të fillojnë punimet edhe në palastrën sportive "Hysni Jetullahu". Njëkohësisht ka përfunduar edhe projekti i Hartimit të Draft Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë, dhe pritët të dal për dëgjim publik, e pastaj të miratohet në Kuvendin e komunës.

3.10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

- **Subvencione dhe Transfere:** Janë bërë tri pagesa në bazë të vlerësimit të komisionit.
- Gjatë vitit 2022 në adresë të DSHPE-së janë pranuar kërkesa dhe lëndë të natyrave të ndryshme gjithsej:
 - **910** – kërkesa dhe lëndë të ndryshme siç janë :
 - kërkesa për mirëmbajtje të kanalizimit dhe gropave septike, të cilat janë realizuar dhe trajtuar të gjitha;
 - kërkesa për shenjëzim horizontal dhe vertikal të komunikacionit;
 - kërkesa për zhavor për rrugët e rendit të IV;
 - kërkesa për zgjerim të ndriçimit public;
 - kërkesa për parkingje të rezervuara;
 - kërkesa për pastrimin e deponive ilegale të mbeturinave;
 - kërkesa për rregullimin e rrethojave për varreza;
 - kërkesa për kompensim të dëmeve nga FNFT ;
 - kërkesa për furnizim me ujë higjienik dhe kërkesa të natyrave tjera të ndryshme;
- Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar dhe sipas detyrës zyrtare ato që kanë qenë të realizueshme kanë përfunduar, ndërsa pjesa tjetër ose është refuzuar ose është ende në proces për shkak të mungesës së buxhetit, mirëpo u është kthyer përgjigje palëve.
- Janë bërë përgaditjet e kërkesave për pagesën e faturave për shërbimet komunale (Ndriçim Publik, ujë, Mbeturina, Energji elektrike, parkingje të rezervuara) dhe janë proceduar për pagesë.

3.10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

DSHPE-ja në bazë të Vendimit 01 Nr. 344-8563 prej dt. 16/02/2016, ka në Menaxhim Stacionin e Autobusëve me objekte përcjellëse në Glllogoc, mirëpo gjatë këtij viti është formuar Kompania Publike “Stacioni i Autobusëve” Drenas, prandaj është hartuar Statuti i kësaj Kompanie dhe pritet që të funksionalizohet. Tri herë është hapur konkursi për kryeshef ekzekutiv, por nuk kanë shprehur intersim asnjë kandidat, atëherë është dashur të bëhej një zgjidhje nga aksionaret, për të caktuar një UD, konform ligjit të ndërmarrve publike, dhe të filloj funksionim normal i kësaj NPL-je.

DSHPE-ja ka një bashkëpunim të plotë me Njësinë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit (NJPZSH).

Rastet emergjente:

Gjatë këtij viti në territorin e Komunës së Drenasit, ka pasur situata emergjente të cilat janë trajtuar si: rastet e zjarreve fushore dhe malore të cilat shumica prej tyre, dyshohet që janë shkaktuar si pasojë e pakujdesisë nga faktori njeri, po ashtu zjarret në objektet e banimit dhe objekte të tjera. Për të gjitha rastet janë marrë masat për reagim të shpejtë në parandalimin dhe zvoglimin e dëmeve të shkaktuara. Pjesëmarrja ka qenë aktive në të gjitha rastet emërgjente duke përfshirë të gjitha rastet e FNFT.

Intervenimet e NJPZSH-së ishin si në vijim:

1) Shuarje të zjarreve	275
2) Shërbime teknike (furnizim me ujë)	61
3) Vershime	25
4) Intervenime teknike	29
5) Intervenime në aksidente rrugore	8

Nga donacionet e fituara këtë vitë vlenë të përmendet, sjella e dy kamioneve për bartjen e mbeturinave me kapacitet 16 m³, të cilët janë blerë më grandet e fituara për garën për:

“Mjedisi i pastër”, ku komuna vitin e kaluar ka fituar grandin mbi **516,000.00€** dhe donacioni për rregullimin e vendndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre me vlerë

prëj **50,000.00 €** nga MZHR.

3.10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

- Takim me organet kompetente që mund të kontribuojnë me qëllim të bashkëpunimit në mbarëvajtjen e punëve në Drejtorinë e Shërbimeve Publike;
- Takime me përfaqësuesit e organizatës së Giz-it dhe AMMK-së (takime fizike dhe online për çështje të Grandit për performancë të Mjedisit të pastër dhe procesin e raportimit vjetor për menaxhimin e mbeturinave);
- Takim me Asociacionin e Komunave të Kosovës (takime online, në formë virtuale);
- Takim me Agjencinë e Emergjencave-AME (takime fizike, në formë virtuale)
- Takim me strukturat e KEDS-it;
- Takim me Fondin e Kosovës për Efiqencë të Energjisë;
- Takime me kolegjiun për Efiqencë të Energjisë në kuadër të Asociacionit të komunave të Kosoves;
- Takime me MAPL, lidhur me Raportin e Performancës komunale;

Takime me administratorët e fshatrave, me biznese me qytetarë rreth menaxhimit të mbeturinave, ndarjes dhe zgjerimit të shërbimit, furnizim me ujë pijshëm.

3.11. INFRASTRUKTURA PUBLIKE

Drejtoria për Infrastrukturë Lokale për realizimin e punëve të planifikuara mbartin mbi vete shumë aktivitete në sektorin e Infrastrukturë lokale, duke filluar me hartimin e projekteve zhvillimore, investimet kapitale. Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë paraqesim raportin e punës për vitin 2022 sipas sektorit :

SEKTORI I INFRASTRUKTURËS LOKALE

Në sektorin e Infrastrukturës jemi angazhuar si drejtori në përmirësimin e procedurave për aplikimin e lejeve, kërkesave të qytetarëve, investorëve dhe përkrahjen e iniciativave për të pasur një planifikim të qëndrueshëm dhe realizim të projekteve kapitale. Gjithashtu janë shqyrtuar edhe kërkesa dhe ankesa tjera të palëve brenda afatit ligjor dhe me kohë i'u kemi përgjigjur dhe njoftuar palët për vendimet e marra në harmoni me ligjet ekzistuese.

Nr	Emërtimi i kërkesave dhe shërbimeve	Pranuara	Aprovuara	Te anuluar	Refuzuara	Në Proces
1	Leje ndërtimi-projekte infrastrukturore	3	3			
2	Pëlqime (për Infrastrukturë)	4	4			
3	Njoftime për lëndë të ndryshme(kërkesa)	159	152		7	
	Totali:	166	159		7	

3.11. INFRASTRUKTURA PUBLIKE

Gjithashtu janë trajtuar kërkesat për infrastrukturë rreth problemeve infrastrukturore etj. Klasifikimi, renditja dhe regjistrimi i lëndëve dhe projekteve të drejtorisë (të gjitha me numër dhe emër në databazën elektronike të krijuar në kuadër të drejtorisë).

- Kontrollimi i projekteve ideore dhe zbatuese në aspektin teknik profesional dhe dhënia e pëlqimit për hartimin e projektit zbatues.

- Hartimi i pëlqimeve të ndryshme për shfrytëzimin e objekteve infrastrukturore

- Hartimi i pëlqimeve të ndryshme për kompani publike dhe private (Kompaninë e Ujësjellësit dhe Kanalizimit, Kompaninë e Pastrimit, Keds-in, Ipko-n, Posta dhe Telekom i Kosovës).

- Hartimi i aktvendimeve të ndryshme për mbikëqyrje dhe menaxhim të kontratës, pranime teknike të projekteve kapitale, përgatitja e raporteve të ndryshme për mbikëqyrje dhe pranimin teknik të projekteve kapitale në Komunën e Drenasit. Gjatë realizimit të projekteve kapitale që janë paraparë për realizim gjatë vitit 2022 nga buxheti komunal, grantet dhe donacionet e ndryshme, ne si drejtori jemi angazhuar me tërë stafin që të realizojmë projektet kapitale dhe hartimin e planeve të nevojshme komunale. Janë kryer një numër i konsiderueshëm i projekteve zbatuese në konsultim me kompaninë projektuese. Projektet kapitale si: rrugët, trotuaret, ujësjellësit, kanalizimet, ndërtimi i objekteve të reja shkollore, ura, mure mbrojtëse, gropa septike, renovime, kanale kulluese, ndriçim publik, pastrim i lumit etj, që janë realizuar gjatë këtij viti janë kryer sipas kontratave të nënshkruara. Në të njëjtën kohë kemi qenë të fokusuar edhe në rritjen e cilësisë së punës dhe në përgjithësi është e kënaqshme. Jemi angazhuar si drejtori që të kemi një performancë edhe më të mirë brenda mundësive dhe kapaciteteve profesionale që i kemi në dispozicion.

3.11. INFRASTRUKTURA PUBLIKE

PROJEKTET KAPITALE QË JANË REALIZUAR GJATË VITIT 2022

Po japim tabelën e projekteve të realizuara gjatë vitit 2022:

LISTA E PROJEKTEVE TË REALIZUARA PËR VITIN 2022		
RRUGËT ME ASFALT DHE KUBËZA BETONI		
Nr	Emërtimi i Projektit	Gjatësia e rrugëve të realizuara në m'
1	RRUGË	
	Totali i përgjithshëm për Asfalt në m'	14,210.00m'
	Totali i përgjithshëm për zhavor në m'	11,902.00m'
2	TROTUARET	
	Totali i përgjithshëm për Kubëza në m'	150.00m'
3	KANALIZIMET	
	Total i përgjithshëm për Kanalizim në m'	Gjatësia e kanalizimeve të realizuara në m'
		10,000.00 m'
	Rehabilitim i kanalizimeve kontrata të lidhura	9,815.00 m'
4	KOLEKTORË	
	Total i përgjithshëm për Kolektorëve në m'	Gjatësia e kolektorëve të realizuara në m'
		4,000.00m'
5	UJËSJELLËS	
	Totali i përgjithshëm për ujësjellës në m'	Rregullimi i kaptazhes gjatësia e ujësjellësit të realizuara në m'
		1,000.00 m'
6	NDRIÇIM PUBLIK	
	Totali i përgjithshëm për ndriçim në m'	Gjatësia e rrejtit të ndriçimit publik të realizuara në m'
		0.00m'
7	LUMEJ, KANALE KULLUSE	
	Rregullim i shtratit të lumit dhe pastrim i tyre	Gjatësia e rregullimit dhe pastrimit të Lumit, përroskave realizuara në m'
		3,000.00m'
	Pastrimi dhe rregullimi i kanaleve kulluese m'	
		3,000.00m'
8	URA, TUMBINA	
	Rregullimi i urës, tombinave dhe mure mbrojtëse	3 Urë 5 tombinave dhe 30.00m' mure mbrojtëse

3.11. INFRASTRUKTURA PUBLIKE

Hartimi i projekteve zbatuese për:

Hartimi i projekteve zbatuese “ Asfaltimi dhe zgjerimi i rrugëve “Besim Mala” , Rr.Fehmi dhe Xhevë Lladrovci” rr. Xhervat Demaku””. Në këto projekte detale zbatuse janë paraparë zgjerimet e rrugëve trotuare dhe ndriçim publik.

Gjithashtu kemi përgatitur me kohë listën me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve për investime kapitale për vitin 2022, kemi pranuar me shkrim kërkesat e administratorëve të fshatrave për investime dhe i kemi paraqitur në kornizën afatmesme për planifikimin e buxhetit për vitet 2023-2025 para Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit Komunal. Jemi munduar ti japim prioritet projekteve të mbetura gjysmë dhe disa projekte që kanë qenë të domosdoshme. Në prioritet kemi vënë një numër të madh të ndriçimit publik, kanalizimesh, rrugëve, trotuareve dhe në krahasim me vitin që lamë pas sepse ishin edhe kërkesat e qytetarëve.

PROJEKTET KAPITALE TË PËRFITUARA NGA DONACIONET ME BASHKËFINANCIM ME KOMUNËN E DRENASIT

Përveç projekteve që janë financuar me buxhetin e Komunës sonë me angazhimin e stafit të drejtorisë dhe me mbështetjen e kryetarit të Komunës në menaxhimin edhe të projekteve të financuar nga Ministria e Infrastrukturës. Projektet që janë financuar në Komunën tonë me ndihmën e granteve dhe donatorëve janë :

Asfaltimi i rrugëve nga memorandume të bashkëpunimit në periudhë 2 dhe 3 vjeçare të financuara nga niveli qendror:

Asfaltimi i rrugës Kroj i Mbretit deri tek Liqeni i Vasilevës- në proces

Asfaltimi i rrugës Tranzit Kroj i Mbretit-Drenas- në proces.

Asfaltimi i rrugës Gradicë-Zhilivodë-vazhdim - në proces.

3.11. INFRASTRUKTURA PUBLIKE

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në vlerë prej 905,811.86 Euro
(Granti i performancës-të shpenzuara ne keto projekte ne shumën 504,837.96 sa ka qenë e alokuar për vitin 2022)

1. **Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuar në Drenas -**
2. **Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i rrjetit te kanalizimeve ne Komunën e Drenasit-**
3. **Ndërtimi i infrastrukturës (Asfaltim dhe kubezim) Drenas I II III dhe IV-**
4. **Kolektorët për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunën e Drenasit**

- Memorandum bashkëpunimi me OJQ “Jetimat e Ballkani”
-Rregullimi i 24 shtëpive për skamnor vazhdimi i tyre nga viti 2021 të cilat një pjesë janë lëshuar në përdorim.

3.11. INFRASTRUKTURA PUBLIKE

AKTIVITETET

Përgatitja dhe dorëzimi i projekteve kapitale të komunës në Ministritë e Infrastrukturës, MMPH, MAPL dhe donatorët ;

Përgatitja e paramasave dhe parallogarive për projekte kapitale;

Përgatitja e dokumentacionit për tenderim të projekteve, deklarata e nevojave, kërkesave për të gjitha projektet e Drejtoria për DIL.

Mbikëqyrja e punimeve gjatë realizimit të projekteve në teren;

Hapja dhe vlerësimi i tenderëve për projekte kapitale;

Hartimet e planeve të menaxhimit të kontratave, raporteve të kërkuara për pagesa nga mbikëqyrësit e projekteve kapitale ;

Përgatitja e platformës digjitale online të dhënave hapësinor në infrastrukturë(rrugë me asfalt dhe kubëza betoni, kanalizime, ujësjellësi, trotuare, ndriçim publik, hapje e kanaleve kulluese, rehabilitim i kanalizimeve, rregullimi dhe pastrimi i shtratit të lumit).

Përgatitja e detyrave projektuese për hartimin e projekteve zbatuese për projekte kapitale

Njoftime të ndryshme për palë rreth kompletimit të lëndëve;

Puna në komisione të ndryshme të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe drejtorët e drejtorive tjera si (Komisioni për Performancë Komunale, Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara nga të reshurat atmosferike, Komisioni për Eficiencë të Energjisë, Komisione të Pranimeve Teknike të Projekteve etj).

Takimi me përfaqësuesit e Ujësjellësit Rajonal dhe punëkryesit për fillimin e punëve në rrjetin e ujësjellësit për fshatrat të komunës sonë.

Përgatitja e raporteve të ndryshme për nevoja të drejtorisë sonë dhe drejtorive tjera të Komunës.

3.11. INFRASTRUKTURA PUBLIKE

PENGESAT DHE VËSHIRËSITË

Zyrtarët e drejtorisë për Infrastrukturë Lokale i kryejnë punët dhe detyrat tjera në bazë të ligjeve në fuqi, përkrahimit të vendeve të punës si dhe planit vjetor të punës. Duhet të theksohet që gjatë realizimit të mbikëqyrjes së projekteve në teren, po ashtu edhe punëve në zyrë jemi ballafaquar me vështirësi të natyrave të ndryshme, kemi pasur shumë pengesa nga banorët e zonave të ndryshme duke filluar nga uzurpimet e pronave dhe ngushtimi i rrugëve, moslejimi i realizimit të projekteve në pronat publike e private e deri te pengimi i realizimit të projekteve, si dhe në disa raste kanë ndikuar edhe në procedurat e prokurimit të stërzgjatura (vlerësimet e ofertave si dhe publikimi i kontratave). Gjithashtu duhet theksuar se gjatë vitit 2022 pengesa kryesore **inflacioni i çmimeve** i cili ka ndikuar në rritjen e materialeve ndërtimore dhe ka zvogëluar sasinë, ku gjithashtu shkaktoi vonesa dhe pengesa në realizimin e projekteve të cilat ishin të kontraktuara në periudhën dy vjeçare 2021/2022. Mungesa e lidhjes së kontratës për Rregullimin e trotuarit dhe ndriçimit publik për shkak ankesave të operatorve ekonomik në OSHP, ka bërë që të mos kemi sasi të realizuara në **ndriçim publik dhe trotuarë**, përveç të atyre në projektin e zgjerimit të rrugës “Besim Mala”. Zyrtarët e drejtorisë tone është dashur të marrin pjesë në çdo hapje dhe vlerësim të ofertave si dhe menaxhimin e mbikëqyrjen e punimeve në teren. Po ashtu kemi mungesë të veturave për dalje në teren për menaxhim të projekteve, takime dhe trajnime të ndryshme, sepse shumë herë kemi humbur ato për mungesë të veturës.

Problem tjetër është edhe mbikëqyrja e punimeve gjatë vikendeve nga ana e zyrtarëve të drejtorisë në mënyrë që të rritet cilësia në realizim të projekteve. Vlen të ceket edhe rrezikshmëria gjatë menaxhimit të kontratave sipas rregullores 33/2012 Për shtesat në page dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil.

PROPOZIMET

Drejtorija për Infrastrukturë Lokale në fokusin e saj përmirësimin e infrastrukturës për jetesë më të mirë për banorët e Komunës sonë dhe kjo do të arrihet duke pasur një planifikim të qëndrueshëm dhe realizimit të projekteve kapitale të cilat lidhen drejtpërdrejtë me infrastrukturën. Për të përmbushur misionin dhe vizionin e saj drejtorija tonë mendojmë se duhet të krijohen edhe disa parakushte për zyrtarët komunal dhe së pari të rritet numri i punëtorëve profesional në këtë drejtori sepse kemi mungesë të inxhinierëve të lëmive profesionale.

3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Drenasit gjatë vitit 2022 (Janar -Dhjetor.2022) në kuadër të fushëveprimtarisë ka ofruar këto punë/shërbime zyrtare të bazuar në Statutin e Komunës, në harmoni me ligjet e Kuvendit të Kosovës, aktet tjera nënligjore, Rregulloret e miratuara nga Kuvendi Komunal i Drenasit, dokumenteve strategjike dhe planin e punës për vitin 2023.

Punës/shërbimet e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik fokus të veçant i është kushtuar hartimi dhe realizimit të politikave zhvillimore, marrja e masave sa më të përshtatshme për të nxituar më tutje zhvillimin e përgjithëshëm ekonomik të komunës së Drenasit, krijimin e kushteve sa më favorëshme, infrastrukturë dhe mjedisit sa më të përshtatshme për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla, mesme për një zhvillim sa më të qëndrueshëm.

Fokus të veçant vazhdon ti ipet promovimit të zhvillimit ekonomik, turizimit, zbutjes së papunësis duke i mundësuar gjenerimin e vendeve të reja të punës.

Pra Drejtoria për Zhvillim Ekonomik vazhdon me intensifikimin e angazhimeve të saj drejt përmirësimit të klimës së të bërit biznes, promovimin e komunës së Drenasit si një Komunë atraktive, për investitorët strategjik për të investuar dhe për tu vizituar, gjithëmon e hapur ndaj ideve inovative dhe projekteve të reja smart, gjithëmon duke ofruar shërbime/konsulenca profesionale.

Përmbledhje e përgjithëshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtori:

- Regjistrimi i bizneseve fillestare (të gjitha bizneset individuale B.I shoqëritë aksionare, ortakëri epërgjithshme, ortakëri e kufizuar, shoqëria e huaj tregtare, ndërmarrjet shoqërore dhe kooperativat bujqësore;
- Regjistrimi i ndryshimeve në biznes;
- Paisje me qertifikata të reja me numër Unifikues;
- Paisja me informata shitesë për biznes;
- Protokollimi i të gjitha lëndëve që kanë të bëjnë me biznes;
- Raportet javore, mujore pranë MTI;
- Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore;
- Vërtetime që nuk posedojnë obligime të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste biznesore;
- Shqyrtimi i lëndëve: kërkesave, ankesave dhe të ngjajëshme;
- Ngarkesa e taksës komunale për biznese;
- Inkasimi i taksës komunale për biznese (pagesat);
- Konsulenca me palët/bizneset si dhe
- Punë dhe angazhime tjera në komisione.

3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Regjistrimet e biznesëve ne peridhuën e raportimit nga data 01.01.2022 deri me datën 31.12.2022 ku janë regjistruara **190** biznese të reja , krahasuar me vitin paraprak të njëjtës periudhë që ishin regjistruar **246** biznese ose shprehur në përqindje **29.47%** më pak se në vitin e kaluar , të cilat biznese në bazë të deklarimeve të tyre punësojnë **200** punëtorë.

- I. Bizneset fillestare brenda ditës pajisen me çertifikatën e biznesit me Numër Unifikes të biznesit, si dhe jepen konsulenca të ndryshme të kësaj natyre për ta krijuar një ambient sa me të volitshëm për regjistrim dhe të gjitha ndryshimet e nevojshme në biznes. Shikuar në bazë të kësaj periudhe ky numër i bizneseve të regjistruara duket si vijon :


Tabela e klasifikimit të biznesëve te regjistruara sipas sektorve për periudhën: Janar-Dhjetor 2022

Nr.	SEKTORËT E BIZNESEVE	Bizneset sipas sektorëve	Përqindja
1	Spektori F-NDERTIMTARIA	112	58.97%
2	Spektori I- AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR	38	20 %
3	Spektori S - VEPRIMTARITË E TJERA SHËRBYESE	20	10.52%
4	Spektori G-TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË; RIPARIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE MOTOÇIKLETAVE	17	8.94%
5	Spektori M-VEPRIMTARITË PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE	2	1.05%
6	Spektori A-SEKTORI A -BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE PESHKIMI	1	0.52%
7	Gjithësejt biznese	190	100%

3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

I. II.Tabela e klasifikimit (kategorizimit) të bizneseve te regjistruara sipas numrit të punësuar për periudhën Janar-Dhjetor 2022


Klasifikimi sipas madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i bizneseve	Përqindja në total
Të vogla	1-5	78	41.05%
Të mesme	5 – 60 (Sh.p.k.)	112	58.94%
Të mëdha	60 - e më tepër	-	-
Gjithsejt		190	100



3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

III.Bizneset e regjistruara sipas aktiviteve në periudhën Janar-Dhjetor 2022


Nr .	Aktivitetet	Shpërndarja e bizn. sipas veprimtarive	Përqindja
1.	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore-	41	21.57%
2.	Aktivitetet shërbyese të pijeve.	31	16.31 %
3.	Sallonet e floktarisë dhe trajtimet e tjera të bukurisë.	20	10.52%
4.	Aktivitetet e tjera të specializuara ndërtimi p.k.t	22	11.57%
5.	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	15	7.9%
6.	Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve	14	7.4%
7.	Punime suvatimi	10	5.26%
8.	Përfundimi dhe finalizimi i punëve të tjera të ndërtesave	12	6.31%
9.	Punimet e kulmit (Içatisë)	15	7.9%
10.	Restorantet dhe aktivitetet shërbyese lëvizëse të ushqimit	10	5.26%
Gjithësejtë.....		190	100 %



3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

IV.Bizneset e regjistruara sipas llojit të pronësisë në periudhën Janar-Dhjetor 2022


Nr.	Lloji i pronësisë	Numri i bizneseve	Përqindja
1	Biznes individual	78	41.06%
2	Ortakëri e përgjithshme		
3	Ortakëri e kufizuar		
4	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	112	58.94%
5	Shoqëri Aksionare		
6	Ndërmarrje në pronësi të huaj		
7	Ndërmarrje publike		
8	Kooperativë bujqësore		
	TOTALI	190	100%



3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

V.Ndryshime në biznes,shuarjet dhe ripërtritjet sipas periudhës Janar-Dhjetor 2022

		I	II	III	IV	V	VI	VI I	VI II	I X	X	XI	XII
1.	Ndryshimet në biznese	6	20	34	23	32	22	14	19	6	29	22	25
2	Shuarjet në biznes	2	2	3	5	4	2	5	1	1	4	7	4
3	Ripërtrirjet të bizneseve	1	4	2	3	5	5	2	3	3	2	2	3




3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

VI.Punë/ shërbime tjera,gjatë periudhës: Janar - Dhjetor 2022;




Nr.	Shërbimi/Lënda	Totali:
1	Çertifikatë duplikat	19
2	Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore.	60
3	Informata shtesë	57



VII.Tabela e pagesave të taksës komunale për vitin 2022 sipas muajve dhe përqindjes


N r.	Pagesat e bizneseve Janar-Dhjetor	Shuma	Përqindja
1	Pagesat e bizneseve për muajin Janar	170.00	0.86%
2	Pagesat e bizneseve për muajin Shkurt	170.00	0.86%
3	Pagesat e bizneseve për muajin Mars	0	0%
4	Pagesat e bizneseve për muajin Prill	0	0%
5	Pagesat e bizneseve për muajin Maj	0	0%
6	Pagesat e bizneseve për muajin Qershor	1,750.00	0.8%9
7	Pagesat e bizneseve për muajin Korrik	65,670.00	32.10%
8	Pagesat e bizneseve për muajin Gusht	33,716.50	17.21%
9	Pagesat e bizneseve për muajin Shtator	22,070.00	11.21%
10	Pagesat e bizneseve për muajin Tetor	25,070.00	12.80%
11	Pagesat e bizneseve për muajin Nentor	5,708.50	2.91%
12	Pagesat e bizneseve për muajin Dhjetor	41,430.00	21.16%
13	Totali i pagesave për vitin 2022	195,755.00	100%



3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK


VIII.Tabela e deklarimeve me zero të taksës komunale për vitin 2022 sipas muajve dhe përqindjes

N r.	Deklarimet me zero Janar-Dhjetor	Shuma	Përqindja
1	Deklarimet me zero për muajin Janar	0	0.00%
2	Deklarimet me zero për muajin Shkurt	0	0.00%
3	Deklarimet me zero për muajin Mars	1,550.00	1.74%
4	Deklarimet me zero për muajin Prill	0	0.00%
5	Deklarimet me zero për muajin Maj	0	0.00%
6	Deklarimet me zero për muajin Qershor	2,150.00	2.42%
7	Deklarimet me zero për muajin Korrik	30,890.00	34.65%
8	Deklarimet me zero për muajin Gusht	43,560.00	48.86%
9	Deklarimet me zero për muajin Shtator	0	0.00%
10	Deklarimet me zero për muajin Tetor	10,050.00	11.27%
11	Deklarimet me zero për muajin Nëntor	750.00	0.84%
12	Deklarimet me zero për muajin Dhjetor	200.00	0.22%
13	Totali I deklarimeve me zero	89,150.00	100



3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Hartimi i aktvendimeve të taksen komunale të ushtrimit të veprimtarisë biznesore në territorin e komunës së Drenasit sipas kartelave dhe faturave të bazuar në rregullorën komunale për taksa ,tarifa,ngarkesa dhe gjoba.



3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

- **Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve që ofron kjo drejtori kanë marrë pjesë stafi sipas kërkesës në;**
- Pjesëmarrja në punëtorinë regjionale për regjionin e Prishtinës ‘Ndikimi COVID-19 në komunat e Kosovës e organizuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim me UN Habitat Kosova
- Pjesëmarrja në punëtorinë e organizuar nga Agjencia për Zhvillim Rajonal- Qendër, lidhur me prezantimin dhe diskutimin e thirrjes për propozime: “Programi për Zhvillim Rajonal (PZHR) 2022” Investimet Kapitale, si dhe rrjetëzimin ndërmjet komunave të rajonit qendër me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.
- Pjesëmarrja në punëtorinë - Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rajonal përmes projekteve për investime kapitale, organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe në partneritet me UN-Habitat Kosovë.
- Pjesëmarrja në trajnimin në Durrës-Shqipëri i organizuar nga INDEP tema “Qendra e Qëndrueshmërisë Ndër-komunale”.
- Pjesëmarrëse në konferencën përmbyllëse të projektit “Zhvillimi dhe fuqizimi i aftësive të të rinjve në Komunën e Drenasit për tregun e punës” në kuadër të projektit Rajonal “Youth Empowerment Enabling Prospect” YEPP, mbështetur nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë dhe implementuar nga Organizata Akti në bashkëpunim me komunën e Drenasit.
- Pjesëmarrëse në punëtorinë e organizuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) me temën “Sfidat e implementimit të legjislacionit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale”.

3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

- Pjesëmarrja ne takimin e rregullt Çmimi Evropian i Ekselencës në Qeverisjes (ELOGE) në Kosovë
- Pjesëmarrëse në takim me bizneset partnere të shkollës se mesme profesionale “Fehmi Lladrovci” organizuar nga Koordinatorja e GIZ-I gjerman dhe GFA për Komunën e Drenasit që janë implementues dhe mbikëqyrës te projektit Fit For Jobs, ne bashkëpunim të ngushtë me Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik.
- Pjesëmarrja ne punëtorin dy ditore e organizuar nga Agjencioni i Menaxhimit të Emergjencave (AME) në koordinim me Komunën e Drenasit dhe mbështetjen e National Democratic Institute (NDI) lidhur më draft dokumentin sipas rregullores se re me Nr.25/2020 për Metodologjinë e hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë .
- Pjesëmarrja në Forumin e Solareve në Kosovë: Promovimi i Investimeve në Energji të Ripërtërishme, organizuar nga Ministria e Ekonomisë e Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).
- Pjesëmarrja në takimin konsultues I organizuar nga MZHR për prezantimin e ”Draft dokumenti Kriteret për brendimin e rajoneve zhvillimore”
- Pjesëmarrja në Tryezë Pune organizuar nga departamenti i turizmit në MTNI ku u diskutuan të arriturat, projektet dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2022 dhe planet për vitin 2023 në fushën e turizmit. Pjesë e tryezës ishin edhe publikimi i atraksioneve turistike ku komuna e Drenasit është ne mesin e 15 komunave që i kanë dërguar listën
- **U realizuan takime me përfaqësuesit institucioneve të nivelit qendror, organizatave vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të arritjen se marrëveshjes/bashkëpunimit për të gjetur mundësin e përkrahjes/ financimit e projekteve zhvillimore, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të komunës së Drenasit dhe sektorit privat/ bizneseve të cilat operojnë në territorin e komunës së Drenasit;**

3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

- Takim pune ne MAPL- Plani i veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2014 qe përfundon në fund të vitit 2022 ,rishikimin e këtij plani për periudhën 2023-2024 si dhe bugjetim i planit te veprimit.
- Takim me përfaqësuesit e WOMEN 4 WOMEN, mundësia e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve të tyre me Komunën e Drenasit për përkrahjen e grave në bujqësi dhe hortikulturë.
- Takim me prof..Dr.Mehtap Hisarciklilar nga Universiteti Coventry në Londër e cila mbikëqyr projektin WOMEN 4 WOMEN ku u diskutua për implementimin dhe zbatimin e këtij projekti.
- Takim pune me Zv. Drejtoreshën e Departamentit për Planifikim nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) znj. Vjendita Avdiu Musliu lidhur me funksionimin dhe zhvillimin e Parkut të Biznesit në Drenas.
- Takim pune me Komandantin e ri të Ekipit Monitorues-Ndërlidhës LMT K9A te Kforit Italian z. Zielo dhe koleget e tij ku u diskutua per gjendjen aktuale të zhvillimit ekonomik.
- Takim me Drejtoreshën e Odes Ekonomike Gjermane në Kosove znj. Nora Hasani më të cilën biseduam lidhur me bashkëpunimin e mundshëm me kompanitë qe operojnë në Komunën e Drenasit dhe mënyrën se si bizneset ne Drenas mund te jenë përfituese të bizneseve Gjermane.
- **Arritja e marrëveshjeve/bashkëpunimeve të cilat do të ndikojnë në përmirësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të NMV**
- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi me AZHER-Qender

3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Projektet e realizuara dha ata në implementim :

- Hartimi i Planit të Veprimit të Strategjisë për vitin 2023-2024 i bazuar në Dokumentin strategjik “Strategjika e Zhvillimit Ekonomik Lokal per vitin 2020-2024 Drenas.
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Women 4 Women në projektin “Mundësitë e përmirësuara të vetë-punësimit dhe punësimit” I SEE që financohet nga Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA) me fondet e Korporatës Austriake për Zhvillim (ADC).
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Agjencinë për Zhvillim Rajonal Qendër (AZHRQ) ka lansuar skema të garantëve “Përkrahja dhe fuqizimi i grave në agrikulturë”,
- Bashkëpunimi me MZHR rreth Analisës së investimeve kapitale si dhe Raportin e Ndarjeve Buxhetore dhe Shpenzimeve të Investimeve Kapitale Komunale për vitin 2021.
- Informimi me kohë në platformën online dhe informim në zyrë të drejtorisë lidhur me gjetjen dhe mundësinë e aplikimit në grande, projekte dhe subvencione adresuar: sektor privatë/bizneseve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit si;
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, ka njoftuar të gjitha subjektet banesore (banoret), se DZHE ka hartuar orarin për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për ditët e punës, të dielave dhe festave zyrtare, për subjektet afariste që janë furnizues të përditshëm për qytetarët me barëra
- Thirrje për aplikim- propozime: Skema e Garantëve „Programi për Zhvillimi Rajonal të Balancuar“ PZHRB 2022, Start-up dhe Biznes ekzistues Lot I dhe Lot II
- Trajnimi për bujqësi dhe hortikulturë në kuadër të projektit të përbashkët Komune- Women 4 Women “Mundësitë e përmirësuara të vetë-punësimit dhe punësimit” I SEE

3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Zhvillimi dhe promovimi i turizmit;




* Me qëllim të mundësisë për promovim dhe zhvillim të turizmit të komunës së Drenasit është duke u bërë identifikimi i monumenteve historike në bashkëpunim me Drejtorin e Kulturës.

* Përzgjedhja e atraksioneve turistike në bashkëpunim me DRKS - atraksion turistik është një vend për të cilin interesohen turistët, zakonisht për vlerën natyrore ose kulturore, rëndësinë historike, bukurinë natyrore ose të ndërtuar, duke ofruar kohë të lirë dhe zbavitje.



RAPORTI I PUNËS JANAR-DHJETOR 2022 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE - KOMUNA E DRENASIT



Ramiz Lladrovci

DRENAS
2023